




# Lufta për statistika të korrupsionit



(Raport i monitorimit vjetor të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë)

Autorët: Hyrije Mehmeti dhe Betim Musliu

Ekipi i Redaktorëve: Ehat Miftaraj, Yll Zekaj dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë” i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.*

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe Përkrahja Kombëtare për Demokraci (NED).*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

Qershor 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

## Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive.....	5
II.	Metodologjia.....	7
III.	Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial .....	8
IV.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial .....	10
	a) Hetimet në rastet e korrupsionit nga sistemi prokurorial .....	10
	b) Hetimet preliminare të korrupsionit nga sistemi prokurorial .....	12
	c) Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve.....	14
V.	Performanca e PSRK-së në luftimin e korrupsionit.....	16
	a) Trajtimi i rasteve të hetimeve nga PSRK.....	16
	b) Trajtimi i hetimeve preliminare të rasteve të korrupsionit nga PSRK .....	19
VI.	Politika e dënimeve për rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës.....	21
	a) Analizë krahasuese e trajtimit të rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore (2018 dhe 2019).....	22
VII.	Monitorimi i rasteve të korrupsionit nga IKD .....	23
	a) Analiza e rasteve të monitoruara gjatë një viti (1 janar - 31 dhjetor 2019).....	24
	b) Profili i personave të akuzuar në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD.....	26
	c) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit .....	27
	d) Konfiskimi i aseteve me rastin e shpalljes së aktgjykimit .....	30
	e) Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastet e korrupsionit .....	31
VIII.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën e Apelit.....	34
IX.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Supreme.....	49
X.	Aneks: Analizë e veçantë e trajtimit të rasteve të profilit të lartë të korrupsionit .....	54
XI.	Rekomandimet .....	123

## Shkurtesat

GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KRRPK	Kodi i Ri Penal i Republikës së Kosovës
LDP	Ligji për deklarimin e pasurisë
LJG	Ligji për Gjykatat
LKGJ	Ligji për Këshillin Gjyqësor
LKP	Ligji për Këshillin Prokurorial
LPSH	Ligji për Prokurorin e Shtetit
PTH	Prokuroria Themelore
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PA	Prokuroria e Apelit
PK	Policia e Kosovës
PP	Lëndë të Prokurorisë me kallëzime penale
PPN	Lëndë të Prokurorisë në fazën e grumbullimit të informatave
MD	Ministria e Drejtësisë
ZKPSH	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

## I. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) gjatë vitit 2019, ka monitoruar 1180 seanca gjyqësore të 334 rasteve të korrupsionit me 919 persona të përfshirë. Nga seancat e monitoruara, 856 janë mbajtur dhe 324 janë shtyrë.

Transparenca dhe llogaridhënia e sistemit gjyqësor dhe prokurorial luajnë rol kyç në ngritjen e besimit të qytetarëve në punën dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Përderisa edhe gjatë vitit 2019, sistemi gjyqësor ka vazhduar me ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me ofrimin e qasjes në dokumente publike, sistemi prokurorial është duke vazhduar me trendin negativ duke refuzuar qasje në dokumente publike. Përderisa Këshilli Prokurorial ka refuzuar qasje në mbi 42% të kërkesave për qasje në dokumente publike në rastet e korrupsionit, prokuroritë ka refuzuar apo nuk kanë ofruar përgjigje në mbi 77% të kërkesave.

Gjatë vitit 2019, sistemi prokurorial ka pranuar 380 lëndë të korrupsionit, ndërsa ka zgjidhur 388 lëndë, respektivisht tetë lëndë më shumë se sa ka pranuar. Nga 380 lëndët e pranuar kanë qenë 777 persona të përfshirë për dyshimet për kryerjen e veprave penale të korrupsionit, përderisa nga 388 lëndët e zgjidhura kanë qenë të përfshirë 734 persona.

Në rastet e zgjidhura ndaj 734 personave, Prokuroritë në 69% të tyre kanë mbyllur rastet, respektivisht ndaj 315 prej tyre kanë hudhur kallëzimet penale, ndaj 192 prej tyre kanë pushuar hetimet, ndaj një personi është caktuar masa për trajtim psikiatrik. Prokuroritë në 30% të rasteve të zgjidhura ku kanë qenë të përfshirë 218 persona kanë ngritur aktakuzë, kurse ndaj 8 personave tjerë lënda është bashkuar apo është zgjidhur në mënyrë tjetër.

IKD gjatë vitit 2019, ka monitoruar njoftimet e lëshuara nga Prokurori i Shtetit lidhur me aktakuzat e ngritura në rastet e korrupsionit dhe veprave penale karakteristike. Nga ky monitorim IKD ka gjetur se Prokurori i Shtetit është duke vazhduar me qasjen selektive të informimit të publikut lidhur me aktakuzat e ngritura, ku në disa raste publiku nuk informohet lidhur me aktakuzat e ngritura, si në rastin e kryetarit të Komunës së Klinës Zenun Elezaj, për veprën penale “Konflikti i interesit” dhe në rastin ndaj ish-zyrtarit policor Jeton Menxhiqi, për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Viti 2019 karakterizohet me rritjen e performancës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në inicimin dhe trajtimin e rasteve të korrupsionit. Për dallim nga vitet e mëhershme kur kjo prokurori hezitonte të merrte në punë rastet e korrupsionit, në vitin 2019 ka pranuar në punë 19 raste të reja me 92 persona të përfshirë, duke zbatuar në praktikë rekomandimin e IKD-së për marrje të përgjegjësisë dhe ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi nga kjo prokurori.

Edhe në vitin 2019, Gjykatat në Kosovë kanë vazhduar kryesisht më shqiptimin e dënimeve më kusht dhe me gjobë në rastet e korrupsionit. Gjykatat gjatë këtij viti kanë zgjidhur 150 lëndë të korrupsionit, nga të cilat në 30 lëndë kanë shqiptuar dënime më burgim apo në 20% të tyre, në 32 lëndë kanë shqiptuar dënime me gjobë apo në 21% të tyre, në 27 lëndë kanë shqiptuar dënime me kusht apo në 18% të tyre, në 46 lëndë gjykatat kanë shqiptuar

aktgjykime liruese ose refuzuese apo në afërsisht 31% të lëndëve, 7 lëndë të korrupsionit janë mbyllur për shkak të parashkrimit absolut, 2 lëndë janë zgjidhur me dënime tjera kurse 6 të tjera janë zgjidhur ndryshe.

Bazuar në monitorimin e IKD-së, nga 133 persona të cilët janë dënuar për korrupsion nga gjykatat në shkallë të parë, ndaj pesë personave është shqiptuar dënim plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit për një periudhë prej dy viteve dhe një viti. Kurse ndaj 11 personave gjykatat kanë konfiskuar asete nga kryerja e veprës penale, ku janë përfshirë asete në vlerë prej 5 euro, 10 euro, 20 euro, 50 euro, në një rast 5, 087 euro, në një rast tjetër automjete dhe shumën e të hollave prej 20, 56 euro dhe gjësende tjera.

Tejzgjatja e procedurave penale dhe shkelja e afateve ligjore në trajtimin e lëndëve të korrupsionit është duke vazhduar në sistemin gjyqësor, duke shkelur të drejtat dhe liritë e të pandehurve për një proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme kohore.

## II. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirëse dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Kjo për shkak se sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor ende përballen me probleme në unifikimin e të dhënave. Prandaj, hulumtimi trajtimit të rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor bazohet në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor. Hulumtimi përfshinë monitorimin e rasteve të korrupsionit në shtatë Prokuroritë Themelore, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Prokurorinë e Apelit, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, shtatë Gjykatat Themelore dhe degët e tyre, Gjykatën e Apelit si dhe Gjykatën Supreme. IKD ka siguruar të dhënat statistikore nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive dhe Departamenti i Statistikës në Këshillin Gjyqësor si dhe ka mbledhë të dhënat individualisht përgjatë procesit të monitorimit nëpër të gjitha prokuroritë dhe gjykatat.

Raportet e siguruar nga IKD janë përmbledhë në një bazë të të dhënave, e cila ka përfshirë të gjitha rastet e korrupsionit dhe personat e përfshirë në këto raste në të gjitha fazat e procedurës penale në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor.

Baza e të dhënave është shfrytëzuar për të evidentuar çështjet më shqetësuese që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit, përkatësisht lidhur me zgjidhjen, mënyrën e zgjidhjes dhe moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit nga prokurorët dhe gjykatësit. Përmes statistikave, IKD ka analizuar disa aspekte të cilat janë paraqitur dhe komentuar përmes tabelave dhe grafikave, duke përfshirë të gjitha specifikat e rasteve të korrupsionit për secilën prokurori dhe gjykatë, për secilin parashtrues të rastit të korrupsionit dhe për mënyrën e zgjidhjes së rasteve.

Hulumtuesit e IKD-së, prej 1 janarit 2019 e deri më 31 dhjetor 2019 kanë monitoruar 334 seanca gjyqësore në rastet e korrupsionit. IKD ka krijuar indikatorë të qartë për të analizuar trajtimin e rasteve të korrupsionit nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshi prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në shkallë të parë nga gjykatat.

IKD ka monitoruar vazhdimisht aktivitetet e Komisioneve Mbikëqyrëse për lëndët e korrupsionit të KPK-së dhe KGJK-së, Prokurorive, Gjykatave, Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore, gjatë vitit 2019 IKD ka zhvilluar intervista të thella, të bazuara në indikatorët e përcaktuar në përputhje me obligimet ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

### III. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial


Gjatë procesit të monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë, prej 1 janarit e deri më 31 dhjetor 2019, IKD ka bërë gjithsej 679 kërkesa për qasje në dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimin e informacioneve, statistikave dhe të dhënave të tjera të disponueshme dhe të lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike, duke përfshirë gjykatat, prokuroritë, KGJK-në, KPK-në dhe institucionet e tjera. (Shih grafikën)



**Grafika 1 - Kërkesat për qasje në dokumente publike adresuar sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial nga IKD (1 janar – 31 dhjetor 2019)**


Nga 490 kërkesa për qasje në dokumente publike që IKD i ka adresuar vetëm në sistemin gjyqësor, 53 kërkesa i janë drejtuar KGJK-së, kurse 437 kërkesa tjera i janë drejtuar gjykatave të Kosovës. (Shih grafikën)





**Grafika 2 – Përgjigjet e kërkesave për qasje në dokumente publike adresuar sistemit gjyqësor**

Në anën tjetër, nga 189 kërkesat për qasje në dokumente publike që IKD i ka adresuar vetëm në sistemin prokurorial, 26 kërkesa i janë drejtuar KPK-së, kurse 163 kërkesa tjera i janë drejtuar prokurorive të Kosovës. (Shih grafikën)



**Grafika 3 – Përgjigjet e kërkesave për qasje në dokumente publike adresuar sistemit prokurorial**

#### IV. Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial

PSh gjatë periudhës një vjeçare (janar-dhjetor 2019), ka pasur në total në punë, 654 raste me 1502 persona të përfshirë lidhur me veprat penale të korrupsionit. Disa nga këto raste, PSh kishte trashëguar nga vitet paraprake, kurse pjesën tjetër të tyre e kishte pranuar në punë gjatë periudhës raportuese. (Shih tabelën)

##### a) Hetimet në rastet e korrupsionit nga sistemi prokurorial

Prokuroria	Raste të pazgjidhura në fillim	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pazgjidhura në fillim	Rastet e pranuar-të reja (përfshirë edhe ndarjen e procedurës)	Personat e dyshuar rastet e të cilëve janë pranuar në punë dhe persona të dyshuar me zgjerimin e hetimeve	Gjithsej raste në punë	Gjithsej persona rastet e të cilëve janë në punë	Rastet e zgjidhura dhe të dërguara në kompetencë		Raste të pazgjidhura në fund	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pa zgjidhura në fund
							Rastet e zgjidhura	Personat për të cilët janë zgjidhur rastet		
PSRK	17	93	16	85	33	178	10	47	34	201
Prishtinë	110	355	152	287	262	642	154	288	215	543
Prizren	28	63	86	186	114	249	91	177	37	102
Pejë	6	15	16	18	22	33	18	26	8	18
Gjilan	8	19	32	49	40	68	34	54	13	34
Mitrovicë	68	102	39	79	107	181	30	53	90	145
Ferizaj	22	63	19	27	41	90	26	46	20	53
Gjakovë	15	15	20	46	35	61	25	43	15	26
Gjithsej	274	725	380	777	654	1502	388	734	432	1122

Tabela 1 – Trajtimi i rasteve të korrupsionit në sistemin prokurorial për vitin 2019.

PSh gjatë kësaj periudhe raportuese ka zgjidhur 388 raste të korrupsionit ndaj 734 personave të përfshirë, kurse në fund i kanë mbetur në punë edhe 432 raste me 1122 persona të përfshirë në vepra të korrupsionit.

##### *Parashtruesit e kallëzimeve penale*

Gjatë kësaj periudhe raportuese numri më i madh i kallëzimeve penale të parashtruara në PSh ka ardhur nga Policia e Kosovës, të dëmtuarit dhe AKK. Karakteristikë gjatë këtij vjetori është fakti se kallëzimet penale ndaj 81 personave janë deleguar në kompetencë. (Shih tabelën)

Prokuroria	PSRK		Prishtinë		Prizren		Pejë		Gjilan		Mitrovicë		Ferizaj		Gjakovë		Gjithsej	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
<b>Parashtruesit</b>																		
<b>AKK</b>	2	2	45	57	9	9	3	3	5	5			3	3	6	6	73	85
<b>Dogana</b>					1	25											1	25
<b>I dëmtuari</b>			31	71	22	49			12	20			4	6			69	146
<b>IPK</b>			2	3	3	4							1	2	3	10	9	19
<b>E pran. komp.</b>	4	23	9	15	4	20	1	1	2	5	5	10	3	7			28	81
<b>Organi i AK</b>					2	3	2	2									4	5
<b>PK</b>	3	24	43	112	37	59	9	11	8	10	25	60	6	7	10	29	141	312
<b>Prok. me vetin.</b>	3	13	7	12											1	1	11	26
<b>Qytetari</b>	3	21	12	14	6	13	1	1	5	9	6	6	2	2			35	66
<b>Titullari i pronës</b>			3	3													3	3
<b>Autor. pyjor i Kos.</b>					2	4					3	3					5	7
<b>Audit. gjeneral</b>	1	2															1	2
<b>Gjithsej</b>	16	85	152	287	86	186	16	18	32	49	39	79	19	27	20	46	380	777

Tabela 2 – Parashtrimi i kallëzimeve penale për korrupsion në sistemin prokurorial.

### Mënyra e zgjedhjes së rasteve të korrupsionit nga PSh

PSh gjatë kësaj periudhe raportuese ka zgjidhur raste të korrupsionit ndaj 734 personave. Në bazë të përqindjes del se PSh ndaj 69% të personave kanë mbyllur rastet, ndaj 30% të personave kanë ngritur aktakuza, kurse për 1% të personave rastet janë zgjidhur ndryshe. (Shih tabelën)

Prokuroria	Gjithsej persona	Personat rastet e të cilëve janë zgjidhur sipas mënyrës së zgjedhjes						
		Është hudson Kallëzimi penal /	Masat për trajtim Psikiatrik	Është Pushuar Hetimi	Aktakuzë për dhënien e urdhrin ndëshkimor	Është ngritur Aktakuzë e drejtpërdrejtë	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	Mënyrë tjetër (është bashkuar procedura,...)
PSRK	47			35			10	2
Prishtinë	288	139	1	79	1	1	67	
Prizren	177	89		29		2	53	4
Pejë	26	5		6		2	13	
Gjilan	54	27		12		3	12	
Mitrovicë	53	21		1		2	27	2
Ferizaj	46	19		16		1	10	
Gjakovë	43	15		14		1	13	
<b>Total</b>	<b>734</b>	<b>315</b>	<b>1</b>	<b>192</b>	<b>1</b>	<b>12</b>	<b>205</b>	<b>8</b>

Tabela 3 – Mënyra e zgjedhjes së rasteve të korrupsionit në sistemin prokurorial.

## b) Hetimet preliminare të korrupsionit nga sistemi prokurorial

Gjatës vitit 2019, PSh ka pasur në punë gjithsej 1017 raste me 1820 persona të përfshirë.  
(Shih tabelën)

Prokuroria	Informata të pambyllura-zgjidhura në fillim	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pazgjidhura në fillim	informata të pranuar-të reja	Personat e dyshuar rastet e të cilëve janë pranuar në punë dhe persona të dyshuar me zgjerimin e hetimeve	Gjithsej raste-informata në punë	Gjithsej persona rastet e të cilëve janë në punë	Informata të përfunduara-mbyllura- zgjidhura	Personat për të cilët janë mbyllur informatat	Informatat e pambyllura-të pazgjidhura në fund	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pa zgjidhura në fund
PSRK	31	96	44	96	75	192	21	54	169	380
Prishtinë	375	636	198	321	573	957	284	447	418	776
Prizren	21	35	49	91	70	126	41	71	60	98
Pejë	20	45	83	152	103	197	75	115	53	119
Gjilan			1	4	1	4			2	7
Mitrovicë	67	107	10	41	77	148	15	16	68	136
Ferizaj	53	100	14	15	67	115	38	57	31	57
Gjakovë	30	46	21	35	51	81	15	21	41	63
Gjithsej	597	1065	420	755	1017	1820	489	781	842	1636

Tabela 4 – Inicimi i rasteve për hetime preliminare në sistemin prokurorial.

*Parashtruesit e rasteve të korrupsionit për hetime preliminare*

Policia e Kosovës, të dëmtuarit dhe qytetarë, gjatë kësaj periudhe raportuese, kanë paraqitur më së shumti raste në PSh. (Shih tabelën)

Prokuroria	PSRK		Prishtinë		Prizren		Pejë		Gjilan		Mitrovicë		Ferizaj		Gjakovë		Gjithsej	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
<b>AKK</b>	1	1	2	3													3	4
<b>Dogana</b>			1	1							1	1	1	2			3	4
<b>I dëmtuari</b>			37	113	11	17									12	21	60	151
<b>IPK</b>					1	1	11	15					1	1			13	17
<b>E pran.komp.</b>	5	16	50	51	7	29	11	38	1	4	4	32	1	1			79	171
<b>Organi i AK</b>			4	4			1	1									5	5
<b>PK</b>	10	24	66	107	21	30	47	73			2	4	11	11	9	14	166	263
<b>Prok. me vetin.</b>	2	5	12	12													14	17
<b>Qytetari</b>	26	50	18	22	8	13	12	22			3	4					67	111
<b>Auditori i Për.</b>			5	5	1	1	1	3									7	9
<b>Titullari i pronës</b>			3	3													3	3
<b>Gjithsej</b>	44	96	198	321	49	91	83	152	1	4	10	41	14	15	21	35	420	755

**Tabela 5 – Parashtrimi i rasteve për hetime preliminare në sistemin prokurorial.**

### c) Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve

IKD ka vazhduar me monitorimin dhe analizimin e profilit të kryesve të veprave penale të korrupsionit në bazë të informatave të publikuara nga Prokurori i Shtetit (PSh) në faqen zyrtare, lidhur me aktakuzat kundër kryesve të veprave penale të korrupsionit gjatë vitit 2019.

Gjatë kësaj periudhe kohore, PSh ka publikuar njoftime të veçanta për ngritjen e 37 aktakuzave për vepra penale të korrupsionit, kundër 96 personave. (Shih grafikën)



**Grafika 4 – Numri i aktakuzave të ngritura nga prokuroritë dhe numri i të akuzuarve.<sup>1</sup>**


Profili i pozitave të personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat, përfshinë: zyrtarë policor, zyrtarë komunal, nëpunës të Administratës në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve, biznesmenë dhe persona tjerë kryesisht të nivelit të ulët. Kurse, për 12 persona nuk ka informata se cilit profil i takojnë. Ndërkaq, vetëm një aktakuzë i takon profilit të lartë, dhe atë ajo e ngritur më 30 dhjetor 2019, nga PSRK, kundër ish-ministrit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Nenad Rikalo, sekretarit të përgjithshëm të kësaj ministrie, Kapllan Halimi dhe gjashtë zyrtarëve tjerë, për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

<sup>1</sup> Sqarim: IKD ka vazhduar monitorimin e faqes zyrtare të PSh, lidhur me informatat për ngritjen e aktakuzave për korrupsion gjatë gjashtëmujorit të parë 2020, ku nga 1 janari e deri më 16 qershor, PSh ka njoftuar për ngritjen e 7 aktakuzave të tilla (katër aktakuza të ngritura nga PSRK, dy aktakuza nga PTh në Prizren dhe një nga PTh në Pejë), ku në mesin e të akuzuarve janë edhe dy gjykatës, anëtarë të bordeve të ndërmarrjeve publike, zyrtarë komunal, zyrtarë policor, etj., të cilat të dhëna do të publikohen në mënyrë të detajuar në raportin e radhës nga monitorimi i rasteve të korrupsionit.

Nga 37 aktakuzat e ngritura, për të cilat PSh ka njoftuar në faqen zyrtare, në vetëm 14 prej tyre është specifikuar vlera e dëmit që pretendohet se është shkaktuar me veprat penale të korrupsionit, përderisa në vetëm një rast është dhënë informacioni lidhur me kërkesën për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

Megjithatë, ka disa raste kur PSh nuk njofton fare për ngritjen e një aktakuzë për korrupsion, për të cilat monitoruesit e IKD-së raportojnë përmes faqes “Betimi për Drejtësi”. (Shih grafikën)

**Pas transmetimit të emisionit “Betimi për Drejtësi”, Prokuroria ngritë aktakuzë për korrupsion në prokurim të Policisë ndaj policit Jeton Menxhiqi**



PSh, në prill 2019, nuk ka njoftuar lidhur me ngritjen e aktakuzës kundër **zyrtarit policor**, për veprën penale **"keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar"**.

**Ngritet aktakuzë për konflikt interesi ndaj kryetarit të Klinës, Zenun Elezaj**



PSh, në tetor 2019, nuk ka njoftuar lidhur me ngritjen e aktakuzës kundër **kryetarit të Komunës së Klinës**, për veprën penale **"konflikti i interesit"**.

**Grafika 5 – Aktakuzat e ngritura gjatë vitit 2019 për të cilat PSh nuk ka njoftuar në faqen zyrtare, e për të cilat ka raportuar “Betimi për Drejtësi”.**

## V. Performanca e PSRK-së në luftimin e korrupsionit

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2007 nga UNMIK-u si Zyrë e Prokurorit Special të Kosovës, në vitin 2008, me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës është themeluar si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit. Kjo prokurori ka mandat dhe juridiksion në tërë territorin e Kosovës, në hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale të përcaktuara me ligj, ku hyn kompetencat e veçanta (ekskluzive) dhe plotësuese.

### a) Trajtimi i rasteve të hetimeve nga PSRK

PSRK vitin 2019 e kishte filluar me 18 raste të trashëguara të korrupsionit nga vitet paraprake me 66 persona të përfshirë, kurse pas pranimit të disa rasteve dhe zgjidhjes së disa prej tyre, në fund të vitit kjo prokurori ka mbetur me 34 raste të pazgjidhura. (Shih tabelën)

Rastet e korrupsionit në PSRK (1 janar – 30 shtator 2019)	Të pazgjidhura në fillim (1 janar 2019)		Të pranuara (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)		Të zgjidhura (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)		Mënyra e zgjidhjes				Të pazgjidhura në fund (31 dhjetor 2019)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje	Pushim	Aktakuzë	Mënyrë tjetër	Raste	Persona
							Persona	Persona	Persona	Persona		
<b>PSRK</b>	18	66	19	92	13	54		35		19	34	201

Tabela 6 – Rastet e trajtuara të korrupsionit nga PSRK gjatë vitit 2019.

Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës me qëllim të arritjes së rezultateve konkrete në luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë, veprave penale të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit, krimeve të luftës, dhe veprave penale më serioze, në fund të vitit 2018, ka miratuar Ligjin e ri për Gjykatat<sup>2</sup>. Përmes këtij ligji, ishte vendosur që të ndryshoj organizimi i brendshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit përmes themelimit të Departamentit Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me obligimet e dalura nga Ligji për Gjykatat gjatë gjysmë vjetorit të dytë të vitit 2019, kishte arritur që të përfundoj procesin e plotësimit të vendeve të punës, si dhe të funksionalizoj këto dy departamente në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit.

Në bazë të ligjit, këto dy departamente kanë kompetencë dhe përgjegjësi gjykimin e të gjitha veprave penale të parashtruara nga PSRK, ku hyjnë edhe veprat penale të korrupsionit.

<sup>2</sup> Ligji Nr. 06/L-054, për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22, 18 dhjetor 2018.



Që nga funksionalizimi i Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë, PSRK gjatë vitit 2019 ka ngritur vetëm një aktakuzë që i takon profilit të lartë dhe atë më 30 dhjetor 2019, kundër ish-ministrit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Nenad Rikalo, sekretarit të përgjithshëm të kësaj ministrie, Kapllan Halimi dhe gjashtë zyrtarëve tjerë, për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Edhe përkundër faktit se me Ligjin për PSRK, kjo prokurori ka të drejtë të ushtroj kompetenca plotësuese në trajtimin e rasteve të korrupsionit, në katër vitet e fundit e njëjta në mënyrë të heshtur është duke anashkaluar ushtrimin e kësaj kompetence.

Kjo vërtetohet me faktin se PSRK *“shfrytëzon shumë pak ushtrimin e kompetencave plotësuese në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Përderisa kjo prokurori, në vitin 2016 kishte pranuar në punë 12 lëndë të korrupsionit, në vitin 2017 ka pranuar vetëm katër lëndë të reja, kurse në vitin 2018, ka pranuar në punë gjashtë lëndë të reja të korrupsionit.”*<sup>3</sup>

Nëse PSRK vazhdon me këtë trend të ikjes së përgjegjësive së trajtimit të rasteve të korrupsionit, përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë, atëherë edhe themelimi i departamenteve speciale në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit, do të humb kuptimin dhe qëllimin për të cilin janë themeluar.

Sa i përket profilizimit të prokurorëve të PSRK-së, IKD vazhdimisht ka rekomanduar që nisur nga rëndësia dhe rrezikshmëria e veprave penale që trajtohen nga kjo prokurori, prokurorët e PSRK-së duhet të profilizohet dhe specializohen.

PSRK ka bërë hapat e parë në raport të adresimit të këtij rekomandimi të IKD-së në shkurt të vitit 2020, kur edhe ka miratuar *“Strategjinë për Riorganizimin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës”*.

Përmes kësaj strategjie, në kuadër të kësaj prokurorie janë themeluar katër (4) departamente. Departamenti për Krime Luftë, Departamenti për Krim të Organizuar dhe krime tjera në kompetencë të PSRK, Departamenti për Terrorizëm dhe Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar.

Sipas të dhënave në faqen zyrtare të PSRK-së, Departamenti për Krime Luftë udhëhiqet nga Prokurorja e PSRK-së, Drita Hajdari, derisa përbëhet edhe nga prokurorët Atdhe Dema dhe Valdet Gashi.

Departamenti për Krim të Organizuar dhe krime tjera në kompetencë të PSRK-së udhëhiqet nga Prokurorja e PSRK-së, Merita Bina-Rugova, derisa këtë departament janë caktuar që të veprojnë prokurorët Agron Bajrami, Habibe Salihi, Haki Gecaj dhe Burim Cerkini.

Departamenti për Terrorizëm udhëhiqet nga Prokurori i PSRK-së, Afrim Shefkiu, derisa e angazhuar në këtë departament është edhe prokurorja Fikrije Krasniqi-Fejzullahu.

---

<sup>3</sup> *“Pandëshkueshmëria e Korrupsionit, rrezik për shoqërinë dhe shtetin”*. Instituti i Kosovës për Drejtësi, mars 2019.

Ndërsa, Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar udhëhiqet nga Prokurori Enver Krasniqi. Ndërsa, si prokurorë tjerë të angazhuar në këtë departament janë edhe prokurorët Naim Abazi, Florije Salihu-Shamolli dhe Dren Paca.

Sipas Strategjisë për Riorganizimin e PSRK-së, “*përcaktimi i numrit të prokurorëve për secilin departament bëhet nga Kryeprokurori i PSRK-së bazuar në dinamikën e punës dhe ngarkesën me lëndë për secilin departament. Në koordinim me Kryeprokurorin e PSRK-së, Administratori i PSRK-së cakton stafin administrativ të nevojshëm për secilin departament brenda strukturës aktuale të kësaj prokurorie*”<sup>4</sup>.

Në këtë rast, kjo strategji përcakton vetëm një rregull të përgjithshëm mbi numrin e prokurorëve në këto departamente, derisa nuk përcakton asnjë rregull specifike mbi kriteret që duhet të aplikohen me rastin e caktimit të një prokurori në një departament të caktuar.

Në këtë mënyrë, sipas kësaj strategjie, Kryeprokurorit të PSRK-së i është lënë në diskrecion të plotë që të caktojë prokurorët në këto departamente, pasi e njëjta strategji, nuk ka përcaktuar asnjë kriter zbatues.

Në këtë drejtim, nisur nga fakti se tanimë këto kriterë mungojnë në këtë strategji, IKD i rekomandon Kryeprokurorit të PSRK-së që krahas dhënies rëndësi të numrit të nevojshëm të prokurorëve në një departament të caktuar, ti jap rëndësi parimore profesionalizmit të një prokurori për të shërbyer në një departament të caktuar. Në këtë rast, si kriterë orientuese për Kryeprokurorin duhet të shërbejnë rastet që një prokuror ka trajtuar në të kaluarën, fushën për të cilat i njëjti ka ndjekur më shumë trajnime etj.

Për më tepër, IKD i rekomandon KPK-së që të angazhohet në mënyrë aktive që prokurorët e caktuar në këto departamente ti trajnoj, përkatësisht ti ngritë profesionalisht, për fushat në të cilat të njëjtit do të shërbejnë.

Në anën tjetër, PSRK duhet të ketë kujdes që në këto departamente të krijohet stabilitet, dhe jo që prokurorët të lëvizin vazhdimisht dhe pa asnjë kriter nga njëri departament në departamentin tjetër.

PSRK në fund të kësaj periudhe raportuese ka mbetur me 34 lëndë të korrupsionit të papërfunduara ku përfshihen 201 persona.

Numri i lëndëve të pranuar në kompetencë nga Prokuroritë Themelore të Kosovës. Vazhdon të jetë i lartë. Kurse, Policia e Kosovës vazhdon të mbetet parashtruesi më i madh i lëndëve të korrupsionit edhe në PSRK, pasuar nga rastet e paraqitura nga qytetarë. (Shih tabelën)

---

<sup>4</sup> “*Riorganizimi i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës*”. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Shkurt 2020. F.9.

PARASHTRUESIT E KALLËZIMEVE PENALE	Të pazgjidh ura në fillim (1 janar 2019)		Të pranuara (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)		Të zgjidhura (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)		Mënyra e zgjidhjes			Të pazgid hura në fund (31 dhjetor 2019)	
	Persona	Persona	Persona	Persona	Hudhje Persona	Pushim Persona	Mënyrë tjetër Persona	Persona	Persona		
Agjencia Kundër Korrupsionit		1	1				1			1	
Policia e Kosovës	9	24	19			15	4			53	
Qytetari	31	22	12			10	2			41	
Prokurori me Vetiniciativë		15								31	
Pranuar në kompetencë	9	28	14			2	12			64	
Dogana e Kosovës	9									9	
EULEX	8		6			6				2	
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm - nga ZKSH		2	2			2					
<b>Total:</b>	66	92	54			35	19			201	

Tabela7 – Rastet e trajtuara të korrupsionit nga PSRK sipas parashtruesve gjatë vitit 2019.

## b) Trajtimi i hetimeve preliminare të rasteve të korrupsionit nga PSRK

Situatë pothuajse e njëjtë është edhe tek lëndët e regjistruara si PPN. (Shih tabelën)

Rastet e korrupsion it në PSRK (1 janar – 30 shtator 2019)	Të pazgjidhur a në fillim (1 janar 2019)		Të pranuara (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)		Të zgjidhura (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)		Mënyra e zgjidhjes				Të pazgjidhura në fund (31 dhjetor 2019)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje Persona	Pushim Persona	Aktakuzë Persona	Mënyrë tjetër Persona	Raste	Persona
	<b>PSRK</b>	31	96	68	159	54	138	52			86	169

Tabela 8 – Rastet preliminare të korrupsionit të trajtuara nga PSRK gjatë vitit 2019.


Numri më i madh i paraqitjes së rasteve PPN në PSRK janë nga qytetarët, pasuar nga Policia e Kosovës.

PARASHTRUESIT E KALLËZIMEVE PENALE	Të pazgjidh ura në fillim (1 janar 2019)	Të pranuara (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)	Të zgjidhura (1 janar deri më 31 dhjetor 2019)	Mënyra e zgjidhjes			Të pazgid hura në fund (31 dhjetor 2019)
	Persona	Persona	Persona	Hudhje Persona	Pushim Persona	Mënyrë tjetër Persona	Persona
Agjencia Kundër Korrupsionit		1	1			1	9
Policia e Kosovës	7	29	5	2		3	64
Qytetari	43	102	104	38		66	214
Prokurori me Vetiniciativë		5					5
Organi i Admin. Komunale							1
Pranuar në kompetencë	46	22	28	12		16	80
Titullari i pronës							7
<b>Total:</b>	96	159	138	52		86	380

Tabela 9 – Rastet preliminare të korrupsionit të trajtuara nga PSRK sipas parashtruesve gjatë vitit 2019.


## VI. Politika e dënimeve për rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës

Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e ulët, e cila mbështetet kryesisht në shqiptimin e dënimeve më kusht dhe me gjobë. IKD vlerëson se këto dënime nuk e arrijnë qëllimin, duke pasur parasysh se dukuria e korrupsionit vazhdon të cilësohet si kancer i shoqërisë, zhvillimit ekonomik dhe perspektivës evropiane.



Grafika 6 - Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë vitit 2019.


Gjatë këtij viti, gjykatat kanë shqiptuar më shumë dënime me gjobë, sesa dënime me burg apo kusht. (Shih grafikën)



Grafika 7 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë vitit 2019.


**a) Analizë krahasuese e trajtimit të rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore (2018 dhe 2019)**

Politika e dënimeve në një analizë krahasuese të dy viteve të fundit rezulton se në vitin 2019 janë zgjidhur 52 lëndë më pak sesa në vitin 2018. (Shih grafikën)



**Grafika 8 - Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë viteve 2018 dhe 2019.**

Për dallim nga viti 2018, në vitin 2019 janë rritur dënimet me burg, kurse janë zvogëluar dënimet me kusht dhe gjobë dhe aktgjykimet liruese. (Shih grafikën)



**Grafika 9 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë viteve 2018 dhe 2019.**

## Vendimet e gjykatave në rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës të KPK

Të dhënat e Mekanizmit Përcjellës të KPK-së tregojnë se Gjykatat e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese (1 janar – 31 dhjetor 2019) kanë marrë vendime ndaj 136 personave të akuzuar nga PSh, lidhur me veprat penale të korrupsionit. (Shih tabelën)

Prokuroria	Numri i personave për të cilët Gjykata ka marrë vendim përkitazi me aktet akuzuese	Është hudhur Aktakuza para Shqyrtimit Gjyqësor	I akuzuari është shpallur FAJTOR	I akuzuari është LIRUAR	Për të akuzuarin është Refuzuar Aktakuza
<b>PSRK</b>					
<b>Prishtinë</b>	21	3	16	1	1
<b>Prizren</b>	29	3	21	2	3
<b>Pejë</b>	10		5		5
<b>Gjilan</b>					
<b>Mitrovicë</b>	15	1	9	5	
<b>Ferizaj</b>	48	1	11	1	35
<b>Gjakovë</b>	13		13		
<b>Total</b>	136	8	75	9	44

Tabela 10 – Vendimet gjyqësore për rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës të KPK-së.


## VII. Monitorimi i rasteve të korrupsionit nga IKD

Nga qershori i vitit 2015, IKD monitoron rastet e korrupsionit në të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës. Ekipi i monitoruesve të IKD-së, vazhdimisht në baza të përditësuara kanë vizituar të gjitha Gjykatat dhe Kryetarët e Gjykatave Themelore, për të monitoruar për së afërmi secilin proces gjyqësor që ndërlidhet me veprat penale kundër korrupsionit. Monitorimi ka përfshirë procesin e identifikimit të rasteve të korrupsionit në punë, caktimin dhe ndarjen në punë të lëndëve, informacionet se në cilën fazë të procedurës gjenden këto raste në gjykata dhe raportimin e tyre për publikun në baza ditore përmes uebfaqes.<sup>5</sup> Sfidat në identifikimin e rasteve të korrupsionit dhe sigurimin e orarit të seancave gjyqësore kanë qenë dhe mbasin të vazhdueshme për monitoruesit e IKD-së<sup>6</sup>.

<sup>5</sup> IKD në bashkëpunim me Radio Televizionin Publik bashkëprodhojnë emisionin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi”. Krahas kësaj, është zhvilluar edhe portali “Betimi për Drejtësi”, në të cilin përveç hulumtimeve, analizave dhe debateve që zhvillohen në emision, publikohen në baza të përditësuara edhe raportet e monitoruesve të IKD-së për të gjitha rastet e korrupsionit. Raportimi bëhet në rubrikën e veçantë të portalit, të cilat gjenden në këtë link <http://betimiperdrejtesi.com/lajme/>

<sup>6</sup>GjTh-të ende nuk kanë një sistem efikas dhe efektiv të azhurnimit të bazës së të dhënave për orarin e mbajtjes së seancave gjyqësore në përgjithësi dhe në veçanti për rastet e korrupsionit. Fillimisht, IKD ka vendosur

Monitorimin e rasteve të korrupsionit, në të gjitha gjykatat e Kosovës, IKD e ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019. (Shih grafikën)



**Grafika 10 – Rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD (1 janar – 31 dhjetor 2019).**

#### **a) Analiza e rasteve të monitoruara gjatë një viti (1 janar - 31 dhjetor 2019)**


Në këtë raport, subjekt i hulumtimit dhe analizës janë rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë vitit 2019.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IKD ka monitoruar 1,180 seanca gjyqësore, në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës. (Shih grafikën)

---


komunikim përmes Kryetarëve të GjTh-ve dhe më pas përmes zëdhënësve të këtyre gjykatave, të cilët kanë informuar monitoruesit e IKD-së për orarin e caktimit të seancave gjyqësore për rastet e korrupsionit. Megjithatë, kjo praktikë nuk ka funksionuar në mënyrën më të mirë, sepse zëdhënësit kanë dërguar tek monitoruesit e IKD-së informacione jo të plota dhe jo të sakta për orarin e seancave, gjë që ka shkaktuar probleme për monitorimin e tyre. Ky komunikim përditë ka avancuar, megjithatë ende ka probleme praktike që ndërlidhen me orarin e seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit. Duke parë këto sfida, IKD duke shfrytëzuar legjislacionin pozitiv për të pasur qasje në të gjitha informatat e nevojshme rreth këtyre rasteve, ka nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit KGJK, përmes të cilit mundësohet një qasje, komunikim, bashkëpunim dhe koordinim më i mirë në mes të monitoruesve të IKD-së dhe KGJK-së, përkatësisht të gjitha niveleve të Gjykatave dhe Kryetarëve.






**Grafika 11 – Seancat e monitoruara gjyqësore për rastet e korrupsionit gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2019.**

Nga këto 1,180 seanca të monitoruara, 856 prej tyre janë mbajtur, ndërkaq si pasojë e mosplotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e seancave 324 prej tyre janë shtyra. (Shih grafikën)



**Grafika 12 – Numri i seancave të mbajtura dhe të shtyra gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2019.**


Arsyet e shtyrjes së 324 seancave të korrupsionit janë të ndryshme, duke nisur nga mungesa e të akuzuarve, prokurorëve, avokatëve, gjykatësve, dëshmitarëve, dhe arsyeve tjera si mungesa e të dëmtuarit, ekspertit, mos pajisja me kohë me shkresa të lëndës, etj. (Shih grafikën)



**Grafika 13 - Arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore të rasteve të korrupsionit të monitoruara gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2019.**

#### **b) Profili i personave të akuzuar në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD**

Të akuzuarit në rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë vitit 2019 i takojnë të gjitha profileve. Numri më i madh i tyre takon profilit të ulët. (Shih grafikën)



**Grafika 14 – Profili i personave të akuzuar në rastet e korrupsionit (janar-dhjetor 2019).**

### c) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit

IKD vlerëson se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e butë. Gjatë kësaj periudhe, IKD ka raportuar për aktgjykimet e shpallura nga Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës për raste të korrupsionit, ndaj 270 personave të përfshirë. Prej tyre, 240<sup>7</sup> persona akuzohen për vepra të ndryshme korruptive, kurse 30 prej tyre janë të përfshirë në këto raste, mirëpo ngarkohen me vepra jo korruptive.



**Grafika 15 – Aktgjykimet e shpallura nga Gjykatat Themelore për raste të korrupsionit gjatë vitit 2019.**

Aktgjykimet e shpallura në shkallë të parë ndaj këtyre 240 personave, dëshmojnë se gjykatësit kryesisht zbatojnë politikë të butë ndëshkimore ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit. Prandaj, në këtë drejtim, IKD vlerëson se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e butë dhe joadekuate për të arritur qëllimin e dënimit.

Ndaj 133 prej 240 personave është shpallur aktgjykim dënues, kurse 107 persona janë liruar nga akuzat për korrupsion. (Shih tabelën)

Dënim me burg		Dënim me kusht		Dënim me gjobë		Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Hudhje e aktakuzës
Persona	Muaj	Persona	Muaj	Persona	Shuma në euro	Persona	Persona	Persona
41 <sup>8</sup>	630	56 <sup>9</sup>	507	36	71,350	91 <sup>10</sup>	14	2

**Tabela 11 - Rastet e aktgjykimeve të monitoruara nga IKD.**

<sup>7</sup> Sqarim: Nga 240 personat e akuzuar për vepra korruptive, për të cilët gjatë kësaj periudhe raportuese është shpallur aktgjykim nga shkalla e parë, 2 prej tyre janë të përfshirë në më shumë se një rast.

<sup>8</sup> Sqarim: Nga 41 personat e dënuar me burg efektiv, 11 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 9,550 euro.

<sup>9</sup> Sqarim: Nga 56 personat e dënuar me kusht, 20 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 21,250 euro.

<sup>10</sup> Sqarim: Një nga personat e liruar për korrupsion, është i njëjti i cili gjatë kësaj periudhe raportuese është liruar edhe në dy raste të tjera. Gjithashtu, një nga personat tjerë të liruar për korrupsion, është i njëjti ndaj të cilin në rastin e dytë është shpallur aktgjykim refuzues, për shkak se prokurori është tërhequr nga ndjekja penale.

- **Shqiptimi i dënimeve me burg efektiv**

Nga 41 personat e dënuar me burg efektiv, një person është dënuar me 1 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 2 muaj burg efektiv, një person<sup>11</sup> është dënuar me 3 muaj burg efektiv, dymbëdhjetë persona<sup>12</sup> janë dënuar me nga 6 muaj burg efektiv, dy persona<sup>13</sup> janë dënuar me nga 8 muaj burg efektiv, pesë persona<sup>14</sup> janë dënuar me nga 9 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 10 muaj burg efektiv, pesë persona<sup>15</sup> janë dënuar me nga 12 muaj burg efektiv, dy persona<sup>16</sup> janë dënuar me nga 15 muaj burg efektiv, tre persona janë dënuar me nga 24 muaj burg efektiv, tre persona janë dënuar me nga 30 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 36 muaj burg efektiv, dy persona janë dënuar me nga 42 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 48 muaj burg efektiv dhe një person është dënuar me 51 muaj burg efektiv.

- **Shqiptimi i dënimeve me kusht**

Gjykatësit ndaj 56 personave kanë shqiptuar dënime me kusht prej 507 muajve. Prej tyre, tre persona<sup>17</sup> janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 1 muaj secili, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj, tridhjetepesë persona<sup>18</sup> janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 7 muaj, një person<sup>19</sup> është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj, gjashtë persona<sup>20</sup> janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, dy persona<sup>21</sup> janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 18 muaj secili dhe shtatë persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj secili.

- **Shqiptimi i dënimeve me gjobë**

Gjykatësit ndaj 36 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë në total prej 71,350 eurosh. Prej tyre, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 100 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 250 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 300 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 400 euro, dy persona janë dënuar me

---

<sup>11</sup> Sqarim: Personi i dënuar me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 250 euro.

<sup>12</sup> Sqarim: Nga 12 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 4 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 4,200 euro.

<sup>13</sup> Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 8 muaj secili, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 1,000 euro.

<sup>14</sup> Sqarim: Nga 5 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 9 muaj secili, 2 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 2,500 euro.

<sup>15</sup> Sqarim: Një nga 5 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 1,000 euro.

<sup>16</sup> Sqarim: Dy personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 15 muaj secili, janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 600 euro.

<sup>17</sup> Sqarim: Tre personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 1 muaj secili, janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 300 euro.

<sup>18</sup> Sqarim: Nga 35 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 12 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 15,250 euro.

<sup>19</sup> Sqarim: Personi i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 1,000 euro.

<sup>20</sup> Sqarim: Nga 6 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 3 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 1,700 euro.

<sup>21</sup> Sqarim: Një nga 2 personat e me kusht në kohëzgjatje prej 18 muaj, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 3,000 euro.

gjobë në vlerë prej nga 500 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 600 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 700 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1,100 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1,200 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1,500 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1,800 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2,000 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2,500 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 2,800 euro, pesë persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 3,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 3,500 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 3,600 euro, katër persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 4,000 euro dhe një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 7,000 euro.

Tutje, gjykatësit ndaj 91 personave kanë shqiptuar aktgjykim lirues, ndërsa ndaj 14 personave kanë shqiptuar aktgjykim refuzues, kurse ndaj 2 personave e kanë hudhur aktakuzën.

Nga 240 persona të akuzuar, Gjykatat rezulton se kanë dënuar me burg efektiv 41 persona apo 17% të personave të akuzuar. Gjithashtu, nga këta 240 persona të akuzuar, gjykatësit ndaj 56 personave kanë shqiptuar dënime me kusht apo ndaj 23% të personave të akuzuar, ndaj 36 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë apo ndaj 15% të personave të akuzuar, ndërsa janë liruar 107 persona apo 45% të personave të akuzuar.

Në këto raste të korrupsionit në të cilat ka pasur shpallje të aktgjykimit, janë përfshirë të gjitha profilet e personave të akuzuar. Prej tyre, 77 persona i takojnë profilit të ulët, 135 persona profilit të mesëm dhe 28 persona i takojnë të profilit të lartë. *(Shih grafikën)*









**Grafika 16 - Profili i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykimi nga Gjykatat Themelore gjatë vitit 2019.**







Në mesin e personave ndaj të cilëve Gjykatat Themelore kanë shpallur aktgjykime, e të cilët i takojnë profilit të lartë janë: ish-deputeti Naser Osmani (aktgjykim lirues), ish-kryetari i Komunës së Kllkotit Sasha Mirkoviq (aktgjykim lirues në tre raste), ish-ministri i Shëndetësisë Ferid Agani (aktgjykim dënues – 30 muaj burg efektiv), ish-kryetari i Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku (aktgjykim lirues), ish-kryetari i Komunës së Suharekës Sali Asllanaj, ish-kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha (aktgjykim lirues), ish-kryetari i Komunës së Klinës Sokol Bashota (aktgjykim dënues - gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë). Për shkak shumë të lartë të dëmit që dyshohet se është

shkaktuar nga të akuzuarit me kryerjen e veprave penale, në kuadër të profilit të lartë hyjnë edhe zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Bahri Shabani, Shkëlzen Lluka dhe Naim Avdiu (aktgjykim lirues për 5 personat), ish-sekretari i ministrisë së Shëndetësisë Gani Shabani (aktgjykim dënues – 24 muaj burg efektiv), ish-drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) Arben Gjukaj (aktgjykim lirues), zyrtari i KEK-ut Azem Duraku (aktgjykim lirues), ish-drejtori i prokurimit në KEK Driton Pruthi (aktgjykim lirues), biznesmeni Esat Tahiri (aktgjykim lirues), kontraktuesit e KFOR-it për importimin e cigareve (aktgjykim dënues – nga 24 muaj burgim me kusht secili).

#### d) Konfiskimi i aseteve me rastin e shpalljes së aktgjykimit

Nga 133 personat ndaj të cilëve Gjykatat Themelore kanë shpallur aktgjykim dënues gjatë kësaj periudhe raportuese, për 5 prej tyre është shqiptuar edhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit për një periudhë të caktuar kohore, kurse ndaj 11 personave janë konfiskuar asete që dyshohen se janë pjesë e kryerjes së veprave penale, e që në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me të holla në shumën prej 10 euro.

 Për 2 persona	Dënim plotësues: ndalim i ushtrimit të profesionit në periudhë prej dy vitesh.
 Për 3 persona	Dënim plotësues: ndalim i ushtrimit të profesionit në periudhë prej një viti.
 Për 1 person	Konfiskim: dy kartëmonedhave prej pesë euro.
 Për 5 persona	Konfiskim: kartëmonedha prej 10 euro.
 Për 1 person	Konfiskim: kartëmonedha prej 20 euro.
 Për 1 person	Konfiskim: kartëmonedha prej 50 euro.

 Për 1 person	Konfiskim: shuma prej 5.086,75 euro.
 Për 1 person	Konfiskim: dy vetura, njëra “BMË”, dhe tjetra “Daimler Chrysler”.
 Për 1 person	Konfiskim: një set me ngjyrë të zezë me çelës, me shumën e të hollave prej 4.179, një “Audi 8E” si dhe lejen e qarkullimit të këtij automjeti, dy vula të falsifikuara, automjeti “BMË”, automjeti “Renault Tëingo”, si dhe shuma e të hollave prej 20.055,58 euro.
 Për 1 person	Konfiskim: motosharra dhe drutë e prera.
 Për 1 person	Konfiskim: shuma prej 630 euro.
 Për 1 person	Konfiskim: Të gjitha gjërat e sekuestruara.

**Tabela 12 – Dënimet plotësuese të shqiptuara nga Gjykatat Themelore dhe konfiskimet e asetëve që dyshohen se janë pjesë e kryerjes së veprave penale.**

IKD pa dashur të komentoj meritën e vendimmarrjes në rastet gjyqësore të korrupsionit, shpreh shqetësimin se politika ndëshkimore që zbatohet nga gjykatësit në rastet e korrupsionit, nuk është duke dërguar mesazh të qartë te kryesit potencial të këtyre veprave penale. Praktika e tillë ndëshkimore, duke shqiptuar dënime të buta më burg apo dënime me kusht dhe me gjobë, përçon mesazh negativ tek qytetarët dhe publiku. Po ashtu, këto dënime të buta të shqiptuara nuk mund të arrijnë qëllimin e vet për të cilat është shqiptuar dënimi, qoftë atë të karakterit ndëshkimor ndaj atyre, të cilët janë gjetur fajtor se kanë kryer vepra penale të korrupsionit, apo të karakterit preventiv, i cili ka për qëllim për të dërguar mesazhin e qartë tek personat të cilët mund të jenë subjekt i kryerjes së veprave penale të korrupsionit.

#### **e) Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastet e korrupsionit**

Dështimet në respektimin e afateve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit paraqiten në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë, përfshi zvarritjet në polici, prokurori dhe gjykata.<sup>22</sup> Zvarritjet në zgjidhjen e rasteve ndikojnë drejtpërdrejt në shkeljen e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës,<sup>23</sup> të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.<sup>24</sup>

<sup>22</sup> Miftaraj E. dhe Musliu B. “Luftimi i korrupsionit në Kosovë, prioritet në letër”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, 10 dhjetor 2015.

<sup>23</sup> Raporti i vjetor i punës 2014, Nr.14. Fq. 137. Avokati i Popullit. Prishtinë 2015. (Shih linkun [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI\\_2014\\_-\\_SHOIP\\_932837.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI_2014_-_SHOIP_932837.pdf)).

<sup>24</sup> Neni 31 “E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

IKD edhe në këtë periudhë raportuese të monitorimit, ka identifikuar shkeljet e institucioneve të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. IKD përmes monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata, përfshi të gjitha fazat e procedurës penale, paraqet gjendjen reale se sa kohë iu merr institucioneve përgjegjëse për trajtimin e një lënde të korrupsionit, prej kohës së inicimit të kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit.

Prej 1,180 seancave gjyqësore të monitoruara në shtatë GjTh, ku për analizë përfshihen 334 raste të korrupsionit, IKD ka identifikuar shkelje në të gjitha fazat e procedurës penale. IKD ka vendosur disa indikatorë për të matur në secilën fazë të procedurës penale kohën e kaluar për trajtimin e rastit përfshi: 1) Kohën e trajtimit të kallëzimit penal deri në fillimin e hetimeve<sup>25</sup> 2) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve; 3) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës<sup>26</sup>; 4) kohën e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës; 5) kohën e trajtimit prej ngritjes së kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës; 6) koha prej ngritjes së aktakuzës deri në caktimin e shqyrtimit fillestar<sup>27</sup>; 7) koha prej shqyrtimit fillestar deri në caktimin e shqyrtimit të dytë<sup>28</sup>; 8) koha prej shqyrtimit të dytë deri në caktimin e shqyrtimit kryesor; 9) numri i seancave të mbajtura dhe 10) koha e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë<sup>29</sup>.

---

<sup>25</sup> Neni 82, “Hudhja e kallëzimit penal të policisë”. 1. Prokurori i shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se: 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer veprë penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

<sup>26</sup> Neni 159, “Afatet kohore të hetimit”, 1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraparak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

<sup>27</sup> Neni 242, “Procedura për ngritjen e aktakuzës”; Paragrafët 4 dhe 5; 4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. 5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.


<sup>28</sup> Neni 245, “Shqyrtimi fillestar”, paragrafi 5. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

<sup>29</sup> Kapitulli XIX, SHQYRTIMI GJYQËSOR, Neni 285 Caktimi i shqyrtimit gjyqësor, paragrafi 2) 2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5. i këtij Kodi. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

Neni 314, “Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor”; 1. Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: 1.1. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjëres prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni; 1.2. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda njëqindnjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për



Bazuar në këta indikatorë, IKD ka bërë matjen e rasteve të monitoruara gjatë vitit 2019. Gjetjet e IKD-së tregojnë se prokurorët dhe gjykatësit vazhdimisht shkelin afatet e përcaktuara ligjore në KPPRK-së. Në tabelën më poshtë, IKD ka paraqitur disa prej indikatorëve të fazave të caktuara të procedurës penale dhe mesataren e kohës së kaluar për secilën prej këtyre fazave si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit praktik dhe analizës ligjore<sup>30</sup>. (Shih grafikën)



**Grafika 17 - Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD (janar-dhjetor 2019).**

vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjëres prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni. 2. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në: 2.1. numër të shumtë të dëshmitarëve; 2.2. dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë; 2.3. numri i provave është jashtëzakonisht i madh; 2.4. siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 3. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet për tridhjetë (30) ditë për secilin aktvendim nga paragrafi 1. i këtij neni.

<sup>30</sup>*Shënim:* Matjet e realizuara për secilin indikatorë në secilën fazë dallojnë për sa i përket numrit të rasteve. IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të komplettoj të dhënat për secilën fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

Trajtimi i rasteve të korrupsionit, me këtë mesatare të afateve ligjore, dëshmon se prokurorët dhe gjykatësit, vazhdimisht shkelin ligjin dhe nuk i respektojnë politikat e sistemit prokurorial dhe gjyqësor për t'i trajtuar me prioritet lëndët e korrupsionit. Rrjedhimisht, të pandehurit në procedurë penale në rastet e korrupsionit vazhdimisht i nënshtrohen shkeljeve të të drejtave për tu zgjidhur rastet e tyre në kohë të arsyeshme.


## VIII. Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën e Apelit

Përveç monitorimit të gjykatave të shkallës së parë, IKD gjatë vitit 2019 ka vazhduar me monitorimin sistematik edhe të drejtësisë në shkallën e dytë. (Shih grafikën)



**Grafika 18 - Monitorimi i IKD-së në Gjykatën e Apelit (1 janar – 31 dhjetor 2019).**

Duke qenë se, pjesëmarrja në seancat që mban Apeli nuk është e obligueshme për palët (përveç nëse i/e akuzuari gjendet në paraburgim), edhe numri i seancave që dështojnë të mbahen në Apel është shumë më i vogël në krahasim me gjykatat e shkallës së parë. (Shih grafikën)



**Grafika 19 – Numri i seancave të mbajtura dhe të shtyra gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2019.**

Të dy seancat janë shtyre me kërkesë të mbrojtjes së të akuzuarve.

Ndërsa, numri i vogël i seancave publike të mbajtura në Gjykatën e Apelit për raste të korrupsionit, pasqyron më së miri edhe politikën ndëshkimore të butë që gjykatat në Kosovë zbatojnë në rastet e korrupsionit, pasi vet ligji e obligon gjykatën e shkallës së dytë që të mbaj seanca publike vetëm në rastet kur dënimi i shqiptuar nga shkalla e parë është me burg efektiv.<sup>31</sup>

Përkundër kësaj, IKD vëren se kohëve të fundit ka një trend në rritje të mbajtjes së seancave publike edhe në rastet kur dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë nuk janë me burg efektiv.



**Grafika 20 – Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykata e Apelit gjatë vitit 2019.**

<sup>31</sup> Kodit i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 390, paragrafi 1.


Prej këtyre lëndëve të kryera, Apeli në disa raste ka vërtetuar aktgjykimet e shkallës së parë, në disa të tjera i ka kthyer rastet në rigjykim, ka ashpërsuar apo zbutur dënimet, etj. (Shih grafikën)

VËRTETIM	RIGJYKIM	NDRYSHIM	HUDHJE	MËNYRË TJETËR
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vërtetimi i aktgjykimeve të shkallës së parë në <b>49</b> raste.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kthimi i <b>26</b> rasteve në rigjykim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ashpërsim i dënimeve në <b>2</b> raste.</li> <li>Zbutje e dënimeve në <b>4</b> raste.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hudhja e ankesës si e palejuar në <b>1</b> rast.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendosje në mënyrë tjetër në <b>6</b> raste.</li> </ul>

Grafika 21 – Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykata e Apelit gjatë vitit 2019.

Ajo çka IKD vëren në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, është një vazhdimësi edhe nga ana e Apelit e politikës së butë ndëshkimore që aplikohet nga gjykatat e shkallës së parë.

GjA, përkundër se në kuadër të autorizimeve të veta ka mundësinë që t'i ndryshojë vendimet e shkallës së parë, një gjë të tillë e ka bërë vetëm në gjashtë (6) raste gjatë vitit 2019. (Shih grafikën)



Grafika 22 – Ndryshimi i aktgjykimeve të shkallës së parë nga Gjykata e Apelit në rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë vitit 2019.

Kësisoj, kjo politikë e dënimeve nga ana e Apelit, del të jetë e kundërta e asaj që vet kreu i kësaj gjykate, Hasan Shala, vazhdimisht e potencon në konferenca apo intervista për media, me ç'rast, i njëjti adreson kritika lidhur me politikën e butë ndëshkimore në rastet e korrupsionit. Madje, në një konferencë për media të mbajtur në janar 2020, gjatë prezantimit të punës së GjA-së për vitin 2019, Shala kishte thënë se dënimet me kusht janë duke e stimuluar korrupsionin.

Njëjtë sikurse edhe në të kaluarën, as gjatë vitit 2019, nuk është shqiptuar as edhe një aktgjykim dënues me burg efektiv për ndonjë të akuzuar të profilit të lartë sa i përket rasteve të korrupsionit.

Përkundrazi, Apeli gjatë kësaj periudhe ka anuluar edhe dy aktgjykime të shkallës së parë, me të cilat, një ish-ministër, një ish-kryetar komune dhe një ish-sekretar i ministrisë, ishin dënuar prej dy (2) deri në tre (3) vjet burgim efektiv për korrupsion.

Po ashtu, një dënim me kusht dhe gjobë, i ishte anuluar edhe një ish-kryetari tjetër komune dhe edhe kjo lëndë ishte kthyer në rigjykim.

Kurse, IKD nuk ka gjetur ndonjë rast kur në lëndët e profilit të lartë, të jenë anuluar apo ndryshuar aktgjykimet liruese të gjykatave të shkallës së parë.

Ndryshe, gjatë kësaj periudhe, Gjykata e Apelit ka vendosur lidhur me ankesat e palëve edhe në disa raste ku të përfshirë kishin qenë zyrtar të lartë publik. (Shih grafikat)



## 1. Rasti “MTPT”, Fatmir Limaj, etj.

• Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), kishte ngritur aktakuzën e konsoliduar më 28 shtator 2015, me anë të së cilës ishin bashkuar dy aktakuza të mëparshme të rasteve MTPT 1 dhe MTPT 2. Aktakuza e konsoliduar i ngarkonte të akuzuarit Fatmir Limaj, Endrit Shala, Nexhat Krasniqi për veprat penale krim i organizuar, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje ryshfeti, Shpëtim Telakun për veprat penale, krim i organizuar dhe keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe të akuzuarin e fundit, Florim Zukën, për veprat penale, dhënie ryshfeti dhe keqpërdorim i autorizimeve ekonomike.

Gjykata Themelore në Prishtinë, në nëntor 2017, i kishte liruar nga akuzat të gjithë të akuzuarit.

Këtë aktgjykim të shkallës së parë e kishte kundërshtuar, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e cila i kishte propozuar Gjykatës së Apelit ta anulojë aktgjykimin e Themelores dhe çështjen t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Mirëpo, këto pretendime të PSRK-së i kishte hedhur poshtë si të pabazuara gjykata e shkallës së dytë, më 30 maj 2019.

Sipas vendimit të Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë dhe as që ka shkelje tjera të cilat Apeli, si instancë e dytë i shqyrton detyrimisht, e të cilat kishin për ta kushtëzuar anulimin e tij. Po ashtu, Apelit kishte vlerësuar se edhe gjendja faktike në këtë rast ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.



## 2. Rasti “Stenta 1”, Ferid Agani dhe Gani Shabani

• Prokuroria e Shtetit, më 15 qershor 2016, kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, sekretarit të përgjithshëm të MSh, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrje e ryshfetit”, “dhënie e ryshfetit”, “trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe “shmangia nga tatimi”.

Ky rast, në shkurt të vitit 2018, ishte veçuar nga kryetarja e trupit gjykues në shkallë të parë, ashtu që Agani dhe Shabani janë gjykuar veçmas, kurse për të akuzuarit tjerë janë duke u zhvilluar dy procedura tjera, në rastet që njihen si “Stenta 2” dhe “Stenta 3”.

Agani dhe Shabani akuzohen se kishin keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare me rastin e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me spitalet private, si dhe me ndarjen e mjeteve për pacientët që ishin trajtuar në këto spitale.

Lidhur me këto akuza, Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 prill 2019 kishte shpallur fajtor ish-ministrin e Shëndetësisë, Ferid Agani dhe ish-sekretarin e kësaj ministrie, Gani Shabani, për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Agani ishte dënuar me 2 vjet e 6 muaj burg, kurse Shabani, me 2 vjet burg.

Ankesë kundër aktgjykimit të Themelores, kishin bërë PSRK dhe mbrojtësit e të akuzuarve.

Duke vendosur lidhur me pretendime ankimore, GjA e kishte anuluar aktgjykimin e Themelores dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim në shkallë të parë. Sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e po ashtu edhe gjendja faktike është vërtetuar mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, për çka kishte vlerësua se duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.



### 3. Rasti i ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota

- Aktakuza në këtë rast ishte ngritur nga Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), më 4 gusht 2016. Sipas kësaj aktakuze, Sokol Bashota, Enver Berisha, Esat Rraci dhe Fadil Gashi akuzoheshin për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje. Bashota dhe Berisha akuzohen edhe për mos raportim apo raportim të rremë të pasurisë, të ardhurave, dhuratave, apo dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare.

Gjykata Themelore në Pejë, ndaj Bashotës dhe Berishës. Rracit dhe Gashit kishte shpallur aktgjykim refuzues për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pasi prokurorja e rastit, Sahide Gashi kishte hequr dorë nga ndjekja penale për këtë vepër penale.

Kurse, Bashota ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë, pasi ishte shpallur fajtor për mos deklarim apo deklarim të rremë të pasurisë.

Mirëpo, dënimi me burgim ndaj tij nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti, kurse dënimin me gjobë, detyrohet ta paguajë brenda 15 ditësh.

Edhe ish-nënkryetari i kësaj komune, Enver Berisha, ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë në GjA kishte bërë prokuroria e cila kishte kërkuar dënime më të larta për të akuzuarit si dhe shqiptimin e dënimeve plotësuere, konkretisht, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Ankesa në GjA kishin bërë edhe mbrojtësit e Bashotës dhe Gashit, të cili kishin kërkuar lirimin nga akuzat së të mbrojturve të tyre ose kthimin e rastit në rigjykim.

GjA, më 22 tetor 2019, kishte aprovuar ankesën e mbrojtësve së të akuzuarve dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim në shkallë të parë.

Gjykata e Apelit, kishte konsideruar se aktgjykimi i shkallës së parë, i shpallur është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.





#### **4. Rasti i ish-kryetarit të Komunës së Lipjanit, Shukri Buja**

- PSRK kishte ngritur aktakuzë në këtë rast më 13 shkurt 2017, sipas së cilës, Buja dhe tetë zyrtarë tjerë të Komunës së Lipjanit akuzoheshin për korrupsion, ndërsa, biznesmeni Fahri Retkoceri akuzohej edhe për punë ndërtimore të kundërligjshme.

Në nëntor të vitit 2018 ish-kryetari i Komunës së Lipjanit, Shukri Buja ishte dënuar me tre vjet burg efektiv për keqpërdorim të pozitës zyrtare në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje.

Për keqpërdorim të pozitës zyrtare, fajtorë ishin shpallur edhe të akuzuarit e tjerë në këtë rast, Nebih Zeqiri, i cili ishte dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim, Halit Gashi me gjashtë muaj burgim, Edmond Rexhepi është dënuar me gjashtë muaj burgim, Bajram Rizani me gjashtë muaj burgim, kurse Hasim Vishesella ishte shpallur fajtor për marrje ryshfeti dhe ishte dënuar me pesë muaj burgim.

Ndërsa, ishin liruar nga akuza, Magbule Sadiku, Burim Kodra si dhe Driton Avdiu, kurse ndaj biznesmenit Fahri Retkoceri, aktgjykim liruës ishte marrë për veprën penale, “Punimet ndërtimore të kundërligjshme”, kurse aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit, ishte marrë për veprën penale të dhënies së ryshfetit.

Ankesë kundër këtij vendimi në shkallën e dytë, kishin bërë PSRK dhe mbrojtësit e të dënuarve, me ç’rast, më 12 qershor 2019, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të aprovojë ankesat ashtu që kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim.



## 5. Rasti i ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Etem Arifi etj.

- Prokuroria Themelore në Prishtinë e akuzonte deputetin Etem Arifi se kishte shfrytëzuar pozitën e tij të deputetit për të ndikuar për dhënien e subvencioneve për OJQ-në “Zëri i Ashkalinjëve për Integrim”, duke siguruar në këtë mënyre shumën prej 25,646.00 euro. Këto para, sipas prokurorisë, nuk janë përdorur për qëllime për të cilat janë dhënë, por janë përvetësuar nga Arifi dhe Gashi për persona të tjerë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 20 prill 2018, e kishte dënuar me dy vjet burgim me kusht, ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë së Ashkalinjëve për Integrim, Etem Arifi, pasi e kishte shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit me subvencione. Me dy vjet burgim me kusht, për të njëjtën veprë penale ishte dënuar edhe i akuzuari tjetër në këtë rast, Bajram Gashi. Por, dënimi ndaj tyre, nuk do të ekzekutohej nëse ata nuk kryejnë vepra penale brenda periudhës tre vjeçare.

Etem Arifi, për ushtrim të ndikimit ishte liruar nga akuza, pasi sipas shkallës së parë, nuk është provuar se i njëjti ka kryer këtë veprë penale.

Të akuzuarit ishin obliguar që Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) t’ia kompensojnë shumën prej 22,900 euro si dhe Zyrës për Komunitete në Kryeministri shumën prej 2,749 euro.

Këtë aktgjykim të Themelores, e kishte ndryshuar shkalla e dytë pasi që kishte aprovuar si të bazuar ankesën e organit të akuzës. Gjykata e Apelit, më 28 mars 2019, ia kishte ashpërsuar dënimin Arifit, për veprën penale të mashtrimit me subvencione, duke e dënuar me një vit e tre muaj burgim efektiv. Po ashtu, shkalla e dytë ia kishte ashpërsuar dënimin edhe të akuzuarit tjetër në këtë rast, Bajram Gashi, duke e gjykuar të njëjtin me një vit burgim efektiv, për dallim nga shkalla e parë e cila e kishte dënuar Gashin me dy vjet burg me kusht për veprën penale të mashtrimit me subvencione. Gjykata e shkallës së dytë, i kishte obliguar që të dy të akuzuarit, që t’ia kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në emër të dëmit të shkaktuar shumën prej 22,900 euro kurse Zyrës së Kryeministrit, shumën prej 2,749 euro. Gjithashtu, Apeli e kishte anuluar aktgjykimin e Themelores për sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit për çka deputeti Arifi ishte liruar nga akuzat nga shkalla e parë, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Mirëpo, këtë aktgjykim të Apelit e kishte anuluar Gjykata Supreme më 20 qershor 2019, me arsyetimin se e njëjta gjykatëse që kishte vendosur lidhur me ankesat në fazën e konfirmimit të aktakuzës, kishte marr pjesë edhe në kolegjin që e kishte nxjerr aktgjykimin në këtë lëndë. Pas kthimit në rivendosje në GjA, një kolegji tashmë i ri i Apelit, kishte vendosur në mënyrë identike sikurse herën e parë, ashtu që, deputetin Arifi ia kishte rritur dënimin në 1 vjet e 3 muaj burg për mashtrim me subvencione kurse e kishte kthyer në rigjykim në shkallë të parë për ushtrim të ndikimit. Edhe sa i përket të akuzuarit Gashi, vendimi i GjA-së kishte qenë i njëjtë sikurse herën e parë.



## 6. Rasti ish-krerëve të Agjencisë së Akreditimit

- Aktakuza e Prokurorisë Speciale ngarkonte Basri Mujën, Ferdije Zhushi – Etemin dhe Armend Mujën për shpërdorim të pozitës zyrtare, me pretendimin se i kanë shkaktuar dëm në shumën prej 2,500.000 euro, kolegjit “Biomedica” për akreditimin e katër programeve. Tutje sipas aktakuzës i akuzuari Basri Muja për mos tërheqje të akreditimit për kolegjin në fjalë, ka kërkuar 50.000.00 euro për vitin e parë, 150.000.00 për vitin e dytë, ndërsa për vitin e tretë 50:50 nga fitimi. Prokuroria pretendonte se të pandehurit Muja dhe Zhushi – Etemi i kanë shkaktuar dëm edhe Kolegjit “ISPE”, në atë mënyrë që kanë kërkuar përfitim me të holla për akreditimin e programeve. Në fillim kanë kërkuar përfitim prej 10.000.00 euro për një program, ndërkaq gjatë vitit 2011 kanë kërkuar shumën prej 20.000.00 eurove.

Bazuar në aktakuzë, të njëjtit në bashkëryerje ngarkohen edhe për marrje ryshfeti, meqenëse për akreditimin e programeve të Kolegjit “Universum” kanë përfituar shumën prej 35.000.00 euro.

Lidhur me këto akuza, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 29 janar 2019 i kishte liruar pika të akuzës, Basri dhe Armend Mujën si dhe Ferdije Zhushi-Etemi, kurse për disa pika të tjera kishte marr aktgjykim refuzues.

Këtë aktgjykim, më 26 gusht 2019 e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. Apeli i kishte hudhur poshtë pretendimet që Prokuroria Speciale i kishte bërë në ankesën e saj, duke vlerësuar se aktgjykimi i Themelores kishte vërtetuar drejtë gjendjen faktike.

- **Trajtimi rasteve të korrupsionit në fazën e konfirmimit/hudhjes së aktakuzave**

Punë me raste të profilit të lartë, Apeli kishte pasur edhe në fazën e konfirmimit të aktakuzës. Gjatë kësaj periudhe, kjo gjykatë kishte lënë në fuqi aktakuzat e ngritura për korrupsion në rastet e ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës, **Pal Lekaj**, ish-kryetarit të Komunës së Gjilanit, **Qemajl Mustafa**, ish-kryetarit të Komunës së Suharekës, **Sali Asllanaj**, Kryetarit të Komunës së Istogut, **Haki Rugova** dhe ish-kryetarit të Komunës së Drenasit, **Nexhat Demaku**.

Gjithashtu, Apeli i kishte refuzuar ankesat e të akuzuarve dhe e kishte lënë në fuqi edhe në rastin e njohur si “Veteranët”, ku të akuzuar për korrupsion janë, **Nuredin Lushtaku**, **Sadik Halitjaha**, **Shkumbin Demaliaj**, **Qelë Gashi**, **Shukri Buja**, **Ahmet Daku**, **Rrustem Berisha**, **Faik Fazliu**, **Smajl Elezaj**, **Fadil Shurdhaj** dhe **Xhavit Jashari**.

Po ashtu, gjatë vitit 2019, Apeli e kishte përmbysur vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila qysh në fazën fillestare e kishte hudhur poshtë aktakuzën ndaj ndaj ish-shefave të Telekomit të Kosovës, **Agron Mustafa**, **Ejup Qerimi** dhe **Rexhë Gjonbalaj**, duke e udhëzuar shkallën e parë që në këtë rast të procedojë me gjykimin e të akuzuarve.

- **Vërtetimi i aktgjykimeve liruese dhe dënuese**

### Vërtetim i aktgjykimeve liruese

Gjykata e Apelit, gjatë vitit 2019, i kishte liruar përfundimisht nga akuzat për korrupsion edhe dy zyrtarët e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), **Tefik Sylejmani** dhe **Ekrem Salihu**, pastaj ish-drejtorin e Pallatit të Rinisë, **Bajram Uka**, i cili akuzohej për keqpërdorim të pozitës zyrtare, inspektoren e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), **Violeta Januzi** dhe udhëheqësen e Zyrës së Prokurimit në Spitalin Rajonal “Dr.Sami Haxhibeqiri”, në Mitrovicë, **Zylfije Halilin**.

Gjykata e Apelit e kishte vërtetuar pafajësinë edhe të ish-policit të akuzuar për ndërhyrje në tiketat kundërvajtëse, **Lulzim Gashi**. Gjykata Themelore në Prishtinë, më 31 maj 2019, e kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës apo autoritet zyrtar Gashin, me arsyetimin se nuk ishte arritur të vërtetohet se ai ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Këtë vendim të Themelores e kishte vërtetuar edhe Apelit duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Gjykata e Apelit i kishte liruar përfundimisht nga akuzat për përvetësim në detyra edhe ish-punëtorët e kompanisë “Buçaj”, **Ekrem Zagragaj**, **Faton Llazani**, **Idriz Shala** dhe **Liridon Vitija**.

Kësisoj, shkalla e dytë e kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e cila kishte kërkuar ndryshimin e aktgjykimit të Themelores dhe dënimin e të akuzuarve apo kthimin e rastit në rigjykim.

Gjatë vitit 2019, Gjykatës së Apelit i është dashur që në të paktën dy raste të korrupsionit të vendos për të tretën herë. Kështu, pasi kishin kaluar më shumë se 10 vjet nga koha kur prokuroria pretendonte se ish-anëtari i Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidrodrini”, në Pejë, **Elez Hajdaraj** kishte kryer veprën penale të përvetësimit në detyrë, Gjykata e Apelit, në gusht të 2019, kishte ardhur në përfundim se kjo veprë tashmë është parashkruar. Për këtë arsye, Apeli kishte vendosur që të refuzojë akuzën për këtë veprë ndaj Hajdarajt, kurse, shkalla e dytë e kishte refuzuar edhe ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë për sa i përket veprës tjetër penale që akuzohej Hajdaraj, atë të frikësimit gjatë procedurës penale duke e liruar kështu përfundimisht nga kjo akuzë të akuzuarin.

Në rastin e ish-zyrtarin e prokurimit në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave (KRM) “Pastërtia” në Ferizaj, **Ilir Beqiri**, Gjykata e Apelit kishte vendosur për herë të tretë në janar të vitit 2019, sipas të cilit vendim Beqiri ishte liruar nga akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Beqiri ishte shpallur dy herë fajtor nga Gjykata Themelore në Ferizaj, mirëpo që të dy herët, lënda ishte kthyer në rigjykim, deri sa më 25 shtator 2018, shkalla e parë e kishte liruar në mungesë të provave Beqirin, vendim i cili ishte vërtetuar pastaj edhe nga Apeli.

### Vërtetim i aktgjykimeve dënuese

Në prill të vitit 2019, Gjykata e Apelit ua kishte vërtetuar dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë drejtorit të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, **Ahmet Asllani** si dhe **Adnan Brovinës, Skender Ndrecajt, Mirlinda Mullahasani, Mentor Bytyqi dhe Kumrije Kameri** që akuzoheshin lidhur me një tender për furnizim me uniforma të këtij spitali.

Në qershor 2019, GjA e kishte vërtetuar edhe dënimin prej nëntë muaj burgim efektiv dhe 2000 euro gjobë, për ish-drejtorin e repartit të Urologjisë në QKUK, **Rexhep Kasumajn**.

Gjykata e Apelit po ashtu kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin ish-zyrtari i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), **Taulant Tahirsylaj**, ishte shpallur fajtor për veprë penale të korrupsionit.

Ai akuzohej se gjatë periudhës 13 maj 2015, e deri më 2 tetor 2015, derisa kompania NSH “Tregu”, ishte në likuidim, nga arka e kësaj kompanie ka tërhequr mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 11.000 euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 6 qershor 2019, e kishte shpallur atë fajtor dhe ndaj tij

kishte shqiptuar dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 10 muajsh.

I pakënaqur me aktgjykimin e shkallës së parë kishte qenë i dënuari Tahirsylaj, i cili brenda afatit ligjor kishte ushtruar ankesë, mbi pretendimin se mjetet i kishte marr për t'i ruajtur.

Por, ankesa e tij është refuzuar si e pabazuar, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, të marr më 6 nëntor 2019.

- **Rigjykim/Ndryshim i aktgjytimeve të shkallës së parë**

Në prill 2019, duke vendosur në një lëndë të shënjestruar për viza, siç është rasti “Kohler”, GjA e kishte ndryshuar aktgjykimin dënues të shkallës së parë, duke e liruar të akuzuarin **Avni Alidemaj**. Ky i fundit, ishte dënuar me gjashtë muaj burg me kusht nga shkalla e parë. Për të akuzuarën tjetër, **Vjollca Ajvazi**, e cila po ashtu ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht, Apeli e kishte kthyer lëndën në rigjykim.

Në fillim të vitit 2019, Gjykata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim rastin e ish-gjykatëses së Gjykatës Themelore në Pejë, degë Deçan, **Safete Tolaj**, djalit të saj, **Fisnik Tolajt** dhe zyrtarit policor, **Granit Shehaj**, që akuzoheshin për korrupsion.

Në vendimin e Apelit thuhej se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, për pjesën dënuese dhe liruese, për tre të akuzuarit, ku përfshihen veprat penale “ushtrimi i ndikimit në vazhdim”, “falsifikimi i dokumenteve”, “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare, apo shkresave zyrtare” dhe “ushtrimi i ndikimit në ndihmë”, është anuluar dhe çështja penale i kthehet gjykatës se shkallës së parë në rigjykim dhe vendim, pasi që, sipas Apelit, aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave esenciale të procedurës penale.

Kurse, sipas vendimit të Apelit, sa i përket pjesës refuzuese që ka të bëjë vetëm me veprën penale “mbajtja në pronësi në kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve” për të akuzuarin Fisnik Tolaj, aktgjykimi është vërtetuar.

Po ashtu, në rigjykim nga GjA ishte kthyer edhe rasti i ish-zëvendësministrit të Administratës Publike, **Bujar Nerjovaj**. Ky i fundit ishte dënuar me 6 muaj burg me kusht nga Gjykata Themelore në Prizren, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Akuza kishte me veprimet që Nerjovaj kishte bërë gjatë kohës sa kishte qenë Drejtor i Drejtorisë Komunale të Inspektorëve në Komuën e Prizrenit.

Apeli kishte vendosur për herë të dytë lidhur me ankesat e palëve edhe në rastin e njohur si “Kontrata”, ku të akuzuar për mashtrim në detyrë janë, **Hakif Veliun dhe Albert Rakipin**.

Herën e parë, Apeli kishte vendosur për këtë rast më 2 maj 2018, me ç'rast Veliu dhe Rakipi ishin dënuar me nga një vit burg efektiv për veprën penale të “mashttrimit në detyrë”, për dallim nga shkalla e parë e cila dy të akuzuarit i kishte gjykuar me nga gjashtë muaj burg me mundësi të zëvendësimit me gjobë prej 10 mijë eurove, secili veç e veç.

Mirëpo, kjo çështje ishte kthyer më pas në rivendosje nga Gjykata Supreme, por, më 16 prill 2019, Apeli kishte marrë sërish vendim të njëjtë sikurse herën e parë, ashtu që Veliu dhe Rakipi ishin dënuar përsëri me nga një vit burg efektiv.

Në këtë rast kishte qenë i përfshirë edhe ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, mirëpo i njëjti ishte liruar nga Apeli në maj 2018, vendim i cili ishte konfirmuar pastaj edhe nga Gjykata Supreme.

Gjatë vitit 2019, në rigjykim janë kthyer edhe rasti i inspektorit të Komunës së Kamenicës, **Sadullah Dërmaku**, i cili dy herë ishte shpallur fajtor nga shkalla e parë, por që të herët, aktgjykimet janë anuluar nga Apeli dhe lënda aktualisht është duke u trajtuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan për herën e tretë.

Në rigjykim, Apeli e kishte kthyer edhe rastin e ish-drejtoreshës së Arsimit në Komunën e Mitrovicës, **Ajmane Barani**. e cila paraprakisht, ishte shpallur e pafajshme nga ana e Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Gjykata e Apelit e kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka kthyer në rigjykim rastin ndaj zyrtarëve të Komunës së Prishtinës, **Shiqeri Spahiu, Ramush Thaqi dhe Doruntina Peqani**, të akuzuar për keqpërdorim detyre. Në këtë rast, për veprën penale të mashtimit akuzohet edhe **Naim Dushku**.

Ata akuzohen se duke qenë në cilësinë e zyrtarëve të Drejtorisë së Kadastrës në Komunën e Prishtinës, kishin shfrytëzuar pozitën apo autoritetin zyrtar me qëllim që t'i sjellin përfitim pasuror të pandehurit Naim Dushku.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 22 shkurt 2019, në mungesë të provave i kishte liruar nga akuza për keqpërdorim detyre, zyrtarët e Komunës së Prishtinës, Shiqeri Spahiu, Ramush Thaqi dhe Doruntina Peqani.

Ndërsa, e kishte shpallur fajtor për veprën penale të mashtimit, Naim Dushkun, ndaj të cilit kishte shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej dy vjetësh dhe dënim me gjobë, në shumë prej 3000 euro.

Në aktvendimin e Gjykatës së Apelit, thuhet se janë të bazuara pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nga arsyeja se përkundër se gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat, të njëjtat nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Në maj 2019, Gjykata e Apelit ua kishte zbutur dënime 15 prej 20 zyrtarëve të Policisë së Kosovës, që ishin dënuar për marrje ryshfeti nga Gjykata Themelore në Prizren, në janar të vitit 2018.

Nga kjo zbritje e dënimeve kishin përfituar të akuzuarit, **Shemsi Demolli, Safet Veliu, Naser Rama, Ivica Djokiç, Ismail Azemi, Blerim Zylfaj, Bekim Zogaj, Qerim Beqiri, Azem Goxhufi, , Sasha Nedeljkovic, Shaban Gerguri, Lulzim Gashi, Shefki Zeka dhe Muhamet Buzhala dhe Alush Elshani.**

Kurse, gjykata e shkallës së dytë kishte vendosur që t'i refuzoj ankesat e ushtruara nga të akuzuarit **Ardian Rrecaj, Shemsi Zejnullahu, Aziz Krasniqi, Nuhi Zogaj dhe Afrim Rafuna.**

Në mars 2019, Gjykata e Apelit ua kishte përgjysmuar dënimet me gjobë edhe ish-zyrtarëve të Policisë së Kosovës, **Neshat Avdaj, Driton Bajrami, Myzafer Sylejmani dhe Binak Bytyqi,** të dënuar nga shkalla e parë për marrje ryshfeti.



## IX. Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Supreme

Instituti i Kosovës për Drejtësi, gjatë vitit 2019, ka monitoruar edhe Gjykatën Supreme, me ç'rast kjo e fundit kishte vendosur në disa raste të korrupsionit, ku përfshihen edhe zyrtar të profilit të lartë.

Duke qenë se Gjykata Supreme nuk mban seanca publike, përveç në rastet kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të GjTh dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin, si dhe në rastet e shqiptimit të dënimeve maksimale apo dënimeve me burg të përjetshëm, monitorimi i Gjykatës Supreme është fokusuar më shumë në analizimin e vendimeve dhe mendimeve juridike të nxjerra nga Supremja.

Në disa raste që IKD ka monitoruar gjatë kësaj periudhe, shihet se Gjykata Supreme kishte konstatuar shkelje që kishin bërë instancat më ulëta të gjyqësorit në favor të akuzuarve për korrupsion, por në pamundësi ligjore që të njëjtat t'i kthej në rigjykim, Supremja vetëm i kishte konstatuar shkeljet në fjalë.

Kjo, pasi sipas nenit 438, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.



Gjykata Supreme e kishte pranuar si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në rastin e ish-drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Gjilanit, **Valon Shefkriu**, shefit të inspeksionit të ndërtimit, **Milot Shkodra**, inspektorëve **Baki Azemi** e **Bahrije Beqiri**, si dhe të akuzuarit për heqje ose dëmtim të vulave zyrtare ose shenjave, **Abdyl Brestovci**.

Përveç, të akuzuarit Azemi, të gjithë të akuzuarit tjerë ishin liruar nga akuzat nga Gjykata Themelore në Gjilan, aktgjykim i cili ishte vërtetuar pastaj edhe Gjykata e Apelit.

Mirëpo, kolegji i Gjykatës Supreme, në përbërje nga gjykatësit, Valdete Daka, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, ka konstatuar se shkalla e parë dhe e dytë, me rastin e vendosjes për këta të akuzuar, kishin shkelur ligjin në favor të të akuzuarve.

Ndërsa, sa i përket të akuzuarit Baki Azemi, Supremja ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së paraqitur nga mbrojtja e tij.



Më 21 janar 2019, kolegji i Gjykatës Supreme me përbërje të gjykatësve, Valdete Daka, Nesrin Lushta dhe Agim Maliqi kishte nxjerr një aktgjykim me të cilin kishte konstatuar se aktgjykimet e GjTh në Prishtinë dhe asaj të Apelit, në rastin e ish-kryetarit të Komunës së Obiliqit, **Mehmet Krasniqi**, për sa i përket pjesës liruese, ishin marr me shkelje esenciale të dispozitave procedurale.

Kurse sa i përket pjesës gjyquese të aktgjykimeve në fjalë, Supremja e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga ana e Prokurorit të Shtetit.

Në maj të vitit 2017, GjTh në Prishtinë, në mungesë të provave kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-kryetarin e Komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi si dhe zyrtarët e komunës në fjalë **Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Nazmi Gashi, Ramadan Hashanin, Bajram Palojin, Azem Spancën** dhe **Altin Preniqin** kurse **Hasnije Dushi** ishte liruar nga akuza për mashtrim në detyrë.

Ndërkaq, ndaj të akuzuarve për mashtrim, **Emir Sopjanit** dhe **Sami Kadriut**, gjykata kishte shpallur aktgjykim dënues, duke iu shqiptuar dënimin me nga 1 vit e 6 muaj burgim me kusht kurse **Bujar Alidema** dhe **Shpend Kelmendi** ishin dënuar me nga 2 vite burgim me kusht dhe 4,000 euro gjobë si dhe **Basri Kqiku** ishte dënuar me 1 vit burgim me kusht dhe 3,000 euro gjobë. Ky vendim pastaj ishte vërtetuar edhe nga Apeli.

Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Supreme kishte paraqitur Prokurori i Shtetit i cili aktgjykimet e dy instancave më të ulëta të gjyqësorit i kishte atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, dhe i kishte propozuar Gjykatës Supreme që të konstatojë se aktgjykimet në fjalë ishin marr me shkelje.

Duke aprovuar pjesërisht këtë kërkesë të Prokurorit të Shtetit, Supremja kishte konstatuar se shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në rastin konkret konsiston në dhënien e arsyeve të paqarta për faktet vendimtare e sidomos me dashjen e të dënuarve për kryerjen e veprave penale për të cilët janë liruar nga akuza.

Duke qenë se shkeljet në këtë rast të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të Apelit kishin shkuar në favor të akuzuarve, Gjykata Supreme vetëm kishte konstatuar shkeljet në fjalë pa pasur mundësi që rastin ta kthejë në rigjykim.



Gjykata Supreme, më 1 prill 2019, kishte konstatuar shkelje edhe në rastin e njohur si “Sekseri”, ku ish-drejtori i Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, **Emin Beqiri** akuzohej për keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, pengim i të provuarit dhe moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre, ndërsa **Rrahim Hashimi** akuzohej për ushtrim të ndikimi dhe mashtrim.

GjTh në Prishtinë, në qershor 2018 kishte refuzuar ankesat e të akuzuarve në fjalë të cilët kishin kërkuar hudhjen poshtë të aktakuzës. Pas ankesave që kishin bërë mbrojtësit e të akuzuarve në Apel, kjo e fundit e kishte hudhur poshtë akuzën dhe kishte pushuar procedurën penale sa i përket të akuzuarit Beqiri kurse kishte kthyer në rivendosje sa i përket të akuzuarit Hashimi. Pas rivendosjes, shkalla e parë sërish e kishte konfirmuar akuzën për Hashimin, mirëpo, pas ankesës së mbrojtësit të tij, Apeli e kishte pushuar procedurën penale për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, kurse e kishte refuzuar ankesën e mbrojtjes për veprën penale të mashtrimit.

Kundër këtyre aktvendime Prokurori i Shtetit kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme të konstatoj se aktvendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës përmbajnë shkelje të dispozitave e të procedurës penale si dhe shkelje të ligjit penal, apo çështja të kthehet në rivendosje.

E këtë kërkesë të Prokurorit të Shtetit e kishte aprovuar si të bazuar, kolegji i Supremes në përbërje të gjykatësve Agim Maliqi, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi. sipas të cilëve, me të gjitha provat e dorëzuara nga prokuroria, të cilat janë në përputhje me njëra tjetrën, Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim të gabuar kur ka konstatuar se nuk ka pasur asnjë provë e cila ka involvuar Emin Beqirin në veprat penale për të cilat është akuzuar.

Sipas Supremes, gjykata e shkallës së dytë duke e marrë rolin e gjykatës së shkallës së parë ka pamundësuar që të vërtetohet apo jo fajësia e të pandehurve si dhe vërtetësia apo jo e provave të paraqitura nga prokuroria, e duke i vlerësuar vet provat, edhe pse në mesin e këtyre provave ka pasur prova të cilat e kanë mbështetur dyshimin e bazuar mirë se këta i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar.



Gjykata Supreme, përkatësisht kolegji i përbërë nga gjykatësit Agim Maliqi, Nesrin Lushta dhe Rasim Rasimi, më 5 qershor 2019, kishte nxjerr aktgjykim me të cilin kishte konstatuar se aktgjykimet e GjTh në Prishtinë dhe asaj të Apelit, në rastin e ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit, **Salih Mekaj** ishin marr me shkelje të ligjit penal.

Supremja kishte konstatuar se shkeljet në fjalë kishin të bënin sa i përket të akuzuarit Mekaj për veprën penale të ushtrimit të ndikimit dhe për të akuzuarën Vlora Gorani, për veprën penale të shtytjes në ushtrimit të ndikimit, kurse ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës e ushtruar kundër këtyre aktgjykimeve, për sa i përket të akuzuarve **Vlora Gorani, Mentor Seferaj dhe Ali Seferaj** në pjesën që ka të bëjë me të pandehurit për veprën penale dhënia e ryshfetit në tentativë.

Të gjithë këta të akuzuar ishin liruar nga akuzat për të cilat ngarkoheshin nga GjTh në Prishtinë, në maj 2018, kurse aktgjykimi lirues ishte vërtetuar pastaj edhe nga ana e Gjykatës së Apelit, në tetor 2018.

Sipas Supremes, shkalla e parë dhe ajo e dytë në aktgjykimet e veta në mënyrë të drejtë dhe të plotë kanë vërtetuar faktet vendimtare të çështjes konkrete por me lirimin e të akuzuarve, Mekaj dhe Goranit kanë nxjerr përfundimeve të gabuara për ekzistimin e veprës penale, që paraqet shkelje të ligjit penal sepse kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal, sipas Supremes, Mekaj do duhej të shpallej fajtor për veprën që është objekt i akuzës.

Veprimet e Mekajt, sipas Supremes, sipas fakteve të cekura në aktgjykim, paraqesin ushtrim të ndikimit, duke qenë se shkas për bisedat m gjyqtaren L.M, ka qenë lidhja e Mekajt me Goranit e cila nuk ka ekzistuar me herët por ka ndodhur pasi Goranit kishte shkuar për tu interesuar për lëndën e bashkëshortit të saj që akuzohej për një vepër penale. Sipas Supremes, pa iniciativën e Goranit, i pandehuri Mekaj, nuk ka filluar bisedat me gjyqtaren, së paku nga provat e nxjerra nuk del se më parë, ka filluar këto biseda.

Në vendimin e saj, Supremja thekson se fakti se nuk ka pasur sukses gjegjësisht ndikimi nga Mekaj nuk ka arritur rezultatin e synuar nuk e ndryshon pozitën juridiko penale e të pandehurit, siç parashihet me dispozitën e nenit 431.par.1 të KPK.

Edhe në këtë rast, meqenëse shkeljet ishin bërë në dobi të akuzuarve, Supremja vetëm kishte konstatuar shkeljet pa pasur mundësi që rastin ta kthej në rigjykim.



Në qershor 2019, Gjykata Supreme e kishte kthyer në rivendosje rastin e deputetit të Kuvendit të Kosovës, **Etem Arifi** i cili akuzohet për veprat penale të mashtrimit me subvencione dhe ushtrim të ndikimit si dhe të akuzuarit **Bajram Gashi**, i cili akuzohej për mashtrim me subvencione.

Supremja e kishte anuluar vendimin e marrë në mars 2019 nga ana e Gjykatës së Apelit me të cilin ish-deputeti Arifi dhe i akuzuari Gashi, ishin dënuar me burg efektiv për veprën penale të mashtrimit me subvencione, kurse ishte vendosur të rigjykohej për veprën penale të ushtrimit të ndikimit.

Sipas vendimit të Gjykatës Supreme, kolegji i Gjykatës së Apelit që kishte nxjerr aktgjykimin në fjalë, kishte pasur në përbërje edhe një gjykatëse e cila kishte qenë pjesë e kolegjit të Apelit edhe në fazën e konfirmimit të aktakuzës gjë e cila është në kundërshtim me nenin 39, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili ndër të tjera ka paraparë se një gjyqtar përjashtohet në rast se ka marr pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal.



Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar shkelje edhe në rastin e lirimimit nga akuzat për marrje të ryshfetit, me të cilën ngarkohej inspektori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), **Lulzim Çitaku**.

Nga një akuzë e tillë, ai ishte liruar nga GjTh në Pejë, e më pas pafajësinë ia kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, por, Supremja ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë, kanë shkelur ligjin penal, duke vepruar në favor të inspektorit Çitaku.

Gjykata Supreme një konstatim të tillë e ka dhënë më 11 korrik të këtij viti, pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që e ka paraqitur prokurorja Sahide Gashi, pas aktgjykimeve të Themelores e Apelit.

Sipas Supremes, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë në aktgjykimet e veta, me lirimimin e të pandehurit sa i përket veprës penale të marrjes së ryshfetit kanë nxjerrë përfundime të gabuara për ekzistimin e saj dhe kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal ai do të shpallej fajtor për veprën penale që ishte objekt i akuzës.

## X. Aneks: Analizë e veçantë e trajtimit të rasteve të profilit të lartë të korrupsionit

IKD ka analizuar të gjitha rastet e korrupsionit, të cilat konsiderohen të jenë të profilit të lartë, duke përkrahur një shpjegim tyre bazuar në aktakuzat e prokurorive përkatëse dhe duke prezantuar gjetjet e monitoruesve.

Në fokus të analizës është respektimi i afateve ligjore, nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK)<sup>32</sup>.

Neni 242 i KPPRK-së, në pikën 4, përcakton se: *“Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”*.

Neni 245 i KPPRK-së, në pikën 5, përcakton se: *“Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”*.

Neni 285 i KPPRK-së, në pikën 2, përcakton se: *“Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5. i këtij Kodi.”*

Neni 314 i KPPRK-së, në pikën 1, përcakton se: *“Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: 1.1. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni; 1.2. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindnjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni.”*

---

<sup>32</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

- **Rasti i kryetarit të Komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanoviq**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Gjilan
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.238/18
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Naser Maliqi
<b>Prokuror:</b>	Fillimisht Arben Kadriu
<b>I pandehur:</b>	Svetislav Ivanoviq
<b>Vepra penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 393 ditë**



Një qytetar, më 16 maj 2018, kishte parashtruar kallëzim penal ndaj kryetarit të Novobërdës Svetislav Ivanoviq, duke pretenduar se i njëjti e ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare. Prokuroria Themelore në Gjilan, më 26 tetor 2018 kishte filluar hetimet, ndërsa më 4 dhjetor 2018 kjo prokurori kishte ngritur aktakuzë ndaj Ivanoviqit, duke e ngarkuar atë me veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Sipas aktakuzës, pretendohet se më 15 nëntor 2017, në Novobërdë, i pandehuri si person zyrtar, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Novobërdës, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për personin tjetër juridik – Shoqatën e Gjuetarëve “Kalaja”, ka tejkalluar kompetencat e tij zyrtare dhe ka shkelur të drejtat e personit tjetër juridik – Shoqatës së Gjuetarëve “Ujku”, në atë mënyrë që shoqatës së lartpërmendur i ka dhënë në shfrytëzim dhe menaxhim tërë territorin e Komunës së Novobërdës dhe një zyre në objekt të kësaj komune.

Me një veprim të tillë, prokuroria pretendon se i njëjti i ka shkaktuar komunës dëm material në vlerë të përgjithshme prej 12.200,00 euro.

**Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Gjykata Themelore në Gjilan, më 25 janar 2019, apo 23 ditë pas afatit ligjor kishte caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilën seancë Ivanoviq ishte deklaruar i pafajshëm për pretendimet e prokurorisë.<sup>33</sup>

Pasi nuk ishte mbajtur shqyrtimi i dytë dhe ishte konfirmuar aktakuza ndaj tij, shqyrtimi gjyqësor ishte paraparë që të fillonte më 21 qershor 2019, por një gjë e tillë nuk ndodhi pasi në sallën e gjykimit nuk ishte paraqitur kryetari Ivanoviq, ndërsa kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Naser Maliqi, ndaj tij kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim.<sup>34</sup> Por gjykatësi po ashtu kishte thënë se nëse i akuzuari do ta arsyetonte mos ardhjen e tij, gjykata do ta tërheq urdhëresën për sjellje me dhunë.

Por edhe pse gjykatësi Maliqi, kishte thënë se ndaj të akuzuarit do të lëshohej një urdhëresë që ai të sillej në gjykatë me dhunë, kjo nuk kishte ndodhur, pasi Ivanoviq nuk mori pjesë as në seancën e 20 shtatorit 2019. Edhe në këtë seancë, Maliqi tha se do të lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim që për seancën e caktuar më 18 tetor ai të sjellët me dhunë në sallën e gjykimit.<sup>35</sup>

Kryetari i Novobërdës kishte vazhduar të mos i bindej ftesave të gjykatës, pasi ai nuk ishte paraqitur në gjykatë edhe në seancën e 18 tetorit 2019. Kryetari i trupit gjykues, Naser Maliqi kishte thënë se gjykata ka pranuar një kërkesë nga një zyrtar i Komunës së Novobërdës, për shtyrjen e kësaj seance, me arsyetimin se i akuzuari Ivanoviq gjendet i sëmurë në një ordinancë private në Prishtinë, ndërsa e kishte përsëritur edhe një herë kërkesën për sjellje me detyrim<sup>36</sup>.

Ivanoviq ishte paraqitur në sallë e gjykimit në seancën e 22 nëntorit, mirëpo ai kishte munguar përsëri në seancën e 16 dhjetorit, ndërsa mungesën fare nuk e kishte arsyetuar<sup>37</sup>.

Rasti i Ivanoviqit, është një shembull se si sistemi gjyqësor i trajton rastet e profilit të lartë, pasi gjykatësit në rastet e mosbindjes së palëve për t'iu përgjigjur ftesave të gjykatave, kur urdhëresat për sjellje me detyrim nuk rezultojnë të suksesshme, gjykata sipas nenit 307 të

---

<sup>33</sup> “Kryetari i Komunës së Novobërdës nuk e pranon fajësinë për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 25 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-komunes-se-novoberdes-nuk-e-pranon-fajesine-per-korrupsion/>)

<sup>34</sup> “Lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj kryetarit të Novobërdës që mungoi në gjykimin për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 21 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/leshohet-urdherese-per-sjellje-me-detyrim-ndaj-kryetarit-te-novoberdes-qe-mungoi-ne-gjykimin-per-korrupsion/>)

<sup>35</sup> “Sërish mungoi në seancë, lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj kryetarit të Novobërdës” Betimi për Drejtësi. 20 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-mungoi-ne-seance-leshohet-urdherese-per-sjellje-me-detyrim-ndaj-kryetarit-te-novoberdes/>)

<sup>36</sup> “Sërish mungoi në seancë, për herë të tretë lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj kryetarit të Novobërdës” Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/serish-mungoi-ne-seance-per-here-te-trete-leshohet-urdherese-per-sjellje-me-detyrim-ndaj-kryetarit-te-novoberdes/>)

<sup>37</sup> “Sërish mungon në seancë, për herë të katërt lëshohet urdhërarrest ndaj kryetarit të Novobërdës” Betimi për Drejtësi. 16 dhjetor 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/serish-mungon-ne-seance-per-here-te-katert-leshohet-urdherarrest-ndaj-kryetarit-te-novoberdes/>)



KPPRK-së, me qëllim që ta siguroj të akuzuarin në shqyrtimin gjyqësor, të njëjtit mund të ia caktoi masën e paraburgimit<sup>38</sup>.

**Dëmi i pretenduar:** 12,200.00 euro

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>38</sup> Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 187 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Për paraburgimin i cili është caktuar për këto shkaqe, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 185 deri 203 të këtij Kodi. Po qe se paraburgimi i tillë nuk hiqet më parë, ai zgjat derisa të shpallet aktgjykimi, por jo më shumë se një (1) muaj. KPPRK- Neni 307. par 2.

- **Rasti (1) i ish-kryetarit të Komunës së Klllokotit, Sasha Mirkoviq dhe një personi tjetër**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Gjilan
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.68/2019
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Agim Ademi
<b>Prokuror:</b>	Shaban Spahiu
<b>Të pandehur:</b>	Sasha Mirkoviq dhe Zharko Dejanoviq
<b>Vepra penale:</b>	“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Vërtetim i aktgjykimit lirues nga Gjykata e Apelit

- **Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, pas rigjykimit, kanë kaluar 945 ditë**



Si pasojë e një kallëzimi penal nga Komuna e Klllokotit, të 8 nëntorit 2016, që e ngarkonte ish-kryetarin e kësaj komune, Sasha Mirkoviq, për keqpërdorim të pozitës zyrtare, kishte shtyrë Prokurorinë Themelore në Gjilan, që të niste hetimet pas tetë ditësh. Këto hetime të prokurorisë rezultuan me një aktakuzë në të cilën, bashkë me Mirkoviqin, për veprën penale të “keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtarë” akuzohej edhe ish-kryetari i Kuvendit Komunal, Zharko Dejanoviq.

Sipas aktakuzës së ngritur më 20 dhjetor 2016, Sasha Mirkoviq, në cilësi të kryetarit të Komunës së Klllokotit dhe Zharko Dejanoviq, në cilësi të kryetarit të Kuvendit Komunal, akuzohen se me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe Dardan Novosellën, kanë tejkaluar kompetencat e tyre.

Në aktin akuzues, thuhet se me 22 shkurt 2012, pa i përfillur procedurat ligjore, kanë nxjerrë vendimin dhe kanë dhënë në shfrytëzim më qira një ngastër kadastrale për periudhë 10 vjeçare, konkretisht Qendrës për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim, “Nëna Naile”, me pronar Dardan Novosella, në shumën prej 550 euro për muaj, ndërsa për disa muaj nuk është

inkasuar asnjë pagesë nga qiraja, gjë e cila i ka shkaktuar dëm material buxhetit komunal në vlerë prej 7,700.00 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Gjykata Themelore në Gjilan, seancën fillestare të këtij rasti e kishte mbajtur pas 267 ditëve nga ngritja e aktakuzës, ku të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë. Pas nëntë seancave të caktuara, tri nga të cilat ishin shtyrë, më 29 nëntor 2018 kishte shpallur aktgjykimin me të cilin ishin liruar të dy të akuzuarit.<sup>39</sup>

Por pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit këtë rast e kishte kthyer në rigjykim, ndërsa në procesin e rigjykimit ishin mbajtur edhe pesë seanca të tjera pas të cilave më 23 korrik 2019 ishte marrë vendim i ngjashëm, si ai i herës së parë, duke liruar nga akuza si Mirkoviqin ashtu edhe Dejanoviqin.<sup>40</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 7,700 euro.

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>39</sup> “Ish-kryetari i Kllkotit dhe ish-kryesuesi i Kuvendit Komunal lirohen nga akuza për korrupsion (Video)” Betimi për Drejtësi. 29 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-kllkotit-dhe-ish-kryesuesi-i-kuvendit-komunal-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>)

<sup>40</sup> “Pas rigjykimit, ish-kryetari i Kllkotit dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal lirohen nga akuza për keqpërdorim detyre” Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-ish-kryetari-i-kllkotit-dhe-kryesuesi-i-kuvendit-komunal-lirohen-nga-akuza-per-keqperdorim-detyre/>)

- **Rasti (2) i ish-kryetarit të Komunës së Kllokotit, Sasha Mirkoviq dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Gjilan
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.174/2019
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Islam Thaçi
<b>Prokuror:</b>	Arben Kadriu
<b>Të pandehur:</b>	Sasha Mirkoviq, Zeqir Selimi, Strahinja Steviq, Nebahate Pira dhe Elbasan Alidema
<b>Vepra penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Rigjykim



- **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 1,471 ditë**

Pas kallëzimit penal, Prokuroria Themelore në Gjilan, më 16 dhjetor 2015, kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve, ndërsa pas pesë ditësh, më 22 dhjetor 2015, kishte ngritur aktakuzë ndaj ish-kryetarit të Komunës së Kllokotit, Sasha Mirkoviq, për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Pjesë e kësaj aktakuze ishin edhe zyrtarët e kësaj komune Zeqir Selimi, Strahinja Steviq dhe Nebahate Pira, si dhe biznesmeni Elbasan Alidemi.

Sipas aktakuzës, Mirkoviq në dhjetor të vitit 2012, në cilësinë e kryetarit të komunës, ka lejuar nënshkrimin e kontratës për shitblerje me kompaninë NTP “Metali”, për inventarin mobile për zyra, i cili asnjëherë nuk kishte arritur në objektet e komunës.

Ndërkaq, Zeqir Selimi, Strahinja Steviq dhe Nebahate Pira akuzohen që si anëtarë të komisionit për pranimin e inventarit të komunës, kanë nënshkruar përmbushjen e kontratës, edhe pse një gjë e tillë nuk kishte përfunduar, e gjithë kjo me qëllim që Ministria e

Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) të bëjë pagesën për kontratën e blerjes së inventarit nga NTP “Metali”, me çka Komuna e Klllokotit është dëmtuar në vlerë prej 29,330.00 euro.

Ndërsa, i pandehuri Elbasan Alidema akuzohet se si pronar i firmës N.T.P “Metali”, me qëllim përfitimi, i ka shkaktuar dëm Komunës së Klllokotit.

Gjithmonë sipas aktakuzës, i njëjti më 17 dhjetor 2012, edhe pse nuk e kishte dërguar në komunë inventarin, duke përpiluar faturat, kinse në tërësi është përmbushur kontrata e 5 dhjetorit 2012, në tenderin sipas konkursit KI 660 12 025 121, e që si pasojë nga MAPL-ja i kryhet pagesa nga Komuna e Klllokotit, në vlerë prej 29,330.00 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Gjykata Themelore në Gjilan kishte mbajtur shqyrtimin gjyqësor fillestar më 21 mars 2017, ndërsa shqyrtimin e dytë e kishte mbajtur më 14 shtator 2017, apo më shumë se pesë (5) muaj sesa që e përcaktojnë dispozitat e KPPRK-së.

Pas 10 seancave të shqyrtimit gjyqësor, njëra nga të cilat ishte shtyrë, Gjykata Themelore në Gjilan, më 15 prill 2019, në mungesë të provave i kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-kryetarin e Komunës së Klllokotit, Sasha Mirkoviq, tre zyrtarët e kësaj komune, Zeqir Selimi, Strahinja Steviq, Nebahate Pira, si dhe pronarin e kompanisë “Metali”, Elbasan Alidema.<sup>41</sup>

“Gjykata me vëmendje dhe përkushtim të madh ka analizuar gjitha provat dhe faktet, dhe ka ardhur në përfundim se të njëjtit nuk e kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar. Ka munguar elementi i dashjes dhe i përfitimit pasuror për vete apo për të tjerë. Sipas gjykatës, Komuna e Klllokotit nuk është dëmtuar”, kishte thënë gjykatësi Thaçi, gjatë shpalljes së aktgjykimit. E pakënaqur ndaj këtij vendimi të Themelores, ankesë në Gjykatën e Apelit kishte ushtruar Prokuroria Themelore në Gjilan, të cilën ankesë e kishte aprovuar Gjykata e Apelit dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim. Sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë është marrë në bazë të shkëlqeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse dispozitivi është në kundërtënie me argumentet e nxjerra në seancën gjyqësore dhe shkresat e lëndës, derisa në aktgjykim nuk ka arsye për faktet të cilat janë treguar në lëndë, ndërsa arsyet janë dhënë në mënyrë të paqartë dhe në masën e njohur kundërtënëse, për çfarë edhe gjetja faktike ka mbetur e vërtetuar në mënyrë të gabuar, ashtu siç tregohet me bazë në ankesën e prokurorisë. Seanca e parë e rigjykimit është mbajtur më 18 dhjetor 2019, ndërsa gjykimi është akoma duke vazhduar.


**Dëmi i pretenduar:** 29,330.00 euro.

**Sekuestrimit dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

<sup>41</sup> “Ish-kryetari i Klllokotit dhe të tjerët lirohen nga akuza për kontratën me kompaninë “Metali” (Video)” Betimi për Drejtësi. 15 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-kontraten-me-kompanine-metali/>)

- **Rasti i ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Gjakovë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.16/18
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Shaqir Zika
<b>Prokuror:</b>	Atdhe Dema
<b>Të pandehur:</b>	Pal Lekaj, Pashk Syla, Bekim Syla, Teuta Mejzini, Dafina Thaqi, Veli Hajdaraga dhe Ismet Isufi
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorimi i pozitës apo autorizimit zyrtar”, “Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, “Mashttrim me subvencione”, “Shmangie nga tatimi”.
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces



- **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 646 ditë**

PSRK-ja aktvendimin për fillim të hetimeve e kishte nxjerr me 12 prill 2016, ndërsa aktakuzën e kishte ngritur me 10 prill 2018, për shkak të veprave penale “keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar” si dhe “përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, kundër ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj. Ai akuzohet se pa bazë ligjore ka dhënë subvencione në bujqësi mbi 630 mijë euro.<sup>42</sup>

Bashkë me Lekajn, akuzohen edhe Ismet Isufi, Pashk Syla, Bekim Syla, Teuta Mejzini dhe Dafina Thaqi, se duke vepruar si zyrtarë të Komunës së Gjakovës, kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare gjatë shpërndarjes së subvencioneve.<sup>43</sup>

Pal Lekaj dhe Ismet Isufi, akuzohen se gjatë periudhës 2008-2014, duke vepruar në cilësinë e

<sup>42</sup> “Ekskluzive: Ngritet aktakuzë për korrupsion ndaj Pal Lekajt”. Betimi për Drejtësi. 12 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-ngritet-aktakuzë-per-korrupsion-ndaj-pal-lekajt/>)

<sup>43</sup> “Pal Lekaj akuzohet se ka dhënë mbi 630 mijë euro subvencione pa bazë ligjore”. Betimi për Drejtësi. 24 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pal-lekaj-akuzohet-se-ka-dhene-mbi-630-mije-eurosubvencione-pa-baze-ligjore/>)

personave zyrtarë, i pari në cilësinë e kryetarit të Komunës së Gjakovës, ndërsa i dyti si drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, kanë shpërndarë subvencione, përmes kompanisë “UNIONVL”, në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.

Sipas aktakuzës, subvencionet janë autorizuar nga të akuzuarit pa mbikëqyrje nëse pagesat janë bërë ndaj fermerëve dhe duke mos pasur fare kontratë me kompaninë “UNION-VL”, me ç’rast rreth 40% e mbi tre mijë fermerëve nuk kanë pranuar fare pagesat që janë autorizuar ndaj tyre.

Ndërsa, të pandehurit Pashk Syla, Bekim Syla, Teuta Mejzini dhe Dafina Thaqi, akuzohen se duke e qenë në cilësinë e kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve për mbikëqyrjen e shpërndarjes së subvencioneve, kanë përpiluar raporte se kinse shpërndarja në teren e subvencioneve është bërë ashtu siç duhet, megjithëse rreth 40% e aplikuesve nuk kanë pranuar subvencionet. Në këtë rast, akuzohet edhe Veli Hajdaraga, i cili, sipas prokurorisë, gjatë periudhës 2008-2015, ka dhënë informacione të pasakta se kinse të gjithë aplikuesit për subvencione kanë pranuar subvencionet dhe ka lejuar që në vend të fermerëve që kanë qenë në lista për të marrë subvencione, të marrin persona tjerë pa pasur të drejtë.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar për 31 maj 2018, apo 27 ditë pas afatit 30 ditor të përcaktuar me KPPRK për mbajtjen e shqyrtimit fillestar pas ngritjes së aktakuzës.<sup>44</sup> Ndërsa më 16 korrik 2018, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur që ta hudhë poshtë akuzën për sa i përket veprës penale “përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare” ndaj Pal Lekajt, Isuf Isufit, Pashk Sylës, Bekim Sylës, Teuta Mejzinit dhe Dafina Thaqit. E njëjta gjykatë e kishte konfirmuar akuzën ndaj Lekajt për sa i përket veprës penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe mashtrim lidhur me subvencione, aktakuza është konfirmuar edhe ndaj të akuzuarve të tjerë, Ismet Isufi, Pashk Syla, Bekim Syla, Teuta Mejzini, Dafina Thaqi dhe Veli Hadaraga.<sup>45</sup>

Në muajin nëntor të vitit 2018, Gjykata e Apelit e ka kthyer në rivendosje rastin ndaj Lekajt dhe të tjerëve për sa i përket veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, për të cilën pikë, GjTh në Gjakovë e kishte konfirmuar aktakuzën, pasi sipas vlerësimit të Apelit, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme kur e kishte konfirmuar akuzën për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës ndaj të akuzuarve dhe kishte refuzuar ankesat e mbrojtësve të tyre. Kurse, sa i përket veprës tjetër për të cilën edhe Themelorja kishte hudhur këtë pikë të aktakuzës, të njëjtën gjë e ka vërtetuar edhe Apeli.<sup>46</sup>

<sup>44</sup> “Ish-kryetari i Gjakovës, Pal Lekaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 31 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-gjakoves-pal-lekaj-dhe-te-tjeretdeklarohen-te-pafajshem-per-korrupsion/> )

<sup>45</sup> “Hudhet pjesërisht aktakuza ndaj ministrit Pal Lekaj”. Betimi për Drejtësi. 24 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-pjeserisht-aktakuza-ndaj-ministrit-pal-lekaj/> )

<sup>46</sup> “Apeli e kthen në rivendosje rastin e Pal Lekajt për keqpërdorim pozite, vërteton hudhjen e akuzës për përvetësim”. Betimi për Drejtësi. 27 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-nerivendosje-rastin-e-pal-lekajt-per-keqperdorim-pozite-verteton-hudhjen-e-akuzes-per-pervetesim/> )

Pas kthimit të rastit në rivendosje, më 3 janar 2019, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë, në të cilët të akuzuarit kishin kërkuar hüdhen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave<sup>47</sup>, Këtë aktakuzë e kishte konfirmuar GjTh në Gjakovë, kurse ka hedhur poshtë aktakuzën dhe kishte pushuar procedurën penale, ndaj të akuzuarve Pashk Syla, Bekim Syla, Teuta Mejzini, Dafina Thaqi, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, për shkak të parashkrimit relative të ndjekjës penale.<sup>48</sup> Ndërsa Gjykata e Apelit, në mars, e kishte vërtetuar aktakuzën ndaj Lekaj, Isufit dhe Hajdaragës, duke e lënë në fuqi aktvendimin e GjTh në Gjakovë.<sup>49</sup>

Nga data e shqyrtimit fillestar e deri në datën e shqyrtimit kryesor kanë kaluar 329 ditë. Më 24 prill 2019, ishte mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor në të cilën seancë PSRK-ja kishte konstatuar se kishte prova të mjaftueshme ndaj të akuzuarve, ndërsa mbrojtja e kishte kundërshtuar këtë aktakuzë. Ndërsa në të njëjtën seancë ishte vendosur që të bëhej një ekspertizë e re financiare.<sup>50</sup> Ndërkaq, me 16 gusht 2019, GjTh në Gjakovë ishte bërë bashkimi i lëndës së të akuzuarit për keqpërdorim në ndarjen e subvencioneve Gani Rama dhe të akuzuarve Leka, Isufi dhe Hajdaraga, pasi sipas prokurorit Atdhe Dema të dyja çështjet ishin të njëjta dhe të ndërlidhura.<sup>51</sup>

Gjykimi i këtij rasti kishte vazhduar në seancat e 7 dhe 8 nëntorit si dhe 23 e 24 dhjetorit 2019, ndërsa për shkak se prokurori i PSRK-së Atdhe Dema ishte jashtë shtetit, ishin shtyrë seancat e parapara të mbaheshin më 24 tetor 2019 dhe 16 dhjetor 2019.

Gjykimi ndaj deputetit Lekaj dhe të tjerëve është duke vazhduar edhe gjatë vitit 2020.

**Dëmi i pretenduar:** Mbi 630.000 euro.

**Sekuestrimit dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>47</sup> “Ish-kryetari i Gjakovës, Pal Lekaj dhe të tjerët kërkojnë hüdhen e aktakuzës për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 3 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-gjakoves-pal-lekaj-dhe-te-tjeret-kerkojne-hudhjen-e-aktakuzes-per-korrupsion/>)

<sup>48</sup> “Konfirmohet aktakuza për keqpërdorim pozite ndaj Pal Lekaj dhe dy të tjerëve, për katër të akuzuar pushohet procedura penale”. Betimi për Drejtësi. 18 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-per-keqperdorim-pozite-ndaj-pal-lekaj-dhe-dy-te-tjereve-per-kater-te-akuzuar-pushohet-procedura-penale/>)

<sup>49</sup> “Apeli vërteton aktakuzën për korrupsion ndaj Pal Lekajt dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 14 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktakuzen-per-korrupsion-ndaj-pal-lekajt-dhe-dy-te-tjereve/>)

<sup>50</sup> “Gjykimi ndaj Pal Lekajt dhe të tjerëve, prokurori mbron aktakuzën, mbrojtja e kundërshton”. Betimi për Drejtësi. 24 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-pal-lekajt-dhe-te-tjereve-prokurori-mbron-aktakuzen-mbrojtja-e-kundershton/>)


<sup>51</sup> “Bëhet bashkimi i rastit të Gani Ramës me atë të Pal Lekajt dhe të tjerëve, të akuzuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 16 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/behet-bashkimi-i-rastit-te-gani-rames-me-ate-te-pal-lekajt-dhe-te-tjereve-te-akuzuar-per-korrupsion/>)



- **Rasti i ish-kryetarit të Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.18/15
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Fillimisht ky rast është gjykuar nga gjyqtari e EULEX-it Vladimir Mikula, por më pas ka kaluar te gjyqtari vendor Beqir Kalludra.
<b>Prokuror:</b>	Fillimisht ky rast është gjykuar nga prokurori i EULEX-it Paul Flynn, por më pas ka kaluar te prokurorja Florie Salihu-Shamolli.
<b>Të pandehur:</b>	Sami Lushtaku, Esat Tahiri, Milazim Lushtaku, Driton Pruthi,
<b>Veprat penale:</b>	Arben Gjukaj, Hysni Hoxha dhe Azem Duraku. “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, “Shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizim”, “Mashtrim”, “Lidhja e kontratës së dëmshme”.
<b>Faza e procedurës:</b>	Aktgjykim i shkallës së parë

- **Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, kanë kaluar 1,586 ditë**



Më 2 shtator 2012 ishte ngritur kallëzim penal kundër ish-kryetarit të Skenderajt, Sami Lushtaku. Më 5 tetor 2012, prokurori i EULEX-it kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimit, kurse më 16 janar 2015 kishte ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Sami Lushtakut, Esat Tahirit, Milazim Lushtakut, Driton Pruthit, Arben Gjukajt, Hysni Hoxhës dhe Azem Durakut për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit” dhe “mashtrim”.

Ata akuzoheshin në lidhje me tenderin milionësh për sigurimin fizik të objekteve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Sami Lushtaku akuzohet për veprën penale “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”, Arben Gjukaj e Hysni Hoxha për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit”, Esat Tahiri dhe Milazim Lushtaku për veprat penale “mashtrimi” dhe “falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, Driton Pruthi për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit” dhe “lidhja e kontratës së dëmshme”, si dhe Azem Duraku për veprën penale “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Aktakuza në rastin kundër Sami Lushtakut dhe të tjerëve ishte ngritur me 16 janar 2015. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar dhe mbajtur në kohë rekord, vetëm pas katër ditëve nga ngritja e aktakuzës, respektivisht më 20 janar 2015 dhe shqyrtimi i dytë me 11 shkurt 2015. Përderisa, shqyrtimi i parë dhe i dytë ishin caktuar dhe mbajtur brenda afateve ligjore të përcaktuara me KPPRK, mbajtja e shqyrtimit kryesor në këtë rast ishte shtyrë për më shumë se një vit, duke u mbajtur tek më 24 shkurt 2016.

Kjo lëndë ka kaluar nga gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula, tek gjyqtari vendor Beqir Kalludra, po ashtu edhe nga prokurori Paul Flynn te prokurorja Florie Salihu-Shamolli.

Nga 24 shkurti i vitit 2016, kur ishte mbajtur seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor, mbi 10 seanca kishin dështuar të mbaheshin. Më 2 nëntor 2018, ky gjykim kishte dështuar të mbahej për shkak se kryetari i trupit gjykues Beqir Kalludra, duhej të merrte pjesë në një trajnim të etikës.<sup>52</sup> Kurse, seanca e paraparë për datën 14 dhjetor 2018 kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së të akuzuarit Sami Lushtaku, për të cilin gjykatësi Kalludra kishte thënë se do të lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim.<sup>53</sup> Ndërsa, për shkak të mungesës së mbrojtësve të të akuzuarve kishte dështuar të mbahej seanca e paraparë për 9 janar. Kjo për arsye se Oda e Avokatëve të Kosovës kishte hyrë në bojkot të përgjithshëm deri në tërheqjen e urdhëresës dhe rekomandimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që kishte të bëjë me kufizimin e avokatëve dhe palëve të tjera në objektet e gjykatave pa ftesë ose pa leje të kryetarit të gjykatës përkatëse.<sup>54</sup> Seanca e paraparë të mbahej më 23 prill 2019, në të cilën synohej të jepej fjala përfundimtare, kishte dështuar të mbahej për shkak se prokurorja e rastit, Florije Shamolli, nuk ishte e gatshme të jep fjalën përfundimtare, pasi sipas saj në

<sup>52</sup> “Gjykatësi në trajnim, shtyhet gjykimi për rastin e njohur “KEK II” Betimi për Drejtësi, 2 nëntor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesi-ne-trajnim-shtyhet-gjykimi-ne-rastin-e-njohur-kek-ii/>)

<sup>53</sup> “Rasti “KEK 2”, mungon Sami Lushtaku, gjykatësi thotë se ndaj tij do të lëshohet urdhëresë për sjellje” Betimi për Drejtësi, 14 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-kek-2-mungon-sami-lushtaku-gjykatesi-thote-se-ndaj-tij-do-te-leshohet-urdherese-per-sjellje/>)

<sup>54</sup> “Avokatët bojkotojnë punën në gjykatë, dështon gjykimi ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi, 9 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avokatet-bojkotojne-punen-ne-gjykate-deshton-gjykimi-ndaj-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve/>)

PSRK kanë qenë të angazhuar me rastin e kthimit jashtëzakonshëm të disa qytetarëve të Kosovës nga Siria.<sup>55</sup>

Seanca e fundit që ishte mbajtur në këtë rast është ajo e 3 majit 2019, ku prokuroria kishte kërkuar dënimin e të akuzuarve, kurse, mbrojtësit e të akuzuarve, kishin kërkuar lirin e tyre nga akuza. Gjithashtu, mbrojtësi i të akuzuarit Esat Tahiri, kishte deklaruar se për njërin nga veprat penale që akuzohet i mbrojturi i tij, e që është “falsifikim i dokumentit” është arritur parashkrimi, andaj ai i kishte propozuar gjykatës që për atë vepër të shqiptojë aktgjykim refuzues.<sup>56</sup>

Pas 34 seancave gjyqësore, prej të cilave 20 ishin mbajtur dhe 14 ishin shtyrë, është caktuar që shpallja e aktgjykimit të mbahet më 20 maj 2019, duke mos respektuar afatin e përcaktuar me ligj, sipas të cilit shpallja e aktgjykimit duhet të bëhet tre ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Më 20 maj, gjykatësi Beqir Kalludra, vendosi që ish-kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe të gjithë të akuzuarit e tjerë të lirohen nga akuzat që rëndonin mbi ta. Sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Kalludra, nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale më të cilat ngarkohen. Kurse, ndaj Esat Tahirit dhe Milazim Lushtakut, u shpall aktgjykim refuzues për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, me arsyetimin se është arritur parashkrimi absolut. Të njëjtit u liruan sa i përket veprës penale të mashtrimit, kurse Tahiri edhe për shtytje për keqpërdorim të detyrës zyrtare.<sup>57</sup>

Gjykatësi Kalludra, në shpalljen e aktgjykimit ishte deklaruar edhe për dëmin në këtë rast, që sipas tij është diskutuar edhe në media. Ai kishte vlerësuar se nuk mund të qëndrojë një aktakuzë e cila nuk ka përcaktuar në mënyrë të saktë vlerën e dëmit, që i është shkaktuar buxhetit të shtetit. “Është fol edhe në media për dëmin, nëse e keni aktakuzën para vete faqja 5 pika 5 , shuma 6 milion e 182 mijë, e njëjta faqe pika 3 është 100 mijë. Te pika tjetër është 50.000 mijë. Ju lutem shumë, kjo nuk duhet me ndodh. 6 milion është vlera e tenderit, dëmi duhet te ishte diferenca mes kompanive. Nuk mund të qëndroj një aktakuzë e tillë diku 100 mijë diku 6 milion”, kishte thënë gjykatësi në arsyetimin e tij pas shpalljes së aktgjykimit. Kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit.

**Dëmi i pretenduar:** 6,182,609.76 euro.

**Sekuestrimit dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>55</sup> “Shtyhet dhënia e fjalës përfundimtare në gjykimin ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve për tenderin milionësh në KEK” Betimi për Drejtësi, 23 prill 2019 (Shih linkun - <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-dhenia-e-fjalës-përfundimtare-ne-gjykimin-ndaj-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve-per-tenderin-milionesh-ne-kek/>)

<sup>56</sup> “Përfundon gjykimi për tenderin milionësh në KEK, prokuroria kërkon dënimin e Sami Lushtakut dhe të tjerëve, mbrojtja e quan “aktakuzë të poshtër”. Betimi për Drejtësi, 3 maj 2019 (Shih linkun - <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-gjykimi-per-tenderin-milionesh-ne-kek-prokuroria-kerkon-denimin-e-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve-mbrojtja-e-quan-aktakuze-te-poshter/>)

<sup>57</sup> “Sami Lushtaku dhe të tjerët lirohen nga akuzat në rastin e njohur KEK 2” Betimi për Drejtësi, 20 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/sami-lushtaku-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuzat-ne-rastin-e-njohur-kek-2/>)

- Rasti “FAN”

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.734/15
<b>Kryetar i Trupit Gjykes:</b>	Shashivar Hoti
<b>Prokuror:</b>	Fikrije Fejzullahu
<b>Të pandehur:</b>	Naser Osmani, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, Agim Deshishku.
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mashtrimi”, “Shmangie nga tatimi”, “Legalizim i përmbytës së rreme”.
<b>Faza e procedurës:</b>	Aktgjykim i shkallës së parë



- **Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, kanë kaluar 1,144 ditë**

Rasti kundër Naser Osmanit kishte filluar sipas kallëzimit penal të parashtruar nga Policia e Kosovës, më 28 prill 2014. PSRK, më 30 prill 2014, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse kjo prokurori më 16 shkurt 2016 kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë, kundër deputetit Naser Osmani si nënkryetari i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabanit si drejtor i bordit të AKP-së, pastaj kundër të pandehurve Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, të gjithë zyrtarë në AKP si dhe kundër biznesmenit Agim Deshishku.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK, të akuzuarit Naser Osmani, si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani si Drejtori i Bordit të AKP-së, Shkelzen Lluka si menaxher i AKP-së, Naim Avdiu si zv/drejtor menaxhues i AKP-së dhe Melita Ymeraga, Ardian Kelmendi, Agron Kamberaj si kryesues të Njesisë së Monitorimit në AKP në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë si anëtarë ndërkombëtar të AKP-së: Lisa Brodey,

Mohammed Omran dhe Hubert Ēarsmann, i kanë kaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete ose për personin tjetër, në vlerë prej 5,400,000.00 euro.

Ata akuzohen se kanë shkelur të drejtat e punëtorëve të kësaj ndërmarrje, me çka njëkohësisht i kanë shkaktuar dëm Ndërmarrjes Shoqërore “FAN” e përfaqësuar nga AKP-ja si dhe buxhetit të shtetit, lidhur me çështjen e Ndërmarrjes së Re “FAN-Podujevë”. Kjo e fundit, ishte privatizuar në valën e 7-të të shitjes nga AKM-ja, ku ishte blerë me çmim prej 2,310,000.00 euro nga blerësi, i akuzuari Agim Deshishku, sipas kontratës së nënshkruar me zotimet e fituara të bëjë investime në vlerë prej 2,800,000.00 euro dhe të punësojë 236 punëtorë përgjatë periudhës dy vjeçare.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast është caktuar më 17 mars 2016, mirëpo e njëjta ishte shtyrë për 4 prill 2016. Në seancën e 4 prillit, përderisa prokurori special Admir Shala ka lexuar aktakuzën, Naser Osmani dhe Bahri Shabani, pjesë e bordit të drejtorëve të AKP-së, nuk ishin deklaruar lidhur me fajësinë, me arsyetimin se prezent duhet të jenë të gjithë anëtarët e bordit.<sup>58</sup> Shqyrtimi gjyqësor i këtij rasti ishte caktuar më 10 prill 2017, pra pas më shumë se një viti, por e njëjta ishte shtyrë dy herë më radhë, ndërsa u arrit të mbahet vetëm më 12 korrik 2017.

Më 29 janar 2019, ishte paraparë të bëhej shpallja e aktgjykimit për këtë rast, mirëpo gjykatësi Shashivar Hoti kishte bërë të ditur se në kohën që trupi gjykues ka pasur në dispozicion nuk ka arritur të bëjë shqyrtimin e të gjitha shkresave të lëndës dhe shpallja është shtyrë për 8 shkurt 2019.<sup>59</sup>

Pas 27 seancave gjyqësore, shtatë nga të cilat kishin dështuar të mbaheshin dhe rreth 3 vjet pas ngritjes së aktakuzës, më 8 shkurt 2019, deputeti Naser Osmani dhe të akuzuarit tjerë Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka dhe Naim Avdiu ishin shpallur të pafajshëm për keqpërdorim të pozitës zyrtare. I pafajshëm për legalizim të përmbajtës së rreme në vazhdimësi, ishte shpallur edhe i akuzuari Agim Deshishku. Mirëpo, Deshishku ishte gjetur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë për veprën penale të mashtrimit në vazhdimësi, për çka ishte dënuar me 1 vit burgim.

Kurse, për veprën penale të shmangies nga tatimi, Deshishku ishte dënuar me 1 vit burgim dhe 10 mijë euro gjobë. Ndaj tij ishte shqiptuar dënim unik prej 1 viti e 8 muajsh burgim, ku

<sup>58</sup> “Fillon gjykimi, Naser Osmani dhe të tjerët në rastin e AKP-së deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 4 prill 2016. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/fillon-gjykimi-naser-osmani-dhe-te-tjeret-ne-rastin-e-akp-se-deklarohen-te-pafajshem/>)

<sup>59</sup> “Shtyhet shpallja e aktgjykimit ndaj deputetit Naser Osmani dhe të tjerëve për privatizimin e fabrikës “FAN” Betimi për Drejtësi 29 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-shpallja-e-aktgjykimit-ndaj-deputetit-naser-osmani-dhe-te-tjereve-per-privatizimin-e-fabrikes-fan/>)

do t'i llogaritej edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Gjithashtu, sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Shashivar Hoti, i akuzuari Agim Deshishku obligohej që dëmin prej 53,807.46 euro t'ia kompensojë Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), si dhe të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në vlerë prej 300 euro. Ndërkaq, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ishte udhëzuar në kontest civil. Sipas aktgjykimit, ishte refuzuar edhe kërkesa e prokurorisë për konfiskimin e ndërmarrjes “FAN”.<sup>60</sup> Ndryshe, ndaj Agron Kamberit, në fillim ishte pushuar procedura, pasi ndaj tij prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale.

Kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit.

**Dëmi i pretenduar:** Mbi 5 milionë euro.

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Është refuzuar kërkesa e prokurorisë për konfiskimin e ndërmarrjes “FAN”

---

<sup>60</sup> “Deputeti Naser Osmani dhe të tjerët shpallen të pafajshëm për keqpërdorim pozite, dënohet Agim Deshishku” , Betimi për Drejtësi, 8 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-naser-osmani-dhe-te-tjeret-shpallen-te-pafajshem-per-keqperdorim-pozite-denohet-agim-deshishku/>)

- **Rasti “Veteranët”**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.230/18
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Nushe Kuka-Mekaj
<b>Prokuror:</b>	Fillimisht ka qenë Afrim Shefkiu, e më pas bashkërisht Enver Krasniqi dhe Valdet Gashi.
<b>Të pandehur:</b>	Agim Çeku, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rrustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari
<b>Vepra penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 390 ditë**



Rasti i njohur si “Veteranët”, konsiderohet si rasti më i madh që është ndjekur nga prokuroria kosovare, kjo për shkak se siç pretendohet, ish-ushtarakët e UÇK-së anëtarë të komisionit për verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së, kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare, duke shtuar në lista të veteranëve 19,500 persona, të cilët sipas prokurorisë nuk është dashur ta gëzojnë këtë status.

Sipas aktakuzës, së ngritur më 7 dhjetor 2018, 12 personat e përfshirë akuzohen se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtarë të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkalluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Sipas PSRK-së, nga provat e siguruara është vërtetuar se nga pagesat e kundërligjshme për veteranët luftëtarë të UÇK-së, buxheti i Republikës së Kosovës është dëmtuar në shumë prej 88,769,217.04 euro.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Ky rast, akoma pa nisur mirë është përfshirë në një trajtim jo-serioz nga PSRK. Këtë aktakuzë fillimisht e kishte përgatitur prokurori Elez Blakaj, por i njëjti në gusht të vitit 2018, kishte dhënë dorëheqje.<sup>61</sup> Në letrën e tij të dorëheqjes, Blakaj, kishte thënë se më 11 korrik 2018, kishte nënshkruar aktakuzën sipas të cilës 19,060 persona e gëzojnë statusin e veteranit në mënyrë të kundërligjshme dhe e kishte dorëzuar këtë aktakuzë te Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Reshat Millaku, por e njëjta nuk kishte shkuar në gjykatë.<sup>62</sup>

E Millaku, në një konferencë për media, më 20 gusht 2018, kishte thënë se njëra nga arsyet e mos dërgimit të aktakuzës ishte se në dispozitivin e aktakuzës së ngritur nga prokurori special i dorëhequr, Elez Blakaj, nuk i ka shkruar emrat dhe mbiemrat e 19,060 veteranëve, të cilët konsiderohen se janë të rrejshëm, edhe pse kishte pranuar se të gjitha provat janë përfshirë, por përmes fusnotave. Ai po ashtu kishte shtuar se nuk ishte bërë propozimi që këtyre veteranëve mashtrues, t’iu ndërpriten pagesat e pensioneve që marrin.<sup>63</sup> Por, PSRK-ja, aktakuzën e veteranëve, përmes prokurorit Afrim Shefkiu, e kishte dorëzuar në gjykatë, më 14 shtator 2018, ku kishte rritur numrin e veteranëve të kundërligjshëm nga 19,060 në 20,238 persona.<sup>64</sup>

Në kohën kur ishte dorëzuar kjo aktakuzë në gjykatë, në media kishin dalë edhe emrat e 20,238 personave, së bashku me të dhënat e tyre personale, çka kishte pasuar një debat të madh publik, pasi shumë persona dilnin me deklaratat se kanë qenë luftëtarë gjatë gjithë kohës së luftës por ishin të përfshirë në ato lista.

---

<sup>61</sup> “Flet Elez Blakaj, thotë se kishte kërcënime nga veteranët, përmend presionin e Kryeprokurori Aleksandër Lumezi për veteranët e UÇK-së dhe rastin “Pronto”ë. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/flet-elez-blakaj-thote-se-kishte-kercenime-nga-veteranet-permend-presionin-e-kryeprokurori-aleksander-lumezi-per-veteranet-e-uck-se-dhe-rastin-pronto/>)

<sup>62</sup> “Prokurori i dorëhequr Elez Blakaj në korrik e ka ngritur aktakuzën e profilit të lartë për veteranët, të cilës i prin Agim Çeku dhe përfundon me Xhavit Jasharin, aktakuza “flenë” në Prokurori Speciale”. Betimi për Drejtësi. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-i-dorehequr-elez-blakaj-ne-korrik-e-ka-ngritur-aktakuzen-e-profilit-te-larte-per-veteranet-te-ciles-i-prin-agim-ceku-dhe-perfundon-me-xhavit-jasharin-aktakuza-flene-ne-pr/>)

<sup>63</sup> “Kryeprokurori Millaku nuk e argumenton mos dërgimin e aktakuzës në Gjykatë, thotë se është e mangët në dispozitiv edhe pse pranon se të gjitha provat janë përfshirë në aktakuzë, por përmes fusnotave (Video)”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-millaku-nuk-e-argumenton-mos-dergimin-e-aktakuzes-ne-gjykatete-thote-se-eshte-e-manget-ne-dispozitiv-edhe-pse-pranon-se-te-gjitha-provat-jane-perfshire-ne-aktakuze-por-permes-fusnotave/>)

<sup>64</sup> “Dorëzohet në gjykatë aktakuza e prokurorit të dorëhequr Elez Blakaj, për rastin e njohur si “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 14 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dorezohet-ne-gjykatete-aktakuza-e-prokurorit-te-dorehequr-elez-blakaj-per-rastin-e-njohur-si-veteranet/>)



Edhe pse të akuzuarit, ishin në pritje të thirrjes së seancës fillestare, gjyqtarja Nushe Kuka-Mekaj, këtë aktakuzë e kishte kthyer në PSRK, për përmirësime dhe qartësime, pasi sipas saj, aktakuza nuk ishte përpiluar konform dispozitave të KPPK-së dhe se përshkrimi i gjendjes faktike të dispozitivit të aktakuzës ishte i paqartë. Gjyqtarja Kuka-Mekaj, i kishte dhënë PSRK-së 30 ditë afat për të bërë përmirësimet e kërkuara.<sup>65</sup> Edhe pse Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, në deklaratimet e tij para mediave kishte thënë se aktakuza do të dorëzohet në gjykatë brenda afatit të përcaktuar nga gjykata,<sup>66</sup> një gjë e tillë nuk ndodhi, pasi PSRK-ja kërkoi nga GjTh në Prishtinë, zgjatjen e këtij afati edhe për 30 ditë të tjera, në mënyrë që të bëhen përmirësimet e kërkuara, propozim të cilin më 9 nëntor 2018, e aprovoi gjyqtarja Kuka-Mekaj.<sup>67</sup> Më 7 dhjetor 2018, PSRK-ja, përfundimisht këtë aktakuzë e kishte dorëzuar në gjykatë.<sup>68</sup>

Seanca e shqyrtimit fillestar ishte caktuar të mbahet më 28 janar 2019, apo pas mbi 21 ditëve pas afatit ligjor të përcaktuar me KPPK, mirëpo e njëjta kishte dështuar për shkak të mungesës së Ministrit të Mbrojtjes Rrustem Berisha, si dhe e dy të akuzuarve të tjerë, Faik Fazliu dhe Smajl Elezaj. Në këtë seancë, përveç prokurorit special Enver Krasniqi, i cili ishte caktuar për ta përfaqësuar këtë aktakuzë, i pranishëm në seancë ka qenë edhe prokurori tjetër special Valdet Gashi. Kjo seancë është shtyrë për 14 mars 2019.<sup>69</sup>

Edhe në seancën e radhës nuk u paraqitën dy nga 12 të akuzuarit, Xhavit Jashari dhe Ahmet Daku për arsye të ndryshme nuk ishin në sallën e gjykimit dhe për këtë shkak, gjykatësja Nushe Kuka-Mekaj, i kishte pyetur palët nëse është e nevojshme të veçohet procedura, mirëpo për këtë propozim nuk ishte pajtuar as prokurori Krasniqi, i cili i kishte propozuar gjykatës që ndaj tyre të lëshohet urdhërarrest, e as mbrojtja e të akuzuarve tjerë. Por pavarësisht se palët nuk kërkuan një gjë të tillë, ajo sipas detyrës zyrtare dhe duke marrë parasysh efikasitetin e procedurës vendosi që ndaj Jasharit dhe Dakut, të veçohet procedura.

---

<sup>65</sup> “Aktakuza e veteranëve i kthehet Prokurorisë Speciale për përmirësim dhe qartësim”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuza-e-veteraneve-i-kthehet-prokurorise-speciale-per-permiresim-dhe-qartesim/>)

<sup>66</sup> “Kryeprokurori Lumezi thotë se brenda pak ditësh aktakuza e veteranëve do të ridërgohet në gjykatë”. Betimi për Drejtësi. 22 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-lumezi-thote-se-brenda-pak-ditesh-aktakuza-e-veteraneve-do-te-ridergohet-ne-gjykat/>)

<sup>67</sup> “Gjykata i jep edhe 30 ditë afat Prokurorisë Speciale që të plotësojë aktakuzën në rastin “Veteranët””. Betimi për Drejtësi. 9 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-i-jep-edhe-30-dite-afat-prokurorise-speciale-qe-te-plotesoje-aktakuzen-ne-rastin-veteranet/>)

<sup>68</sup> “Prokuroria Speciale e dorëzon në Gjykatë aktakuzën e plotësuar në rastin e “Veteranëve””. Betimi për Drejtësi. 7 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-e-dorezon-ne-gjykat-aktakuzen-e-plotesuar-ne-rastin-e-veteraneve/>)

<sup>69</sup> “Rasti “Veteranët”, mungesa e ministrit Rrustem Berisha dhe dy të tjerëve shtyn seancën fillestare”. Betimi për Drejtësi. 28 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-mungesa-e-ministrit-rrustem-berisha-dhe-dy-te-tjereve-shtyn-seancen-fillestare/>)

Pasi u plotësuan kushtet ligjore për mbajtjen e asaj seance, asnjëri nga të akuzuarit nuk e pranuan fajësinë për veprën për të cilën ishin akuzuar<sup>70</sup>, ndërsa mbrojtjes iu caktua data 15 prill 2019, si afat brenda së cilës mund të kërkohet hedhja e aktakuzës.

Në seancën fillestare, PSRK-ja paraqiti edhe kërkesën për ndaljen e përkohshme të pensioneve ndaj 19,500 veteranëve përfitues, të cilët konsiderohen si “të rrejshëm”, por kjo kërkesë më 26 mars 2019, u refuzua nga gjykatësja Kuka-Mekaj.<sup>71</sup>

Në një pjesë të arsyetimit të këtij aktvendimi, ndër të tjerash thuhet se propozimi për masën e përkohshme nuk është ndaj të akuzuarve, por ndaj MPMS-së, si palë e tretë.

“Në rastin konkret, kur kemi parasysh se kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, të kërkesëpadisë, e cila është e karakterit urdhërues dhe qëllimi i saj është që të ruhet një gjendje ekzistuese, përkatësisht të mos dëmtohet edhe më tepër buxheti shtetëror i Republikës së Kosovës, nuk është drejtuar ndaj të pandehurve por ndaj Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Sociale, e cila e ka cilësinë e personit të tretë, gjykata ka ardhur në përfundim se nuk plotësohen kushtet ligjore për caktimin e masës së propozuar”, thuhet në aktvendimin të cilin e ka marr kryetarja e trupit gjykues, gjykatësja Nushe Kuka-Mekaj, që mban datën 26 mars 2019.

Ndërsa për dy të akuzuarit, për të cilët ishte veçuar procedura Xhavit Jashari dhe Ahmet Daku, gjykatësja Kuka-Mekaj, kishte caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar më 1 prill 2019, në të cilin dy të akuzuarit kishin deklaruar se nuk e pranojnë fajësisë për akuzat që ngarkojnë mbi ta.<sup>72</sup>

Në qershor 2019, GjTh në Prishtinë përmes një komunikate për media kishte njoftuar konfirmimin e kësaj aktakuze.<sup>73</sup> Pas konfirmimit të kësaj aktakuze nga shkalla e parë, edhe Gjykata e Apelit e kishte konfirmuar këtë aktakuzë duke lënë në fuqi aktvendimin e 19 qershorit 2019, të GjTh në Prishtinë.

“Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar dhe në mënyrë të drejtë ka dhënë arsye të mjaftueshme, se kundërshtimet janë të pabazuara dhe se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka prova të mjaftueshme, të pranueshme në

---

<sup>70</sup> “Rasti “Veteranët”, Agim Çeku, Rrustem Berisha, Shkumbin Demalijaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm (Video)”Betimi për Drejtësi. 14mars 2019 (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-ceku-rrustem-berisha-shkumbin-demalijaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>)

<sup>71</sup> “Gjykata refuzon kërkesën e Prokurorisë Speciale për pezullimin e pensioneve për 19.500 veteranë”Betimi për Drejtësi. 14mars 2019 (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-refuzon-kerkesen-e-prokurorise-speciale-per-pezullimin-e-pensioneve-per-19-500-veterane/>)

<sup>72</sup> “Rasti “Veteranët”, Ahmet Daku e Xhavit Jashari deklarohen të pafajshëm” Betimi për Drejtësi. 1 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-ahmet-daku-e-xhavit-jashari-deklarohen-te-pafajshem/>)

<sup>73</sup> “Konfirmohet aktakuza ndaj Rrustem Berishës, Agim Çekut e të tjerëve në rastin “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-rrustem-berishes-agim-cekut-e-te-tjereve-ne-rastin-veteranet/>)

aspektin procedural , për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, ndërsa tani nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të cilat mund të hedhet aktakuza, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 250 par. 1 nën par. 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Kodit të Procedurës Penale“, thuhet në komunikatën për media të Apelit.<sup>74</sup> Pas konfirmimit të aktakuzës, më 4 dhjetor 2019 ka filluar shqyrtimi gjyqësor i këtij rasti, gjatë kësaj seance janë dhënë fjalët hyrëse. Kurse, më 5 dhe 6 dhjetor është filluar me dëgjimin e dëshmitarëve. Por, kryetarja e trupit gjykues Nushe Kuka-Mekaj, ka marrë vendim me të cilin ka ndaluar që të publikohen në media dëshmitë e dëshmitarëve e po ashtu që emrat e tyre të jepen vetëm me initiale derisa të përfundohet procedura e provave, duke lënë kështu publikun të painformuar për dëshmitë e dëshmitarëve të këtij procesi gjyqësorë.

Kuka-Mekaj, këtë vendim e ka arsyetuar mbi bazën se me publikimin e dëshmime të dëshmitarëve dëmtohet procesi gjyqësorë, pasi sipas saj humb rëndësia që të largohen dëshmitarët nga salla e gjykimit, derisa të merret në pyetje një dëshmitar tjetër. Mirëpo një formë e tillë e vendimit është aplikuar për herë të parë, pasi e njëjta situatë ndodh edhe në raste të tjera, por më parë nuk ka pasur vendime të ngjashme.<sup>75</sup> Edhe në seancën e mbajtur më 23 dhjetor, në gjykatorë ka dhënë dëshminë e tij njëri nga dëshmitarët në këtë rast.<sup>77</sup> Gjatë kësaj seance, gjykata ka lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim për ish-kryetarin e Skenderajt, S.L, i cili mungoi në gjykim. Kryetarja e trupit gjykues, Nushe Kuka-Mekaj, kishte thënë se kishte prova se dëshmitari S.L, e kishte pranuar ftesën e gjykatës për të dëshmuar në këtë seancë, mirëpo i njëjti nuk e kishte arsyetuar mungesën e tij. Dëshmitari S.L, nuk i ishte përgjigjur ftesës së gjykatës as për seancat e 4, 5 dhe 6 dhjetorit, ndaj të cilit gjykata kishte lëshuar edhe më herët urdhëresë për sjellje me detyrim. Në seancën e së hënës ka munguar edhe dëshmitari S.B, ku sipas gjykatës Kuka-Mekaj atij i ishte dërguar ftesa përmes bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, por sipas kërkesës së tij, ai do të sillej përmes policisë në seancën e 24 dhjetorit.<sup>78</sup> Gjatë seancës së mbajtur me 26 dhjetor, në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar ish-kryetari i Komunës së Skenderaj, S.L dhe S.B.<sup>79</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 88,769,217.04 euro.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>74</sup> “Rasti “Veteranët”, Apeli konfirmon aktakuzën ndaj Agim Çekut, Rrustem Berishës e të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-agim-cekut-rrustem-berishes-e-te-tjereve/>)

<sup>75</sup> “Rasti “Veteranët”, gjykata kundërligjshëm vendos që mediave t’u ndalohet publikimi i dëshmime të dëshmitarëve” Betimi për Drejtësi” 5 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-gjykata-kunderligjshem-vendos-ge-mediave-tu-ndalohet-publikimi-i-deshmive-te-deshmitareve/>) ..

<sup>76</sup> “Dëgjohen edhe dy dëshmitarë në rastin “Veteranët”, por deklaratat e tyre sipas vendimit të gjykatës s’mund të bëhen publike” Betimi për Drejtësi” 6 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/degjohen-edhe-dy-deshmitare-ne-rastin-veteranet-por-deklaratat-e-tyre-sipas-vendimit-te-gjykatës-smund-te-behen-publike/>)..

<sup>77</sup> “Rasti “Veteranët”, nis seanca ndaj Agim Çekut, Rrustem Berishës dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi. 23 dhjetor 2019. ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-nis-seanca-ndaj-agim-cekut-rrustem-berishes-dhe-te-tjereve/>).

<sup>78</sup> “Lëshohet urdhër për sjellje me detyrim ndaj ish-kryetarit të Skenderajt, që është dëshmitar në rastin e “Veteranëve”. Betimi për Drejtësi. 23 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/leshohet-urdher-per-sjellje-me-detyrim-ndaj-ish-kryetarit-te-skenderajt-ge-eshte-deshmitar-ne-rastin-e-veteraneve/>).

<sup>79</sup> “Ish-kryetari i Skenderajt dëshmitar në gjykimin e rastit “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-skenderajt-deshmitar-ne-gjykimin-e-rastit-veteranet/>).

- Rasti “Stenta 1”

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.369/16
<b>Kryetar i Trupit Gjykes:</b>	Shadije Gërguri
<b>Prokuror:</b>	Floriqe Salihu-Shamolli
<b>Të pandehur:</b>	Ferid Agani dhe Gani Shabani
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Aktgjykim i shkallës së parë

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, kanë kaluar 1,045 ditë**



Më 14 qershor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, sekretarit të përgjithshëm të MSh-së, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrje e ryshfetit”, “dhënie e ryshfetit”, “trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe “shmangia nga tatimi”.

Në këtë çështje penale hetimet fillimisht janë zhvilluar ndaj 116 personave fizik dhe katër personave juridik. Pas hetimeve, për 56 persona fizik nuk ishin plotësuar kushtet ligjore që të përfshihen në këtë aktakuzë, andaj për të njëjtit edhe kishin pushuar hetimet. Karakteristikë e këtij rasti është ngritja e aktakuzës nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në

kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore në Kosovë, gjetje kjo të cilën e ka ngritur IKD në raportet paraprake.<sup>80</sup>

Deri më tani, katër prokurorë janë ndërruar me lëndën “Stenta”. Tjetër karakteristikë e rastit është fakti se prokurori i shtetit që e ka përpiluar aktakuzën as nuk e përfaqëson dhe as nuk e mbrohet atë. Aktakuza është dorëzuar në muajin qershor 2016, por leximi i saj nuk ishte bërë një kohë të gjatë, meqë prokuroria nuk i kishte dorëzuar provat për të gjithë të pandehurit në gjuhën që ata e kuptojnë. Kjo kishte rezultuar me 5 seanca të shtyra.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 19 maj 2017, si dhe më 25 maj 2017 për njërin nga të akuzuarit që kishte munguar në seancën e 19 majit. Kërkesat e mbrojtësve të të akuzuarve për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, ishin refuzuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë më 31 korrik 2017, kurse, pas ankesave që mbrojtësit kishin ushtruar në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit, në tetor 2017 e kishte kthyer rastin në rivendosje.<sup>81</sup>

Pas kthimit të rastit në rivendosje, më 26 shkurt 2018, kryetarja e trupit gjykues, Shadije Gërguri, për qëllim të efikasitetit të çështjes, e kishte veçuar procedurën në tri pjesë. Që nga ajo kohë, Ferid Agani dhe Gani Shabani gjykohen veçmas si një rast (STENTA 1). Gani Bajraktari dhe të akuzuarit tjerë, kryesisht mjekë, që bëjnë pjesë në dispozitivat tre dhe katër të aktakuzës, janë duke u gjykuar veçmas (STENTA 2), kurse, Ali Hocaoglu dhe të akuzuarit tjerë që përfshihen nga dispozitivi 4 deri në dispozitivin 10 të aktakuzës do të gjykohen veçmas (STENTA 3).<sup>82</sup>

Asnjë nga të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 26 shkurt 2018, kurse, kërkesat e tyre për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave ishin refuzuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Në rastin e Ferid Aganit dhe Gani Shabanit, si dhe në rastin tjetër Gani Bajraktari etj. aktakuza ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe këto raste tanimë janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor, kurse për rastin Ali Hocaoglu etj., rasti është kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit pas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve. Në ndërkohë, për shkak se ka ndërruar jetë, ka pushuar procedura penale ndaj njërit nga të akuzuarit në këtë rast, Bedri Zaiti.

## Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

<sup>80</sup>“Luftë, persekutim apo amnisti në emër të luftës kundër korrupsionit?”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhjetor 2017. (Shih linkun <http://kli-ks.org/luftë-persekutim-apo-amnisti-ne-emer-te-luftes-kunder-korrupsionit/>)

<sup>81</sup> “Apeli e kthen në rivendosje rastin “Stenta”. Betimi për Drejtësi. 2 nëntor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-stenta/>)

<sup>82</sup>“Pas veçimit të procedurës ndaj tyre, sërish deklarohen të pafajshëm ish-ministri dhe ish-sekretari Shabani”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-vecimit-te-procedures-ndaj-tyre-serish-deklarohen-te-pafajshem-ish-ministri-agani-dhe-ish-sekretari-shabani/>)

Kallëzimi penal në rastin “Stenta” është ngritur më 26 maj 2014, kurse aktvendimi për fillimin e hetimeve më 16 qershor 2014. Aktakuza është ngritur më 14 qershor 2016. Shqyrtimi fillestar në rastin “Stenta” është caktuar më 21 tetor 2016, respektivisht me katër muaj vonesë apo jashtë afatit të përcaktuar me KPPRK. Karakteristikë për këtë rast është edhe seanca e shtyrë më 28 shkurt 2017, në të cilën gjyqtarja e rastit, Shadije Gërguri, kishte sqaruar se prokuroria me shkresë të veçantë ka njoftuar gjykatën se Afrim Bekteshi kishte qenë i përfshirë në hetimet për këtë rast, por ndaj tij nuk ishin gjetur elemente të veprës penale dhe i njëjti nuk ishte pjesë e akuzës.<sup>83</sup>

Mënyra e ngritjes së aktakuzës dhe tërheqja nga ndjekja penale ndaj Afrim Bekteshit, dëshmon jo-seriozitetin e prokurorisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Po ashtu, arsyetimi i prokurorisë për gabim teknik në ngritjen e aktakuzës, bie në kundërshtimin me obligimin ligjor që ka Prokurori i Shtetit sipas nenit 48 të KPPK-së, i cili përcakton se është detyrim i prokurorit që gjatë hetimit të veprave penale, të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet, duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit.

Më 18 prill 2019, ishte dhënë fjala përfundimtare e palëve, ku prokurorja Florije Salihu-Shamolli kishte kërkuar dënimin e të akuzuarve, kurse mbrojtja lirimin e tyre<sup>84</sup>, ndërsa më 24 prill, gjykata e shkallës së parë i ka shpallur fajtorë të akuzuarit për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Agani është dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim efektiv, ndërsa i akuzuari tjetër, Gani Shabani është dënuar me dy vjet burgim efektiv. Ata gjithashtu janë obliguar edhe t'i paguajnë shpenzimet procedurale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 400 euro.<sup>85</sup>

Në këtë rast të shënjestruar për liberalizim të vizave, nga ngritja e aktakuzës deri në shpalljen e aktgjyqimit në shkallë të parë, kanë kaluar 1,405 ditë.

Më 22 nëntor 2019, në Gjykatën e Apelit, është mbajtur seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit, në të cilën seancë të akuzuarit Ferid Agani dhe Gani Shabani, kanë kërkuar që shkalla e dytë t'i shpallë ata të pafajshëm ose që rasti ndaj tyre të kthehet në rigjykim. Në anën tjetër, prokuroria ka kërkuar që ndaj të njëjtëve të rritet dënimi i shqiptuar nga shkalla e parë.

Me 24 dhjetor, në një komunikatë për media, Apeli ka njoftuar se Departamenti Special i gjykatës së shkallës së dytë, i ka aprovuar ankesat e avokatëve mbrojtës të dy të akuzuarve

---

<sup>83</sup>“Përfshihet gabimisht në aktakuzën e rastit “Stenta”, lirohet nga ndjekja penale Afrim Bekteshi”. Betimi për Drejtësi. 28 shkurt 2017. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/perfshihet-gabimisht-ne-aktakuzen-e-rastit-stenta-lirohet-nga-ndjekja-penale-afirim-bekteshi/> )

<sup>84</sup>“Stenta 1”, ish-ministri Agani dhe ish-sekretari Shabani kërkojnë të lirohen nga akuzat, prokuroria kërkon dënimin e tyre” Betimi për Drejtësi. 18prill 2019. (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/stenta-1-ish-ministri-agani-dhe-ish-sekretari-shabani-kerkojne-te-lirohen-nga-akuzat-prokuroria-kerkon-denimin-e-tyre/>)

<sup>85</sup>“Rasti “Stenta 1”, ish-ministri Ferid Agani dhe ish-sekretari Gani Shabani dënohen me mbi 4 vjet burg efektiv (Video)”Betimi për Drejtësi. 24prill 2019. (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/rasti-stenta-1-ish-ministri-ferid-agani-dhe-ish-sekretari-gani-shabani-denohen-me-mbi-4-vjet-burg-efektiv/>)

kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas komunikatës, Gjykata e Apelit, pasi ka shqyrtuar më vëmendje aktgjyqimin e shkallës së parë, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve si dhe shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se aktgjyqimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e po ashtu edhe gjendja faktike është vërtetuar, mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, për çka duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.<sup>86</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 4,555,553.00 euro.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.


---

<sup>86</sup> “Apeli e kthen në rigjykim dhe rivendosje rastin ndaj ish-ministrit, Ferid Agani dhe ish-sekretarit, Gani Shabani” Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-dhe-rivendosje-rastin-ndaj-ish-ministrit-ferid-agani-dhe-ish-sekretarit-gani-shabani/>).

- **Rasti “Posta”**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.202/18.
<b>Kryetar i Trupit Gjykes:</b>	Lutfi Shala
<b>Prokuror:</b>	Naim Abazi
<b>Të pandehur:</b>	Agron Mustafa, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Rigjykim

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 502 ditë**



Më 22 dhjetor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, pas disa publikimeve në media kishte dorëzuar lëndën PPN.nr.236/16, me të cilën kishte kërkuar nga Prokuroria Speciale ta trajtojë çështjen e kontestit në mes të PTK-së dhe “Z-mobile”, në procedurën e arbitrazhit, kontest të cilin, e kishte humbur PTK-ja, duke u detyruar që Z-mobile-it t’ia përmbushë detyrimin në vlerë prej 32,856,407.28 euro.

Pasi PSRK-ja kishte filluar hetimet, e njëjta, më 17 gusht 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj drejtorit të PTK-së Agron Mustafa, ish-drejtorit të PTK-së Ejup Qerimi dhe kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të PTK-së Rexhë Gjonbalaj, duke i ngarkuar ata me veprën penale “keqpërdorimi pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPRK-së.

Sipas aktakuzës, nga 19 shkurti 2015 kur Agron Mustafa ishte zgjedhur në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të PTK-së e deri më 24 maj 2017, edhe pse nuk kishte qenë kompetent në kontestin në mes të PTK-së dhe tani të dëmtuarës DARDAFON.net (Z-Mobile), kishte lidhur marrëveshjen për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit. Me këtë veprim, sipas prokurorisë, janë shkaktuar vonesa në liferimin e Sim-kartelave, nuk e kishte furnizuar me bllokun e numeracionit dhe nuk i kishte dhënë shërbimet 3G dhe 4G të dëmtuarës. Edhe pse për këtë kontratë, për veprën penale “lidhja e kontratave të dëmshme”, me aktgjykim të



formës së prerë në qershor 2011, ishin liruar pesë persona, e po ashtu, edhe pse autoriteti rregullativ i komunikimeve elektrike dhe postare, tani të dëmtuarës Z-Mobile ia kishte lejuar përdorimin e numeracionit jo-gjeografik 045, i njëjti këto vendime nuk i kishte zbatuar.

Në këtë mënyrë, siç pretendon prokuroria, përkundër përpjekjeve të të dëmtuarës për zgjidhje të kësaj marrëveshje dhe për eliminimin e arbitrazhit të mundshëm, Mustafa nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me këtë. Gjithnjë sipas aktakuzës, Mustafa, në procedurën e arbitrazhit kishte angazhuar kompaninë “Studioligji”, për të përfaqësuar kompaninë në arbitrazh, në të cilën procedurë, gjykata ndërkombëtare e Arbitrazhit kishte marrë vendim në dobi të së dëmtuarës. Në bazë të këtyre veprimeve të Mustafës, prokuroria po pretendon, se PTK-ja ka qenë e detyruar që t’i paguajë të dëmtuarës Z-Mobile shumën prej 32,856,407.28 euro, pa llogaritur shpenzimet tjera të procedurës së arbitrazhit, në vlerë prej mbi 500,000 euro dhe 65,000 funta angleze.

Lidhur me këtë kontest në mes PTK-së dhe Z-Mobile, në gjykatat vendore ashtu edhe në atë të arbitrazhit, pas të cilave procedura gjyqësore, PTK-ja ishte dëmtuar miliona euro, përpos Mustafës, për periudhën 2012-2014, është duke u akuzuar edhe Kryeshefi Ekzekutiv i PTK-së, Ejup Qerimi, dhe kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të PTK-së, Rexhë Gjonbalaj. Sipas prokurorisë, të njëjtit kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare, në dëm të të dëmtuarës Z-Mobile, e po ashtu i kanë shkaktuar dëm edhe PTK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Aktakuza ndaj Mustafës, Qerimit dhe Gjonbalajt, kishte arritur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në të njëjtën ditë në të cilën edhe ishte ngritur, më 17 gusht 2018 dhe i ishte ndarë gjyqtarit Lutfi Shala.

Shala kishte caktuar shqyrtimin fillestar më 27 shtator 2018 apo 10 ditë pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh nga momenti kur aktakuza kishte arritur në gjykatë, në të cilin shqyrtim tre të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.<sup>87</sup>

Në shqyrtimin e dytë i cili ishte caktuar më 7 nëntor 2018, brenda afatit ligjor nga shqyrtimi fillestar, të akuzuarit kërkuan që kjo aktakuzë të hudhet.<sup>88</sup> Ndërsa, më 7 dhjetor 2018, gjykatësi i rastit Lutfi Shala kishte nxjerrë aktvendim me anë të së cilit kishte hudhur poshtë aktakuzën për shkak se sipas tij nuk ishte vërtetuar që të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkoheshin. Edhe pse Prokuroria Speciale kishte pretenduar se tre të akuzuarit i kanë shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës rreth 30,000,000 euro dëm, sipas gjykatës,

<sup>87</sup> “Agron Mustafa dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për rastin e “Z-Mobile””. Betimi për Drejtësi. 27 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/agron-mustafa-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-rastin-e-z-mobile/>)

<sup>88</sup> “Agron Mustafa dhe dy të tjerët kërkojnë hudhjen e aktakuzës për rastin “Z-Mobile” . Betimi për Drejtësi. 7 nëntor 2018 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/agron-mustafa-dhe-dy-te-tjeret-kerkojne-hudhjen-e-aktakuzes-per-rastin-z-mobile/>)

prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer vepër penale.<sup>89</sup>

Pas ankesës së Prokurorisë Speciale ndaj aktvendimit për hudhje të aktakuzës, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të aprovojë ankesën e PSRK-së dhe në këtë mënyrë kishte konfirmuar aktakuzën ndaj tre të pandehurve.<sup>90</sup>

Pas konfirmimit të aktakuzës, seanca e shqyrtimit gjyqësor është mbajtur më 21 mars 2019, kur kishte dhënë dëshminë Blerim Devolli, i cili në këtë proces gjyqësor është në cilësi të të dëmtuarit.<sup>91</sup> Pastaj seanca e radhës e cila ishte paraparë të mbahej me 16 maj 2019 është anuluar, për arsye se i akuzuari Ejup Qerimi, me anë të një parashtrere e kishte informuar gjykatën se për shkaqe shëndetësore gjendet jashtë vendit. Po ashtu, gjykatësi Shala, kishte njoftuar se edhe prokurori special Naim Abazi kishte njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantonte në seancën e kësaj date, për shkak se më herët ishte caktuar në gjykimin e rastit “Toka”, ku të akuzuar për krim të organizuar dhe për vepra të tjera penale janë Azem Sylja dhe 17 persona të tjerë. Mirëpo, aktakuzën e rastit “Toka”, në seancën e 16 majit e kishte përfaqësuar prokurorja Habibe Salihi.<sup>92</sup>

Në seancën e radhës të mbajtur me 10 qershor 2019, eksperti i telekomunikacionit Ismet Haliti e kishte cilësuar si krim të përmasave të mëdha kontratën që Telekom i Kosovës kishte arritur me kompaninë “Dardafon.net”, lidhur me ndarjen e numrave për Z-Mobile. Ai po ashtu kishte thënë se me një kontratë të tillë është dëmtuar rëndë interesi publik.<sup>93</sup> Në po të njëjtën seancë dëshminë e tij edhe kishte dhënë edhe udhëheqësi i Departamentit Ligjor në Telekom të Kosovës, Sabahudin Ramxhiku, i cili kishte deklaruar se gjetjet që kishte bërë departamenti i tij, para nënshkrimit të kontratës me Dardafon.net, nuk ishin respektuar nga ana e Bordi të PTK-së.<sup>94</sup> Seanca e radhës ishte mbajtur me 8 korrik 2019, në të cilën seancë

---

<sup>89</sup> “Hudhet poshtë aktakuza ndaj Agron Mustafës dhe të tjerëve në rastin e “Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2018 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-agron-mustafes-dhe-te-tjereve-ne-rastin-e-z-mobile/> )

<sup>90</sup> “Apeli vendos që Agron Mustafa dhe ish-drejtuësit tjerë të Telekomit të Kosovës të gjykohen për rastin “Z-Mobile” Betimi për Drejtësi. 4 shkurt 2018 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-vendos-qe-agron-mustafa-dhe-ish-drejtuësit-tjere-te-telekomit-te-kosoves-te-gjykohen-per-rastin-z-mobile/> )

<sup>91</sup> “Blerim Devolli thotë se takimet me udhëheqësit e Telekomit ishin të “ftohta” dhe sa për tu njoftuar” Betimi për Drejtësi. 21 mars 2019 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/blerim-devolli-thote-se-takimet-me-udheheqesit-e-telekomit-ishin-te-ftohta-dhe-sa-per-tu-njoftuar/> )

<sup>92</sup> “Anulohet seanca ndaj Agron Mustafës dhe dy të tjerëve për rastin e Z-Mobile” Betimi për Drejtësi. 21 mars 2019 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/anulohet-seanca-ndaj-agron-mustafes-dhe-dy-te-tjereve-per-rastin-e-z-mobile/> )

<sup>93</sup> “Gjykimi ndaj ish-krerëve të Telekomit, Ismet Hamiti thotë se kontrata me Z-Mobile është skemë e krimit të organizuar”, Betimi për Drejtësi. 10 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-krereve-te-telekomit-te-kosoves-ismet-hamiti-thote-se-kontrata-me-z-mobile-eshte-skeme-e-krimit-te-organizuar/> )

<sup>94</sup> “Rasti “Z-Mobile”, udhëheqësi i Departamentit Ligjor në Telekom thotë se gjetjet e tyre nuk ishin respektuar nga Bordi”. Betimi për Drejtësi. 10 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-z-mobile-udheheqesi-i-departamentit-ligjor-ne-telekom-thote-se-gjetjet-e-tyre-nuk-ishin-respektuar-nga-bordi/> )

kishte deklaruar ish-ushtuesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të PTK-së, Mehdi Latifaj, i cili kishte thënë se kontrata e lidhur mes PTK dhe Z-Mobile kishte pasur mangësi juridike.<sup>95</sup>

Në seancën të mbajtur me 22 gusht 2019, ish-menaxheri i sigurimit të të hyrave në njësinë “Vala”, Arben Shabani kishte deklaruar se në kontratën e lidhur me Z-Mobile nuk ishin paraparë shërbimet 3G dhe 4G.<sup>96</sup>

Në seancën e mbajtur më 10 tetor 2019, drejtuesit e kompanisë Dardanfon.net, përkatësisht Z-Mobile, Blerim Devolli dhe Milot Gjokolli e kishin njoftuar Gjykatën Themelore në Prishtinë, se ata nuk e ndiejnë veten të dëmtuar dhe nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale, në rastin e ish-drejtuesve të Telekomit të Kosovës. Gjatë kësaj seance, këshilltari ligjor në Darafon.net, Valon Basha ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, si dhe ishin administruar provat e propozuara në aktakuzë, si dhe ishin propozuar prova të reja nga ana e mbrojtjes.<sup>97</sup>

Gjatë seancës së 11 tetorit, Agron Mustafa kishte shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore për tu mbrojtur në heshtje, ndërkaq Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj kishin mohuar akuzën.<sup>98</sup>

Më 18 tetor 2019, gjatë dhënies së fjalës përfundimtare, tre ish-drejtuesit e Postës dhe Telekomit të Kosovës, tash Telekomit të Kosovës, Agron Mustafa, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj, kishin kërkuar që të shpallen të pafajshëm lidhur me akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare.<sup>99</sup>

Në anën tjetër, prokurori Naim Abazi, kishte kërkuar dënimin e tyre, e kishte thënë se nga kontrata me Z-Mobile janë dëmtuar xhepat e qytetarëve.<sup>100</sup>

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 21 tetor, ka shpallur aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve. Sipas kryetarit të trupit gjykues gjykatësit Lutfi Shala, ky trup gjykues nuk ka gjetur se të

---

<sup>95</sup> “Ish-ushtuesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të PTK-së thotë se marrëveshja me Z-Mobile kishte mangësi juridike”. Betimi për Drejtësi. 8 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-ushtuesi-i-detyres-se-kryeshefit-ekzekutiv-te-ptk-se-thote-se-marreveshja-me-z-mobile-kishte-mangesi-juridike/>)

<sup>96</sup> “Zyrtari i Telekomit thotë se në kontratën me Z-Mobile nuk ishin paraparë shërbimet 3G dhe 4G”. Betimi për Drejtësi. 22 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zyrtari-i-telekomit-thote-se-ne-kontraten-me-z-mobile-nuk-ishin-parapare-sherbimet-3g-dhe-4g/>)

<sup>97</sup> “Gjykimi ndaj ish-drejtuesve të Telekomit të Kosovës, Z-Mobile thotë se nuk e ndien veten të dëmtuar”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2019 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-drejtuesve-te-telekomit-te-kosoves-z-mobile-thote-se-nuk-e-ndien-veten-te-demtuar/>) .

<sup>98</sup> “Gjykimi për kontratën me Z-Mobile, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj mohojnë akuzën, Agron Mustafa mbrohet në heshtje” Betimi për Drejtësi. 11 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-kontraten-me-z-mobile-ejup-qerimi-dhe-rexhe-gjonbalaj-mohojne-akuzen-agron-mustafa-mbrohet-ne-heshtje/>).

<sup>99</sup> “Ish-drejtuesit e Telekomit kërkojnë të lirohen nga akuzat për korrupsion në rastin e kontratës me Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2019 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtuesit-e-telekomit-kerkojne-te-lirohen-nga-akuzat-per-korrupsion-ne-rastin-e-kontrates-me-z-mobile/>) .

<sup>100</sup> “Prokurori kërkon dënimin e ish-drejtuesve të Telekomit, thotë se nga kontrata me Z-Mobile u dëmtuan xhepat e qytetarëve” Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2019 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-kerkon-denimin-e-ish-drejtuesve-te-telekomit-thote-se-nga-kontrata-me-z-mobile-u-demtuan-xhepat-e-qytetareve/>) .

akuzuarit kanë kryer veprën penale. Ai kishte thënë se pas dëgjimit të dy të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe provave materiale, nuk është vërtetuar pretendimi i Prokurorisë Speciale.<sup>101</sup>

“Pas procedimit të provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarëve dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën në kuptim të nenit 361 par. I dhe 2 të KPPRK-së, ky trup gjykues nuk gjeti se të akuzuarit të kenë kryer veprën penale për të cilën i ngarkon akuza”, thuhet në një pjesë të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Gjykatësi Shala, me arsyetimin e tij kishte vlerësuar se trupi gjykues i drejtuar nga ai, ka gjetur se janë të pabazuara të gjitha provat me të cilat prokuroria pretendon me aktakuzën e saj se tre të akuzuarit në periudhën kohore prej shkurt 2012, e deri në shkurt të vitit 2015, nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare, me qëllim që t'i shkaktojnë dëm të dëmtuarës “Z-Mobile”, duke mos zbatuar kontratën me numër 01-156/09, të datës 16 janar 2009.

Sipas Shalës, gjykata ka gjetur se të gjitha provat e propozuara nga PSRK-ja, si dëshmitar, e po ashtu edhe provat tjera materiale vetëm kanë konstatuar ekzistimin e një marrëdhënieje kontraktuale juridiko-civile dhe asgjë më shumë.

Tutje, edhe pse gjykata kishte vlerësuar se nga kjo kontratë e lidhur në mes palëve ka mundur t'i shkaktohet dëm PTK-së, me asnjë provë thuhet se nuk është vërtetuar se për këto dëme janë fajtorë të akuzuarit, pasi kanë munguar elementet e dashjes dhe përfitimit.

“Trupi gjykues ka vlerësuar se në rastin konkret, mund të jetë shkaktuar dëmi lidhur me mos zbatimin e kontratës, mirëpo assesi nuk është vërtetuar se dëmi është shkaktuar me dashjen e të pandehurve. Kjo së paku nuk është arrit të vërtetohet me provat që ka prezantuar prokuroria si organ i ndjekjes që obligohet që ti provojë para gjykatës pretendimet e prezantuara ne aktakuzë”, është thënë në arsyetimin e gjykatës.<sup>102</sup>

Mirëpo në maj të këtij viti, Gjykata e Apelit e ka kthyer në rigjykim rastin e tre ish-drejtuesve të Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK)<sup>103</sup>.

Vendimi i Apelit është marr pas ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), kundër aktgjykimit lirues të shpallur nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për shkak të pretendimeve për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

PSRK kishte propozuar që aktgjykimi në fjalë të anulohet nga Apeli dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendim

---

<sup>101</sup> “Tre ish-drejtuesit e Telekomit të Kosovës lirohen nga akuzat lidhur me kontratën me Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 21 tetor 2019. ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/tre-ish-drejtuesit-e-telekomit-te-kosoves-lirohen-nga-akuzat-lidhur-me-kontraten-me-z-mobile/>).

<sup>102</sup> “Arsyetimi i gjykatës për lirimin e tre ish-drejtuesve të Telekomit nga akuzat lidhur me kontratën me Z-Mobile” Betimi për Drejtësi. 21 tetor 2019 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-gjykatës-per-lirimin-e-tre-ish-drejtuesve-te-telekomit-nga-akuzat-lidhur-me-kontraten-me-z-mobile/>).

<sup>103</sup> Pas ankesës së PSRK-së, Apeli e kthen në rigjykim rastin “Posta”, Betimi për Drejtësi. 7 maj 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-ankeses-se-psrk-se-apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-posta/>).

Në vendimin e Gjykatës së Apelit, të siguruar nga “Betimi për Drejtësi”, thuhet se janë të bazuara pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.<sup>104</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Rreth 30,000,000 euro.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>104</sup> Arsyetimi i Gjykatës së Apelit për kthimin në rigjykim të rastit “Posta” Betimi për Drejtësi. 7 maj 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-gjykates-se-apelit-per-kthimin-ne-rigjykim-te-rastit-posta/>).

- **Rasti i ish-Kryetarit të Suharekës, Sali Asllanaj dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prizren
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.87/18
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Artan Sejerani
<b>Prokuror:</b>	Ervehe Gashi
<b>Të pandehur:</b>	Sali Asllanaj, Sherif Berisha dhe Milazim Hajdari
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, kanë kaluar 417 ditë**



Prokuroria Themelore në Prizren, më 26 dhjetor 2017, kishte filluar hetimet kundër tre të akuzuarve të lartcekur si dhe Avni Bytyqit, kurse më 22 tetor 2018, ka ngritur aktakuzë kundër ish-kryetarit të Komunës së Suharekës, Sali Asllanaj, Sherif Berishës në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Suharekë dhe Milazim Hajdarit në cilësinë e drejtorit të ShFMU “Bajram Curri. Ndaj të pandehurit Avni Bytyqi ishin pushuar hetimet.

Sipas aktakuzës, të pandehurit dyshohen se duke e shfrytëzuar pozitën zyrtare, i tejkalojnë kompetencat e tyre me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për personin tjetër, lidhur me Marrëveshjen për Mirëkuptim dhe Bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Suharekës dhe OJQ-së “Kosovo Hope” për projektin “Transporti i nxënësve”, duke shkelur Ligjin e Prokurimit Publik nr.04/L-042, Ligjin për menaxhimin e financave publike nr.03/L-048, si dhe Rregulloren financiare nr.01/2013, me ç ‘rast i shkaktojnë dëm buxhetit të Kosovës në shumën totale prej 10.556.00 euro.

## Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Shqyrtimi fillestar është mbajtur më 19 nëntor 2018, brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në KPPRK për mbajtjen e shqyrtimit fillestar pas ngritjes së aktakuzës, në të cilin shqyrtim të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm. Edhe shqyrtimi i dytë është përcaktuar brenda afatit ligjor, më 21 dhjetor 2018.

Pasi ishte konfirmuar aktakuza<sup>105</sup>, shqyrtimi gjyqësor kishte nisur pas 12 ditësh, konkretisht më 27 shkurt 2019, ndërsa pas kësaj seance janë mbajtur edhe tri (3) seanca gjyqësore, ndërsa seanca e caktuar më 29 gusht 2019, ka dështuar për shkak të mungesës së anëtares së trupit gjykues e cila gjendej në pushim mjekësor.<sup>106</sup>

Në seancës e 26 shtatorit 2019 ka vazhduar shqyrtimi gjyqësor, ku është marrë në pyetje një ekspert financiar, ndërsa në seancën e radhës e cila është caktuar më 21 nëntor 2019 është paraparë që të jepet mbrojtja e të akuzuarve. Me 9 dhjetor 2019 është dhënë fjala përfundimtare në këtë rast, ku prokurorja e rastit, Ervehe Gashi, ka kërkuar dënimin e tre të akuzuarve, ndërsa mbrojtja ka kërkuar që të akuzuarit të lirohen nga akuza.<sup>107</sup>

Me 12 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Prizren i ka liruar nga akuza tre të akuzuarit në këtë rast.<sup>108</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 10,556.00 euro

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>105</sup> “Apeli konfirmon aktakuzën për korrupsion ndaj ish-kryetarit të Suharekës, Sali Asllanaj dhe dy të tjerëve” Betimi për Drejtësi. 15 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-aktakuzen-per-korrupsion-ndaj-ish-kryetarit-te-suharekes-sali-asllanaj-dhe-dy-te-tjereve/>)

<sup>106</sup> “Mungon anëtarja e trupit gjykues, dështon gjykimi për korrupsion ndaj ish-kryetarit të Suharekës dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi. 29 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-anetarja-e-trupit-gjykues-desh-ton-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-ish-kryetarit-te-suharekes-dhe-te-tjereve/>)

<sup>107</sup> “Prokurori kërkon dënimin e ish-kryetarit të Suharekës dhe dy të tjerëve, ata kërkojnë pafajësinë”. Betimi për Drejtësi. 9 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-kerkon-denimin-e-ish-kryetarit-te-suharekes-dhe-dy-te-tjereve-ata-kerkojne-pafajesine/>)

<sup>108</sup> “Ish-kryetari i Suharekës dhe dy të tjerët lirohen nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 12 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-suharekes-dhe-dy-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>)

- **Rasti i ish-gjykatësit Kolë Puka dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PS.nr.24/19
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Fillimisht Hamdi Ibrahim, pastaj Musa Kongjeli
<b>Prokuror:</b>	Fillimisht ka qenë Ali Rexha, më pas Fikrije Fejzullahu
<b>Të pandehur:</b>	Kolë Puka, Zef Marleku, Lon Palushaj, Isa Salih, Fatbardh Makolli dhe Besnik Nikqi
<b>Veprat penale:</b>	“Krim i organizuar”, “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, “Keqpërdorim i pozitës apo autorizimit zyrtar”, “Mashtrimi”, “Keqpërdorim i besimit”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces



➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 2,211 ditë**

Aktakuza e parë për këtë rast nga ana e PSRK-së ishte ngritur më 12 dhjetor 2013, ndërsa ishte precizuar me 14 nëntor 2014, 30 qershor 2017 dhe 14 gusht 2017. Sipas aktakuzës, të gjithë të pandehurit kishin marrë pjesë në grupin e strukturuar kriminal, i cili ka vepruar në kohë dhe hapësirë të caktuar e që objekt sulmi kanë qenë kompanitë e sigurimeve që kanë qenë duke vepruar në Republikën e Kosovës.

Këtë grup, aktakuza thotë se e ka krijuar, udhëhequr, mbikëqyrur e kontrolluar ish-gjykatësi i Klinës, Kolë Puka. Sipas aktakuzës, Puka arriti të krijojë marrëveshje me anëtarët e grupit kriminal që të imagjinojnë raste gjyqësore, të nxjerrin vendime të kundërligjshme, të falsifikojnë dokumente, të paraqesin rrejshëm fakte, të keqpërdoret pozita apo autoriteti zyrtar, si dhe të mos respektohet kompetenca gjyqësore. E krejt kjo, siç thuhet, me qëllim që



të ketë përfitim të kundërligjshëm të mjeteve financiare me vlera të mëdha, në dëm të të tjerëve në kohë sa më të shpejtë dhe sa më të lehtë.

Sipas aktit akuzues, Puka kishte lidhur marrëveshje për përfitim të kundërligjshëm me avokatë të cilët ishin të parët në zinxhirin e aktivitetit kriminal pas Kolë Pukës, si Zef Marleku dhe Lon Palushaj.

Në aktakuzë thuhet se Zef Marleku, i ka dhënë autorizim Pukës që të ketë qasje në xhironlogarinë e tij bankare, përmes të cilës ka operuar me vlera të mëdha në mënyrë të kundërligjshme. Pastaj, është lidhur marrëveshje me përfaqësuesit e Kompanive të Sigurimeve në mënyrë që gjatë shqyrtimit gjyqësor të pajtohen me propozimet-vendimet e Kolë Pukës nga pozita e gjyqtarit si Isa Salihaj, Fatbardh Makolli dhe Besnik Nikqi. E më tutje, aktakuza thotë se u krijua marrëdhënie edhe me mjekët specialistë, kryesisht të ortopedisë si tani të ndjerin Bedri Bakalli.

Ky aktivitet, sipas aktakuzës, ka zgjatur nga viti 2004, deri në vitin 2008. Me këtë aktivitet, sipas aktakuzës, kanë ndarë mes vete në mënyrë të kundërligjshme vlerën prej 1.225.927.93 euro. Aktakuza thotë se me veprimet e të gjithë të pandehurve, përfshihen elementet e veprës penale të krimit të organizuar.

Kolë Puka akuzohet për nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore e keqpërdorim të pozitës apo autorizimit zyrtar. Zef Marleku dhe Lon Palushaj akuzohen për keqpërdorim të besimit. Fatbardh Makolli dhe Besnik Nikqi akuzohen për mashtrim dhe keqpërdorim detyre, si dhe Isa Salihu akuzohet për keqpërdorim të pozitës apo autorizimit zyrtar.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Rasti ndaj ish-gjykatësit Kolë Puka dhe pesë të akuzuarve të tjerë është njeri nga rastet të cilat pasqyrojnë jo seriozitetin e sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të profilit të lartë, në të cilin rast pretendohet se dëmi është mbi një (1) milionë euro.

Kjo për arsye se edhe pse aktakuza ishte ngritur më 12 dhjetor të vitit 2013, ky rast është akoma në fazën fillestare. Pas shumë ndryshimeve të kësaj aktakuze seanca fillestare është arritur të mbahet më 26 shtator 2019 apo pas 2115 ditësh. Të gjithë të akuzuarit, janë deklaruar të pafajshëm lidhur me pretendimet e prokurorisë.<sup>109</sup>

Ky rast fillimisht kishte qenë në Departamentin e Krimeve të Rënda, mirëpo me funksionalizimin e Departamentin Special, në seancën e 17 prillit 2019, kishte kaluar në këtë departament. Në Departamentin e Krimeve të Rënda, gjykatësi Hamdi Ibrahimisi kishte dështuar të mbaj pesë seancat e caktuara, për arsye se në secilën prej tyre mungonte njëra nga palët, pa të cilat ishte e pamundur mbajtja e shqyrtimit fillestar.

<sup>109</sup> “Ish-gjykatësi Kolë Puka dhe pesë avokatë deklarohen të pafajshëm për krim të organizuar dhe korrupsion” Betimi për Drejtësi. 26 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-gjykatësi-kole-puka-dhe-pese-avokate-deklarohen-te-pafajshem-per-krim-te-organizuar-dhe-korrupsion/>)

Seanca e 26 janarit 2018 ishte shtyrë pasi nuk kishte prokurorë që përfaqësonte këtë lëndë,<sup>110</sup> ndërsa për shkak të mungesës së të akuzuarit Leon Perlaskaj kishin dështuar seancat e 31 majit, 3 dhe 22 tetorit 2018.<sup>111</sup>

Për shkak të themelimit të Departamentit Special brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjykatësi Ibrahimisi kishte njoftuar palët se seanca e 17 prillit 2019 nuk do të mbahej pasi kjo lëndë do të kalonte në atë departament, ndërsa edhe pas kalimit në këtë departament, gjykatësi i ri i kësaj lënde, Musa Konxheli, e kishte shtyrë seancën e 15 gushtit 2019 ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi fillestar, për shkak të mungesës së prokurores Fikrije Fejzullahu.<sup>112</sup>

Pas 5 seancave fillestare të cilat nuk kishin arritur të mbaheshin për shkaqe të ndryshme, me 26 shtator 2019 ishte mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ku të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.<sup>113</sup> Me 25 nëntor 2019 ishte paraparë të mbahej shqyrtimi i dytë në këtë rast, mirëpo i njëjti ishte shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit Isa Salihu. Mirëpo, në këtë seancë mbrojtësi i Pukës, avokati Nexhat Xharra, kishte kërkuar nga gjykata që ta sqarojë rrethanën nëse klienti i tij ishte duke u gjykuar për një çështje penale, për të cilën më parë është vendosur me vendim të formës së prerë. Lidhur me këtë prokurorja, Fikrije Fejzullahu kishte thënë se prokuroria do të kryej verifikime sipas detyrës zyrtare, por kishte thënë se i nevojitej që mbrojtja t'ia dorëzoj atyre numrat e këtyre aktgjykimeve.<sup>114</sup>

Mirëpo, shqyrtimi i dytë në këtë rast kishte dështuar të mbahej për të dytën herë, pasi në seancën e 13 dhjetorit 2019, kishte munguar i akuzuari Besnik Nikqi.<sup>115</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Mbi 1 milion euro

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>110</sup> "Lënda aktualisht pa prokuror, shtyhet gjykimi ndaj ish-gjykatësit Kolë Puka dhe të tjerëve" Betimi për Drejtësi. 26 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lenda-aktualisht-pa-prokuror-shtyhet-gjykimi-ndaj-ish-gjykatesit-kole-puka-dhe-te-tjereve/>)

<sup>111</sup> "Katër herë radhazi dështon gjykimi për krim të organizuar ndaj ish-gjykatësit Kolë Puka dhe të tjerëve" Betimi për Drejtësi. 22 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kater-here-radhazi-deshton-gjykimi-per-krim-te-organizuar-ndaj-ish-gjykatesit-kole-puka-dhe-te-tjereve/>)

<sup>112</sup> "Mungon prokurorja, dështon gjykimi për krim të organizuar ndaj ish-gjykatësit, Kolë Puka dhe avokatëve" Betimi për Drejtësi. 15 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurorja-deshton-gjykimi-per-krim-te-organizuar-ndaj-ish-gjykatesit-kole-puka-dhe-avokateve/>)

<sup>113</sup> "Ish-gjykatësi Kolë Puka dhe pesë avokatë deklarohen të pafajshëm për krim të organizuar dhe korrupsion". Betimi për Drejtësi. 26 shtator 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-gjykatesi-kole-puka-dhe-pese-avokate-deklarohen-te-pafajshem-per-krim-te-organizuar-dhe-korrupsion/>)

<sup>114</sup> "Mbrojtja e ish-gjykatësit Kolë Puka kërkon nga gjykata ta vërtetojë nëse klienti i tij po gjykohej për një çështje penale për të cilën është vendosur më herët". Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-e-ish-gjykatesit-kole-puka-kerkon-nga-gjykata-ta-vertetoje-nese-klienti-i-tij-po-gjykohet-per-nje-ceshtje-penale-per-te-cilen-eshte-vendosur-me-heret/>)

<sup>115</sup> "Mungon njëri i akuzuar, dështon gjykimi për krim të organizuar e korrupsion ndaj ish-gjykatësit Puka dhe avokatëve". Betimi për Drejtësi. 13 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-njeri-i-akuzuar-deshton-gjykimi-per-krim-te-organizuar-e-korrupsion-ndaj-ish-gjykatesit-puka-dhe-avokateve/>)

- **Rasti i ish-Kryetarit të Drenasit, Nexhat Demaku dhe një personi tjetër**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.242/18
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Shpresa Hasaj-Hyseni
<b>Prokuror:</b>	Dulina Hamiti
<b>Të pandehur:</b>	Nexhat Demaku dhe Sadik Tahiraj
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autorizimit zyrtar”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces

- **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 461 ditë**



Pas parashtrimit të kallëzimit penal nga ana e Policisë së Kosovës më 31 maj 2018, Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 6 gusht të atij viti, kishte filluar hetimet, të cilat pas pak muajsh kishin prodhuar aktakuzën, e cila ishte ngritur më 27 shtator 2018, e me të cilën ish-kryetari i Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku dhe ish-drejtori i arsimit të kësaj komune, Sadik Tahiraj, akuzohen se kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare.

Sipas aktakuzës, Nexhat Demaku akuzohet se duke shfrytëzuar detyrën zyrtare si kryetar i Komunës së Drenasit, i ka tejkalluar kompetencat e tij me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër.

Ai akuzohet se, më 10 mars 2015, ia ka lëshuar akt emërimit punëtore Mimoza Berisha në pozitën inspektore e tregut në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Drenasit, me kohëzgjatje prej datës 5 mars 2015 deri më 5 mars 2016, si dhe me datë 20 janar 2016 me numër 01-120-3424, në kohëzgjatje prej datës 5 mars 2015 deri më 5 qershor 2018, ia ka lëshuar akt emërimit Berishës, në Drejtorinë e Inspektoratit të Komunës së Drenasit, me

titullin e vendit të punës inspektore e tregut, pa pasur konkurs publik të shpallur, duke mos iu nënshtruar procedurave të rekrutimit-punësimit. Prokuroria për këtë veprim të Demakut, pretendon se Mimoza Berishës i ka sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm në vlerë prej 18,309.01 euro, ndërsa në këtë vlerë është dëmtuar Komuna e Drenasit.

Lidhur me punësimin e Mimoza Berishës, prokuroria po ashtu pretendon se ka keqpërdorur detyrën edhe ish-drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Drenasit Sadik Tahiraj. Sipas prokurorisë, Tahiraj duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, i ka tejkaluar kompetencat e tij me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër.

Ai akuzohet se, më 3 nëntor 2014, ia ka lëshuar kontratën e punës për mësimdhënës Mimoza Berishës, me titullin e vendit të punës, edukatore me parafillor në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Ali Gashi” në Drenas, si dhe ia ka lëshuar vendimin e datës 3 nëntor 2014 Berishës, në pozitën edukatore në atë shkollë, pa pasur konkurs publik të shpallur dhe e ka punësuar të njëjtën pa përgatitje shkollore adekuate, duke mos iu nënshtruar procedurave të rekrutimit-punësimit. Gjithmonë sipas aktakuzë, Tahiraj, më 5 mars 2015, ia ka lëshuar vendimin Mimoza Berishës për transferimin e saj në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Drenasit në vendin e punës inspektor i tregut, e me ç’rast edukatores Mimoza Berisha i ka sjell përfitim të kundërligjshme në vlerë prej 756.18 euro, ndërsa të dëmtuarës Komunës së Drenasit i ka shkaktuar dëm të buxhetit në vlerë prej 756.18 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Seanca fillestare në të cilën asnjëri nga të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë, ishte mbajtur më 21 nëntor apo pas afatit ligjor të përcaktuar më KPPRK. Ndërsa me propozimin e mbrojtjes nga gjykatësja Shpresa Hasaj-Hyseni, në kundërshtim me KPPRK, ishte vendosur që të mos lexohet aktakuza ndaj dy të pandehurve.

Pas kundërshtimeve të mbrojtës, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte refuzuar ato, ndërsa pas ankesave në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit, me arsyetimin se vendimi i shkallës së parë përmbante shkelje ligjore, kishte kthyer çështjen e konfirmimit të aktakuzës në rivendosje.<sup>116</sup>

Por edhe pas vendimit për kthimin në rivendosje, gjykata e shkallës së parë kishte konfirmuar përsëri aktakuzën, duke hedhur kundërshtimet e mbrojtjes.<sup>117</sup>

Pasi që aktakuza kishte marrë formën e prerë, i akuzuari Nexhat Demaku dhe mbrojtësi i tij Gazmend Halilaj, në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 24 maj 2019, kishte kërkuar përjashtimin e kryetares së trupit gjykues Shpresa Hasaj-Hyseni, me arsyetimin se

<sup>116</sup> “Apeli e kthen në rivendosje rastin ndaj ish-kryetarit të Drenasit, Nexhat Demaku” Betimi për Drejtësi. 13 shkurt 2019 ( Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-ndaj-ish-kryetarit-te-drenasit-nexhat-demaku/>)

<sup>117</sup> “Shkalla e parë përsëri konfirmon aktakuzën për korrupsion ndaj ish-kryetarit të Drenasit, Nexhat Demaku” Betimi për Drejtësi. 19 shkurt 2019 ( Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shkalla-e-pare-perseri-konfirmon-aktakuzen-per-korrupsion-ndaj-ish-kryetarit-te-drenasit-nexhat-demaku/>)

kjo gjyqtare kishte marrë pjesë në një proces tjetër në të cilin Demaku akuzohej për korrupsion. Sipas tij, Hasaj-Hyseni në atë proces ishte anëtare e trupit gjykues dhe ishte dënuar me një vit e pesë muaj burgim.<sup>118</sup>

Por, kjo kërkesë e Demakut ishte refuzuar nga ana e kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë Afërdita Bytyqi, ndërsa shqyrtimi gjyqësor ka nisur më 2 gusht 2019, në të cilën seancë përfaqësuesja ligjore e kësaj komune, Gentiana Morina, ka deklaruar se Komuna e Drenasit parashtron kërkesë pasurore-juridike në shumë prej 18,309 euro si palë e dëmtuar në këtë rast.

Në seancën e 3 tetorit 2019, ishte dëgjuar dëshmitarja Mimoza Berisha, ku pikërisht për punësimin e saj po akuzohen Demaku dhe Tahiraj. Ajo në këtë seancë kishte deklaruar se në pozitën ku ajo kishte punuar si inspektore e tregut nuk kishte pasur konkurs të shpallur.<sup>119</sup>

Me 18 dhjetor 2019, kishte dhënë mbrojtjen i akuzuari Nexhat Demaku i cili kishte mohuar në tërësi akuzat për keqpërdorim detyre<sup>120</sup>.

**Dëmi i pretenduar:** 19,065.19 euro

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>118</sup> “Ish-kryetari i Drenasit kërkon përjashtimin e kryetares së trupit gjykues në gjykimin për keqpërdorim detyre” Betimi për Drejtësi. 24 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-drenasit-kerkon-perjashtimin-e-kryetares-se-trupit-gjykues-ne-gjykimin-per-keqperdorim-detyre/>)

<sup>119</sup> “Gjykimi ndaj ish-kryetarit të Drenasit, dëshmitarja thotë se nga edukatore zëvendësuese e pa diplomë universiteti ishte punësuar pa konkurs si inspektore e tregut”. Betimi për Drejtësi. 3 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-kryetarit-te-drenasit-deshmitarja-thote-se-nga-edukatore-zevendesuese-e-pa-diplome-universiteti-ishte-punesuar-pa-konkurs-si-inspektore-e-tregut/>)

<sup>120</sup> “Ish-kryetari i Drenasit thotë se është i pafajshëm lidhur me akuzat për keqpërdorim detyre”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-drenasit-thote-se-eshte-i-pafajshem-lidhur-me-akuzat-keqperdorim-detyre/>)

- **Rasti i ish-Kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Pejë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.227/16
<b>Kryetar i Trupit Gjykues:</b>	Sylë Lokaj
<b>Prokuror:</b>	Agron Bajrami
<b>Të pandehur:</b>	Qemajl Mustafa dhe 38 të tjerë
<b>Veprat penale:</b>	“Krim i organizuar”, “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 1,202 ditë**



Policia e Kosovës, më 20 dhjetor 2013, kishte ushtruar kallëzim penal ndaj Qemajl Mustafës dhe të tjerëve, kurse aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë nga prokuroria më 6 nëntor 2015. Më 16 shtator 2016, PSRK kishte ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve: Qemajl Mustafa, Hatixhe Daku, Vehbi Geci, Qefsere Sadriu, Iljaz Rashiti, Musa Nasufi, Muhamet Kastrati, Heset Mahmuti, Fatmir Halili, Drita Bajrami, Agim Hoxha, Ramush Musliu, Selvije Shefkiu, Ganimete Kastrati, Shemsedin Qerimi, Merita Canaj-Shabanaj, Ibrahim Foniqi, Behar Mehmeti, Hamdi Ismajli, Fadil Osmani, Heset Asllani, Selver Xhelili, Qemajl Latifi, Enver Biqku, Asllan Mustafa, Naser Sylejmani, Zeqirja Fazliu, Azem Mujku, Nazim Jashari, Basri Kqiku, Avdi Pireva, Rrustem Hajdari, Florim Zuka, Skender Imeri, Naser Mehmeti, Mejdi Ahmeti, Burim Govori, Asllan Asllani dhe Asllan Sylja, për veprat penale “krimi i organizuar”, “shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit” dhe “keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi”.

Sipas aktakuzës, zyrtarët duke vepruar në cilësinë e personave zyrtarë, kanë keqpërdorë detyrën zyrtare, duke i tejkaluar kompetencat e tyre ose duke mos i përmbushur detyrat e tyre zyrtare.

Ndërsa të pandehurit tjerë, duke vepruar si pronarë apo përfaqësues të këtyre operatorëve ekonomik, kanë ushtruar veprimtari ekonomike me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për operatorin ekonomik tjetër, me rastin e ofertimit në aktivitete të prokurimit, pranë asaj komune.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Edhe pse aktakuza në këtë rast është ngritur para më shumë se dy viteve, gjykimi vazhdon të mbetet ende në fazën fillestare. Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte caktuar pas 431 ditëve, konkretisht më 19 prill 2017, mirëpo ishte shtyrë për shkak se disa nga të akuzuarit nuk kishin të angazhuar avokat mbrojtës.<sup>121</sup> Edhe shqyrtimi fillestar i paraparë të mbahej më 22 maj 2017 ishte shtyrë pasi që, me 11 maj 2017, gjykata ia kishte kthyer në plotësim aktakuzën PSKR- së.<sup>122</sup> Më 25 korrik 2017, gjykata e shkallës së parë e kishte hudhur pjesërisht si të parregullt aktakuzën e PSRK-së.<sup>123</sup> Pas ankesës së PSKR-së, Gjykata e Apelit, në shtator të 2017-tës, e kishte kthyer rastin në rivendosje.<sup>124</sup> Më 21 nëntor 2017, apo rreth 14 muaj pas ngritjes së aktakuzës, GjTh në Pejë kishte mbajtur shqyrtimin fillestar për këtë rast, ku të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.<sup>125</sup> Në prill 2018, gjykata e shkallës së parë sërish e kishte konfirmuar vetëm pjesërisht aktakuzën, mirëpo në shtator të të njëjtit vit, rasti është kthyer sërish në rivendosje nga Apeli, duke vazhduar kështu ping-pongun Themelore<sup>126</sup> - Apel.<sup>127</sup>

Në fillim të dhjetorit të vitit 2018, GjTh në Pejë kishte konfirmuar pjesërisht aktakuzën edhe njëherë ndaj Mustafës dhe të tjerëve për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe vepra tjera

<sup>121</sup> “Në mungesë të avokatëve, shtyhet gjykimi ndaj ish kryetarit të Gjilanit dhe 38 të pandehurve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 19 prill 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-mungese-te-avokateve-mbrojtesshtyhet-gjykimi-ndaj-ish-kryetarit-te-gjilanit-dhe-38-te-pandehurve-tjere/>)

<sup>122</sup> “Kërkohet plotësimi i akuzës në rastin e ish-kryetarit të Gjilanit, në të kundërtën paralajmërohet hedhja e saj”. Betimi për Drejtësi. 22 maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kerkohet-plotesimi-i-akuzesne-rastin-e-ish-kryetarit-te-gjilanit-dhe-38-te-pandehurve-tjere/>)

<sup>123</sup> “Hudhet pjesërisht aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe 38 të akuzuarve tjerë në këtë rast”. Betimi për Drejtësi. 2 gusht 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-pjeserisht-aktakuzandaj-ish-kryetarit-te-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-38-te-akuzuarve-tjere-ne-kete-rast-dokument/>)

<sup>124</sup> “Ish-kryetari i Gjilanit, Qemajl Mustafa kthehet në bankën e të akuzuarve për të gjitha pikat e aktakuzës”. Betimi për Drejtësi. 22 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-gjilanit-qemajlmustafa-kthehet-ne-banken-e-te-akuzuarve-per-te-gjitha-pikat-e-aktakuzes/>)

<sup>125</sup> “Ish-kryetari i Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe 38 të akuzuarit e tjerë deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 21 nëntor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-38-te-akuzuarit-e-tjere-deklarohen-te-pafajshem/>)

<sup>126</sup> “Konfirmohet pjesërisht aktakuza për korrupsion ndaj ish-kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 18 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-pjeserishtaktakuza-per-korrupsion-ndaj-ish-kryetarit-te-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-te-tjereve/>)

<sup>127</sup> “Apeli e kthen në rivendosje rastin e ish-kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe të akuzuarve tjerë për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 14 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-nerivendosje-rastin-e-ish-kryetarit-te-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-te-akuzuarve-tjere-per-korrupsion/>)

penale, por kishte konstatuar se në këtë aktakuzë nuk ka elemente të veprës penale të krimit të organizuar.<sup>128</sup>

Gjykata e Apelit kishte trajtuar përsëri këtë aktakuzë, por në shkurt të 2019-tës kjo gjykatë kishte aprovuar aktakuzën ndaj Mustafës dhe të tjerëve duke i hapur rrugë fillimit që përfundimisht të filloi shqyrtimi gjyqësor.<sup>129</sup>

Tentimi i parë për ta filluar shqyrtimin gjyqësor ishte bërë më 17 qershor 2019, por që kishte dështuar për shkak të mungesës së prokurorit Agron Bajrami.

Një dështim tjetër i fillimit të gjykimit është edhe seanca 27 qershorit 2019, në të cilin seancë e kishin munguar të akuzuarit Nazmi Jashari dhe Burim Govori, Sipas kryetarit të trupit gjykues, gjykatësit Sylë Lokaj, i akuzuari Jashari nuk kishte shkuar në gjykatë edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, kurse Govori e kishte njoftuar gjykatën se është jashtë shtetit.<sup>130</sup> Në këtë seancë, gjykatësi Lokaj po ashtu kishte thënë se nuk ishte faji i prokurorit Bajrami për mungesën e tij, pasi ishte vërtetuar se ftesa nuk kishte shkuar në mënyrë të rregullt.

Seanca e 14 tetorit ishte shtyrë, ndërsa në seancën e 18 tetorit 2019, mbrojtësi i të akuzuarit Qemajl Mustafa, avokati Ismet Shufta e kishte quajtur të anshme Gjykatën Themelore në Pejë, pasi sipas tij nuk iu ishte dhënë mundësia të kundërshtonte ekspertizën financiare të cilën e kishte kërkuar. Po ashtu, në këtë seancë ishte veçuar procedura ndaj të pandehurit Burim Govori, i cili sipas raportit policor gjendet jashtë shtetit për shkak të gjendjes shëndetësore, ndërsa ndaj Behar Mehmeti, gjykata kishte marrë vendim për pushimin e procedurës penale për shkak se ai ka ndërruar jetë.<sup>131</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Nuk ka informacion.

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>128</sup> Gjykata konfirmon aktakuzën për korrupsion ndaj Qemajl Mustafës, s'gjen krim të organizuar në veprimet e të akuzuarve". Betimi për Drejtësi. 6 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatakonfirmon-aktakuzen-per-korrupsion-ndaj-qemajl-mustafes-sgjen-krim-te-organizuar-ne-veprimet-e-teakuzuarve/>)

<sup>129</sup> "Apeli vendos që ish-kryetari i Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe 38 të akuzuar të tjerë të gjykohen për korrupsion dhe vepra tjera" Betimi për Drejtësi. 19 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-vendos-qe-ish-kryetari-i-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-38-te-akuzuar-te-tjere-te-gjykohen-per-korrupsion-dhe-vepra-tjera/>)

<sup>130</sup> "Serish dështon gjykimi ndaj ish-kryetarit të Gjilanit dhe të tjerëve, Qemajl Mustafa s'pajtohet që seanca është shtyrë për tetor" Betimi për Drejtësi. 27 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-deshton-gjykimi-ndaj-ish-kryetarit-te-gjilanit-dhe-te-tjereve-qemajl-mustafa-spajtohet-qe-seanca-eshte-shtyre-per-tetor/>)


<sup>131</sup> "Avokati i Qemajl Mustafës e quan të anshme Gjykatën e Pejës, gjykatësi kërkon përmbajtje nga komentet e tilla". Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avokati-i-qemajl-mustafes-e-quan-te-anshme-gjykatën-e-pejës-gjykatesi-kerkon-permbajtje-nga-komentet-e-tilla/>)



- **Rasti i ish-zëvendës ministrit të MSH-së, Bujar Bukoshi, ish-sekretarit të MSH-së, Ilir Tolaj dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.737/16
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Naime Krasniqi-Jashanica
<b>Prokuror:</b>	Fikrije Fejzullahu
<b>Të pandehur:</b>	Bujar Bukoshi, Ilir Tolaj, Arbenita Pajaziti, Hajrullah Fejza, Zenel Kuqi dhe Bekim Fusha
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autorizimit zyrtar”, “Marrja e ryshfetit”
<b>Faza e procedurës:</b>	Aktgjykim i shkallës së parë

- **Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit të fundi për këtë rast nga shkalla e parë, kanë kaluar 2,693 ditë**



Aktiviteti për fillim të hetimeve ndaj të akuzuarve në këtë rast ishte nxjerrë më 28 dhjetor 2008, kurse aktakuza ishte ngritur më 16 korrik 2012.

Aktakuza e përpiluar nga Prokurorja Speciale e EULEX-it, Maria Bamieh, e ngarkon Ilir Tolajn, Arbenita Pajazitin, Ismet Hysenin, Zenel Kuqin, Hajrullah Fejzën, Bekim Fushën, Alban Thaçin, Basri Asllanin, Bujar Bukoshin, Nexhat Shabanin dhe Imer Ajeti me kryerjen e veprës penale “shpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Në seancën e mbajtur më 5 qershor 2018, prokurorja speciale Fikrije Fejzullahu kishte bërë ndryshimin e aktakuzës në këtë rast.<sup>132</sup>

<sup>132</sup> “Prokuroria bën ndryshimin e aktakuzës ndaj Ilir Tolajt, Bujar Bukoshit e të tjerëve, mbrojtja thotë se është

Me aktakuzën e ndryshuar të dorëzuar në Gjykatë, Ilir Tolaj, Arbenita Pajaziti, Zenel Kuqi, Hajrullah Fejza, Bekim Fusha e Bujar Bukoshi akuzohen për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit”, nga neni 339 i Kodit të Përkohshëm Penal, aktualisht e penalizuar me paragrafin 1 të nenit 422 dhe 423 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal. Në aktakuzë thuhet se Ilir Tolaj, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) dhe Arbenita Pajaziti, zyrtare për furnizim në MSH, mes datës 26 shtator 2007 dhe 1 tetor 2007, kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare duke lejuar në kontratë ligjërisht të detyrueshme me “Jona Med” të kalonte pa respektuar kushtet dhe kriteret e saj. Sipas aktit akuzues, “Jona Med”, kishte ushtruar padi kundër MSH për lejimin e dështimit të kontratës pa përmbushur detyrimet e saj nën të dhe pastaj lidhjen e kontratës me kompani të tjera farmaceutike, e kontrata kishte qenë në vlerë prej 3.8 milionë euro. Padia kishte qenë e suksesshme, e aktakuza thotë se Gjykata Ekonomike ka marr vendim për dëmshpërblim kundër MSH në vlerë prej 1.5 milionë, përveç kostove të drejtimit të procesit të ri dhe të panevojshëm të tenderit.

Ilir Tolaj, më tutje thuhet se ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare, pasi i ka thënë komisionit vlerësues se cili operator duhet të zgjidhet në dy tenderë emergjentë, një tender kishte thënë t’i jepet “Koslabor” e tjetri Kompanisë Ekskluziv nga Gjilani. Sipas aktit akuzues pronari i kësaj të fundit, Burim Shkodra kishte qenë student i Tolaj e në lidhje me Arbenita Pajazitin pasi kjo e fundit i kishte shitur licencën e saj vëllait të Arsim Shkodrës. Sipas akuzës, Tolaj nuk ka dëshiruar të ndërronte kontratat ekzistuese të MSH sepse dëshironte që të lëshonte kontratë të reja në interesa të veta dhe për përfitimin material të atyre me të cilët kishte lidhje financiare ose ndryshe.

Kurse, Pajaziti, akti akuzues thotë se ka keqpërdorur detyrën e saj zyrtare pasi nuk ka deklaruar konfliktin e interesit dhe nuk është larguar nga komisioni i vlerësimit. Tolaj dhe Pajaziti, akuzohen se kanë kërkuar vet e përmes Alban Pozhegut, nga Raimonda Hyseni për të nënshkruar se kinse ka marrë pjesë në vlerësimin e tenderëve, kur ajo nuk kishte marrë pjesë fare. Një gjë e tillë, konsiderohet se u ka mundësuar fituesve të tenderëve përfitime materiale. Sipas akuzës, procedurat tenderuese për këto kontrata nuk kanë qenë në përputhshmëri me Ligjin për Prokurimin Publik të 15 Janar 2004.

Tutje, në akuzë thuhet se Tolaj e Pajaziti kanë keqpërdorur pozitat e tyre në nëntor dhe dhjetor të vitit 2007, duke takuar furnizuesit në datë të ndryshme ndërmjet 15 dhe 18 nëntorit dhe duke u kërkuar furnizuesve të cilët nuk kanë mundur të furnizojnë deri më 21 dhjetor 2007, të sigurojnë garanci bankare. Akuza thotë se garancitë bankare ishin mënyrë që furnizuesit të paguhen nga buxheti financiar i vitit aktual për mallra që do të dorëzohen në vitin e ardhshëm financiar. Pajaziti, sipas akuzës, i ka thënë komisionit për pranim që të nënshkruante një deklaratë të rrejshme të pranimi të barnave nga furnizuesit të cilët nuk ishin në gjendje të furnizonin MSH para 21 dhjetor 2007. Tolaj e Pajaziti, thuhet se kanë bërë të mundur që furnizuesit të merrnin një përfitim material, domethënë pagesa paradhënie me

mashttrim, e Pajaziti thuhet se ka mashtruar Ministrinë e Financave duke i thënë Komisionit për Pranim të nënshkruaj certifikata të rreme të pranimit duke pretenduar se malli ishte marrë kur në fakt nuk kishte qenë kështu.

Më tej, thuhet se kur produktet janë pranuar pas 21 dhjetor 2007, ato nuk kanë qenë në përputhje me kontratat. Sipas akuzës, më tutje thuhet se Tolaj ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare duke drejtuar një fushatë për të dëmtuar “Jona Med” e këtë duke u siguruar që kjo kompani të mos fitojë asnjë kontratë nga MSH, duke dërguar inspektor dhe duke kërkuar që t’i dënojnë, duke bërë kallëzime penale dhe padi civile ndaj “Jona Med” dhe duke përdorur ndikimin e tyre për të siguruar që “Jona Med” të mos merrte licencat e importit dhe eksportit. Ilir Tolaj dhe Bujar Bukoshi, akuzohen se kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare në qershor të 2010, kur Tolaj ishte këshilltar personal i Bujar Bukoshit, sipas aktakuzës, Tolaj ka përdorur influencën e tij si Këshilltar që kontrata një plus e fituar nga “Jona Med” të mos vazhdohet. Edhe pse kontratat kanë qenë të hartuara, Bujari Bukoshi nuk kishte nënshkruar kontratat për “Yess Pharm” apo për “Jona Med”. Dy kompanitë kanë ngritur padi civile kundër Ministrisë. Tolaj, Fejza, Fusha, dhe Kuqi, sipas aktakuzës, mes 1 mars 2011 dhe 30 prill 2011 kanë shpërdorur detyrën zyrtare duke ndarë kontratë për “Lirimed”.

Nuk i’u kanë përmbajtur procedurave të prokurimit pasi ka ekzistuar një raport përfundimtar i nënshkruar, me të cilin i është ndarë kontrata “Jona Med”. Kuqi, udhëheqës i prokurimit, thuhet nuk e ka nënshkruar, dhe komisioni vlerësues ka vazhduar duke i ndarë kontratën kompanisë që nuk i përmbush kriteret e tenderit. Tolaj, dhe Kuqi, akuzohen se kanë shpërdorur detyrën zyrtare nga 1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2011 duke shpallur dhe pastaj pa ndonjë arsye të mirë duke anuluar tenderët për barëra esenciale për pacientë, “Beta”, “Interfon” dhe “Fluradabine”. Pronari i kompanisë që furnizonte me këto barëra, sipas aktakuzës nuk është pëlqyer nga Ministria, dhe në vend së të përdornin përjashtime nga Ligjet e Prokurimit, këta të fundit kanë vazhduar me heqjen dhe anulimin e tenderëve për këto barëra.

Zenel Kuqi, thuhet se ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare duke mos mbajtur shënimet për lotet 72 dhe 73 të cilat përmbanin dosjet e Sante Pharm, e kjo sipas akuzës ka nënkuptuar se nuk ka qenë e mundur të sfidohej vendimi për këto lote. Ilir Tolaj dhe Arbenita Pajaziti akuzohen për shpërdorim të pozitës zyrtare në tentativë. Ata thuhet se kanë tentuar të keqpërdorin detyrat zyrtare. Sipas akuzës, më 30 nëntor 2011 ose rreth kësaj date, Bekim Dëshishku ishte thirrur në takim për të zgjidhur një kontest civil ndërmjet palëve. Në takim kishin qenë të pranishëm ehe Tolaj, Pajaziti e Ismet Hyseni. Në këtë takim thuhet se Pajaziti i kishte thënë Dëshishkut që ta tërheq padinë që e kishte ngritur në Gjykatën Ekonomike.

Sipas akuzës, Dëshishkut i ishte thënë se nëse ai vepron kështu do të merrte një kontratë me një tender të emergjencës në vlerë prej 70.000 euro dhe do të konsiderohej i favorshëm për tenderët e ardhshëm. Të pandehurit Tolaj, Pajaziti dhe Hyseni pretendohet se me 30 nëntor 2011 kanë duke tentuar t’i japin kompanisë “Jona Med” përfitim material në vlerë prej 5.000 eurove duke fituar një tender dhe kontratë në vlerën prej 70.000 euro. duke vepruar jashtë autoritetit të tyre financiar. Hajrullah Fejza, shef i atëhershëm i kontrollit të cilësisë, akuzohet se duke vepruar si zyrtar i MSH-së, në data të ndryshme ka kërkuar ryshfet. Tolaj e Fejza,

akuzohen se kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare rreth ose në 24 dhjetor 2010 duke ndërhyrë në procesin e tenderit për Glivek duke insistuar që zyrtari i prokurimit Enver Maliqi të nënshkruaj dhënien e tenderit për “Farmkos”, kur kjo ishte shkelje e patentetës ndërkombëtare të Novartis. Ata thuhet se kanë insistuar që Maliqi të nënshkruante raste për lote ku kishte vetëm dy oferta, ndërsa ligji kërkonte tre oferta të përgjegjshme.

### **Pretendimet e aktakuzës së mëparshme:**

Aktakuza e përpiluar nga Prokurorja Speciale e EULEX, Maria Bamieh, ngarkon Ilir Tolaj, Arbenita Pajaziti, Ismet Hyseni, Zenel Kuqi, Hajrullah Fejza, Bekim Fusha, Alban Thaçi, Basri Asllani dhe Bujar Bukoshi, Nexhat Shabani, Imer Ajeti me kryerjen e veprës penale “shpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas aktakuzës, Ilir Tolaj, në atë kohë sekretar i përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë, Arbenita Pajaziti, dhe Ismet Hyseni si zyrtarë në po atë Ministri, në një datë mes 26 shtatorit 2007 dhe 1 tetorit 2007 kanë shpërdoruar detyrat zyrtare, duke lejuar një kontratë të obligueshme ligjore me kompaninë “Jona Med”, të skadojë pa përmbushur kushtet. Pas padisë të “Jona Med” ndaj Ministrisë së Shëndetësisë, buxhetit të Kosovës iu shkaktua humbje prej 1.5 milion euro. E tëra kjo si pasoje të mosnjohjes së obligimeve kontraktuale ndaj kompanisë “Jona Med” dhe ndërprerjes së kontratës nga Ilir Tolaj.

Tutje, sipas aktit akuzues, Tolaj akuzohet se shpërdoroi detyrën e tij zyrtare, duke i thënë komisionit vlerësues se kush duhet të zgjidhet në dy tenderë emergjent, duke udhëzuar një tender t’i jepej “Koslabor”, ndërsa tjetri “Exclusive Company”. Sipas aktakuzës, Tolaj nuk ka dashur të respektoj kontratën ekzistuese të Ministrisë së Shëndetësisë, pasi ka dashur të lëshoj kontrata të reja në interes të tij dhe për përfitime materiale për ata me të cilët kishte lidhje financiare apo lidhje të tjera.

Tolaj dhe Pajaziti, akuzohen se kanë kërkuar nga Raimonda Hyseni për të nënshkruar se kinse ka marrë pjesë në vlerësimin e tenderëve, kur ajo nuk kishte marrë pjesë fare. Një gjë e tillë, konsiderohet se u ka mundësuar fituesve të tenderëve përfitime materiale. Fituesit kanë marrë kontrata substanciale, ku procedurat tenderuese për këto kontrata nuk kanë qenë në përputhshmëri me Ligjin për Prokurimin Publik të 15 Janar 2004.

Arbenita Pajaziti, sipas aktakuzës, ka keqpërdorur detyrën zyrtare, duke mos deklaruar se ka konflikt interesi dhe duke mos përjashtuar veten nga komisioni vlerësues për tenderë.

Tolaj, Pajaziti, Hyseni, Kuqi, Fejza, dhe Bukoshi, akuzohen se kanë shpërdoruar detyrat zyrtare duke udhëhequr një fushatë për të dëmtuar kompaninë “Jona Med”. Këtë veprim akuzohen se e kanë bërë duke u siguruar që “Jona Med” të mos marrë asnjë kontratë nga Ministria e Shëndetësisë, duke dërguar inspektorë te kompania në fjalë dhe duke u kërkuar që ta dënojnë, dukë përgatitur një numër të tepruar të kallëzimeve penale dhe padive civile

kundër kompanisë “Jona Med”, dhe duke përdorur influencën e tyre për të siguruar që kjo e fundit të mos marrë licencë për import- eksport.

Illir Tolaj dhe Bujar Bukoshi, akuzohen se kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare në qershor të 2010, kur Tolaj ishte këshilltar personal i Bujar Bukoshit, sipas aktakuzës, Tolaj ka përdorur influencën e tij si Këshilltar që kontrata një plus e fituar nga “Jona Med” të mos vazhdohet. Edhe pse kontratat kanë qenë të hartuara, Bujari Bukoshi nuk kishte nënshkruar kontratat për “Yess Pharm” apo për “Jona Med”. Dy kompanitë kanë ngritur padi civile kundër Ministrisë.

Tolaj, Fejza, Fusha, dhe Kuqi, sipas aktakuzës, kanë shpërdorur detyrën zyrtare duke ndarë kontratë për “Lirimed”. Nuk i’u kanë përmbajtur procedurave të prokurimit pasi ka ekzistuar një raport përfundimtar i nënshkruar, me të cilin i është ndarë kontrata “Jona Med”. Raportin Kuqi nuk e ka nënshkruar, dhe komisioni vlerësues ka vazhduar duke i ndarë kontratën kompanisë që nuk i përmbush kriteret e tenderit.

Tolaj, Fusha dhe Kuqi, akuzohen se kanë shpërdorur detyrën zyrtare duke publikuar dhe pastaj pa ndonjë arsye të mirë duke anuluar tenderët për barëra esenciale për pacientë, “Beta”, “Interfon” dhe “Fluradabine”. Pronari i kompanisë që furnizonte me këto barëra, sipas aktakuzës nuk është pëlqyer nga Ministria, dhe në vend së të përdornin përjashtime nga Ligjet e Prokurimit, këta të fundit kanë vazhduar me heqjen dhe anulimin e tenderëve për këto barëra.

Fejza, Tolaj, Fusha, gjithashtu akuzohen se Fadil Lubeniqit që kishte fituar një tender për furnizimin e pikave intravenoze ,ku çmimi për një infuzion ishte 36 cent ndërsa Lubeniqi fitonte 2 cent, nuk ia kanë vazhduar kontratën pasi i njëjti nuk ka pranuar të paguaj 10% për të vazhduar kontratën. Dhe më pas kontratën ia kanë dhënë kompanisë “EXCLUSIVE” ku çmimi ishte 45 cent për infuzion, 9 cent më shtrenjtë nga që i ishte paguar Lubeniqit për infuzion.

Kuqi, gjithashtu akuzohet se ka shpërdorur pozitën zyrtare, duke dështuar në ruajtjen e dokumenteve të tenderëve. I njëjti, ka pasur për obligim të arkivojë dokumentacionin e plotë të tenderëve. Edhe pse këto dokumente janë kërkuar nga Prokuroria, asnjë kopje nuk është dorëzuar as gjetur gjatë bastisjes së Ministrisë.

Të pandehurit Tolaj, Pajaziti dhe Hyseni pretendohet se me 30 nëntor 2011 kanë duke tentuar t’i japin kompanisë “Jona Med” përfitim material në vlerë prej 5.000 eurove. Duke fituar një tender dhe kontratë në vlerë prej 70.000 eurove duke vepruar jashtë autoritetit të tyre financiar.

Në periudhën kohore prej 1 qershorit 2010 deri më 11 janar 2012, Tolaj bashkë me Fushën pretendohet se kanë keqtrajtuar apo frikësuar persona për çka akuzohen për veprën penale “keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”.

Duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kodin Penal të Kosovës Tolaj bashkë me Pajazitin dhe Hysenin u kanë dhënë përfitim material furnizuesve të medikamenteve apo mundësinë për përmbushjen e kontratave me anë të pagesave në avans. Për më tepër Pajaziti supozohet se në fund të vitit 2007 i kishte thënë komisionit pranues që të nënshkruajnë pranim të falsifikuar të medikamenteve nga këta furnizues.

Sipas aktakuzës, Tolaj, Pajaziti dhe Hyseni në vitin 2007 kanë anuluar obligimet ndaj “Jona Med”-it dhe operatorëve tjerë që t’iu japin kontratat atyre me të cilët kishin interes, duke i shkaktuar humbje buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Ndërsa në vitin 2011 të pandehurit e lartpërmendur së bashku me Fejzën, Fushën dhe Kuqin kanë hyrë në një kontratë dëmtuese duke i shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës në vlerë prej 1.5 milionë euro për një periudhë tri vjeçare.

Tolaj sipas aktakuzës kishte përfituar shumë në vlerë prej 5.000 eurove nga një vendim i Nexhat Shabanit atëherë kryesues i Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me një tender të Ministrisë së Shëndetësisë. Edhe Shabani pretendohet se ka marr shpërblim duke lëshuar këtë vendim i cili nuk ishte i regjistruar as vulosur e as arkivuar.

Tolaj dhe Fejza duke vepruar si zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë kanë kërkuar ryshfet nga persona të ndryshëm për fitimin e kontratave.

Tolaj sipas aktakuzës ka procesuar shuma të mëdha parash shume iu shmangur tatimit. Ai gjithashtu pretendohet se nuk ka paguar taksë në vlerë që kalon shumë prej 15.000 eurove.

Tolaj dhe Imer Ajeti, gjatë vitit 2012, sipas aktakuzës kanë tentuar t’i pengojnë hetimet e këtij rasti përmes ndërmjetësuesit që të njëjtit të kontaktojnë me Kryeprokurorin e EULEX-it dhe Kryetarin e Asamblesë së Gjykatave të EULEX-it për të larguar prokurorin e rastit dhe për ta hedhur poshtë rastin ndaj tyre.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin e nxjerrë më 19 korrik të vitit 2013, ish-sekretarin e përhershëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolajn, e ka dënuar me 10 muaj burgim për “nxitje të falsifikimit të dokumenteve zyrtare”, kurse me 9 muaj burgim për “shmangie nga tatimi”. Gjykata ka caktuar dënim unik prej 18 muajsh burgim, ku sipas aktgjykimit, të njëjtit, do t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Gjithashtu, për kryerjen e veprës penale të “shmangie nga tatimi” është dënuar me gjobë në vlerë prej 1000 euro.

Me këtë aktgjykim i është ndaluar edhe ushtrimi i funksioneve në administratë apo shërbim civil për 3 vjet.

Arbenita Pajaziti, është dënuar me 6 muaj burgim për kryerjen e veprës penale “nxitje të falsifikimit të dokumenteve zyrtare”, ndërsa edhe për një pikë tjetër të aktakuzës ku akuzohej për “nxitje të falsifikimit të dokumenteve zyrtare” është dënuar me 6 muaj burgim me kusht.

Gjykata i ka caktuar dënim unik prej 8 muajsh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse e njëjta nuk kryen veprë penale për periudhën kohore prej 2 vitesh, që nga momenti kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Pajazitit gjithashtu i ishte ndaluar ushtrimi i funksioneve publike në administratë apo shërbim publik për 2 vite.

Hajrullah Fejza, është dënuar për veprën penale marrje ryshfeti, me 6 muaj burgim. Gjykata i ka caktuar dënim unik prej 8 muajsh burgim. Sipas aktgjykimit, koha e paraburgimit, të njëjtit do t'i llogaritet në dënimin me burg. Edhe Fejzës i është ndaluar ushtrimi i funksioneve publike në administratë dhe shërbim publik për tri vite.

Për pikat e tjera të aktakuzës, të lartcekurit janë liruar nga akuzat. Bujar Bukoshi, ish-ministër i Shëndetësisë, me aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është liruar nga akuzat. Edhe të akuzuarit e tjerë, Ismet Hyseni, Zenel Kuqi, dhe Bekim Fusha janë liruar nga akti akuzues.

Pas ankesave të mbrojtjes së Ilir Tolajt, Arbenita Pajazitit, dhe Hajrullah Fejzës, në Gjykatën e Apelit, lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit kishte marrë këtë aktgjykim: aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës është anuluar në lidhje me pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 2, 3.1, 10 dhe 12 dhe lidhur me këto pika lënda është kthyer në rigjykim. Kurse, Apeli ka vërtetuar aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore, lidhur me pikat 1.4, 1.5, 11 si dhe pikat të cilat nuk ishin ankimuar nga prokurori 1.7, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 3.2, 6,8 dhe 9. Gjykata Supreme, ka miratuar kërkesën e mbrojtjes së Ilir Tolaj, dhe është refuzuar akuza për kryerjen e veprës penale shmangie nga tatimi. Me ç'rast është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe i Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, Supremja ka anuluar dënimin për Hajrullah Fejzën, i dënuar për veprat penale të marrjes së ryshfetit, si dhe e ka kthyer çështjen në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë.

Gjithashtu, me 6 mars 2017, Gjykata Supreme kishte miratuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë për Ismet Hysenin, duke e konsideruar si të bazuar. Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ishte anuluar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i datës 13 shtator 2016, vetëm sa i përket pikës dy të dispozitivit dhe vetëm sa i përket të pandehurit Ismet Hyseni, ndërsa çështja në këtë pjesë i ishte kthyer gjykatës së njëjtë në rivendosje.

Pas kthimit të rastit në rigjykim, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përpos seancës në të cilën prokurorja Fejzullahu kishte precizuar aktakuzën, akoma nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore, ndërsa kjo seancë ka dështuar të mbahet në tetë (8) tentime të gjykatës, shumica nga të cilat kanë dështuar për shkak të mungesës së të akuzuarit Bujar Bukoshi, i cili është në gjendje jo të mirë shëndetësore.

Seanca e 10 majit 2019 kishte dështuar për arsye se në atë seancë, përpos të akuzuarit Bukoshi, mungoi edhe anëtarja e trupit gjykues Valbona Musliu- Selimaj, e cila gjendej në

një udhëtim zyrtar.<sup>133</sup> Pas shumë dështimeve të seancave, gjykata më 11 qershor 2019 kishte veçuar procedurën ndaj të akuzuarit Bujar Bukoshi, ndërsa kishte vazhduar për të akuzuarit e tjerë të cilët kishin dhënë fjalët e tyre hyrëse.<sup>134</sup> Përpos kësaj seance, ishte mbajtur edhe seanca e 25 korrikut 2019, në të cilën seancë gjykata kishte aprovuar propozimin e prokurores speciale Fikrije Fejzullahu, që të dëgjohen sërish palët e dëmtuara.<sup>135</sup>

Në seancën e 7 tetorit 2019, i dëmtuari Blerim Deshishku kishte kërkuar kohë që të përgatitet për të dhënë deklaratë, ndërsa ka mbetur në tërësi pranë deklaratave që kishte dhënë në polici, prokurori dhe gjykatë.<sup>136</sup> Më 20 nëntor 2019, ishte mbajtur fjala përfundimtare në këtë rast ku prokurorja Fikrije Fejzullahu kishte deklaruar se mbetet pranë fjalës përfundimtare të prokurorit paraprak, duke thënë se gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë, ndërsa mbrojtja kishte kërkuar lirimin e të akuzuarve.<sup>137</sup>

Me 25 nëntor 2019 ishte shpallur aktgjykimi në këtë rast, ku të akuzuarit ishin shpallur të pafajshëm për disa pikë të akuzës, kurse për disa të tjera ishte refuzuar akuza.<sup>138</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Nuk ka informacion.

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>133</sup> “Mungon anëtarja e trupit gjykues dhe Bujar Bukoshi, për herë të tetë dështon gjykimi ndaj tij, Ilir Tolajt dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi. 10 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-anetarja-e-trupit-gjykues-dhe-bujar-bukoshi-per-herë-te-tete-deshton-gjykimi-ndaj-tij-ilir-tolajt-dhe-te-tjereve/>)

<sup>134</sup> “Veçohet procedura ndaj Bujar Bukoshit, derisa Ilir Tolaj e të tjerët e kundërshtojnë edhe aktakuzën e ndryshuar, prokuroria thotë se ka prova” Betimi për Drejtësi. 11 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vecohet-procedura-ndaj-bujar-bukoshit-derisa-ilir-tolaj-e-te-tjeret-e-kundershtojne-edhe-aktakuzen-e-ndryshuar-prokuroria-thote-se-ka-prova/>)

<sup>135</sup> “Gjykata vendos që në rigjykimin ndaj Ilir Tolajt dhe të tjerëve të dëgjohen sërish palët e dëmtuara”. Betimi për Drejtësi. 25 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-vendos-qe-ne-rigjykimin-ndaj-ilir-tolajt-dhe-te-tjereve-te-degjohen-serish-palet-e-demtuara/>)

<sup>136</sup> “Rigjykimi ndaj Ilir Tolajt dhe të tjerëve, i dëmtuari thotë se kanë kaluar mbi 10 vjet, kërkon kohë për t’u deklaruar”. Betimi për Drejtësi. 7 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rigjykimi-ndaj-ilir-tolajt-dhe-te-tjereve-i-demtuari-thote-se-kanë-kaluar-mbi-10-vjet-kerkon-kohe-per-tu-deklaruar/>)

<sup>137</sup> “Prokuroria kërkon dënimin e Ilir Tolajt dhe të tjerëve, mbrojtja kërkon lirimin e tyre”. Betimi për Drejtësi. 20 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-denimin-e-ilir-tolajt-dhe-te-tjereve-mbrojtja-kerkon-lirimin-e-tyre/>)

<sup>138</sup> “Ilir Tolaj dhe të tjerët lirohen nga akuzat që lidhen me keqpërdorimin e detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi, 25 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ilir-tolaj-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuzat-qe-lidhen-me-shperdorimin-e-detyres-zyrtare/>)



- **Rasti i ish-Kryetarit të Klinës, Sokol Bashota dhe të tjerëve**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Pejë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.168/16
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Sylë Lokaj
<b>Prokuror:</b>	Sahide Gashi
<b>Të pandehur:</b>	Sokol Bashota, Esat Raci, Fadil Gashi Enver Berisha
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”
<b>Faza e procedurës:</b>	Rigjykim

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 1,245 ditë**



Më 25 nëntor 2013, AKK kishte parashtruar kallëzim penal lidhur me dyshimet për keqpërdorim në Komunën e Klinës. Më 24 shkurt 2014, Prokuroria kishte marrë aktvendim për fillim të hetimeve, kurse më 4 gusht 2016, prokurori i EULEX-it kishte ngritur aktakuzë kundër Sokol Bashotës, kryetar i Klinës dhe tre të tjerëve për “Keqpërdorim i pozitës apo autorizimeve” dhe “Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”.

Sipas aktakuzës, gjatë procesit të ndarjes së banesave me qira, në pronësi të Komunës së Klinës, kanë bërë marrëveshje politike (PDK, LDK, AAK DHE LDD), për shpërndarjen e banesave. Pas kësaj marrëveshje, të pandehurit kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes, ku kanë anashkaluar aplikantët me gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shpërblyer shokët e tyre partiak me banesa. Sipas prokurorisë, dy të pandehurit Esat Rraci dhe Fadil Gashi, duke shfrytëzuar dispozitat e Ligjit për shitjen e banesave, në të cilat ekziston e drejta banesore, kishin paraqitur kërkesa me shkrim për blerjen e banesave, të cilat u ishin ndarë atyre. Por, si

rezultat i hetimeve, procesi i blerjes ishte pezulluar. Prokuroria akuzon të pandehurin Sokol Bashota po ashtu se në periudhën janar 2009 deri në qershor 2016, në cilësi të Kryetarit të Klinës, ka falsifikuar me qëllim ose nuk ka përfshirë të dhënat ose informacionet, kur ka paraqitur deklaramet e tij pasurore në AKK.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur me 4 gusht 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte caktuar me 12 dhjetor 2016, apo jashtë afatit prej 30 ditësh të përcaktuar nga KPPRK, për mbajtjen e shqyrtimit fillestare pas ngritjes së aktakuzës. Në këtë seancë të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.<sup>139</sup> Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte caktuar me 23 janar 2017, mirëpo ishte shtyrë për arsye se prokurorja Valeria Bolici kishte deklaruar se nuk kishte pranuar asnjë shkresë tjetër lidhur me kundërshtimet e provave të paraqitura nga palët, përveç ato të të akuzuarit Bashota.<sup>140</sup> Më 31 mars 2017, ky gjykim kishte filluar rishtas për shkak të ndryshimit dhe zgjerimit të akuzës nga prokurorja Bolici.<sup>141</sup>

Pas zgjerimit të kësaj aktakuze, shqyrtimi i dytë ishte mbajtur tre muaj më vonë, më 30 qershor 2017, duke shkelur aatin e paraparë me nenin 245, paragrafi 5 të KPPRK-së, ku të akuzuarit me mbrojtësit e tyre ishin deklaruar lidhur me kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe provave.<sup>142</sup> Më 30 nëntor 2017, shkalla e parë kishte refuzuar kërkesat për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, mirëpo pas ankesave të mbrojtësve dhe të akuzuarve, Gjykata e Apelit me 6 shkurt 2018, e kishte anuluar aktvendimin e shkallës së parë dhe rastin e kishte kthyer në rivendosje.<sup>143</sup>

Edhe pas kthimit të lëndës në rivendosje, gjykata e shkallës së parë, më 19 prill 2018 kishte vendosur njëjtë si herën e parë, duke refuzuar sërish kërkesat e të akuzuarve për hudhje të aktakuzës. Ky vendim i shkallës së parë, ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, në maj 2018.<sup>144</sup>

Pas konfirmimit të aktakuzës, seanca e shqyrtimit kryesor ishte caktuar të mbahej me 10 korrik 2018, mirëpo kishte dështuar për shkak të grevës së personelit administrativ, ndërsa

<sup>139</sup> “Kryetari i Komunës së Klinës dhe tre zyrtarë tjerë komunal deklarohen të pafajshëm për veprat me të cilat ngarkohen”. Betimi për Drejtësi. 12 dhjetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-it-komunes-se-klines-dhe-tre-zyrtare-tjere-komunal-deklarohen-te-pafajshem-per-veprat-me-te-cilat-ngarkohen/>)

<sup>140</sup> “Prokurorja nuk i ka pranuar të gjitha shkresat për kundërshtimin e provave, shtyhet shqyrtimi i dytë në rastin e kryetarit të Klinës dhe tre të akuzuarve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 23 janar 2017 (Shih Linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-nuk-i-ka-pranuar-te-gjitha-shkresat-per-kundershtimin-e-provave-shtyhet-shqyrtimi-i-dyte-ne-rastin-e-kryetarit-te-klines-dhe-tre-te-akuzuarve-tjere/>)

<sup>141</sup> “Nis prej fillimi gjykimi ndaj kryetarit të Klinës, Sokol Bashota”. Betimi për Drejtësi. 31 mars 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nis-prej-fillimi-gjykimi-ndaj-kryetarit-te-klines-sokol-bashota/>)

<sup>142</sup> “Gjykimi ndaj kryetarit të Klinës, Sokol Bashota dhe tre zyrtarëve të tjerë”. Betimi për Drejtësi. 30 qershor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-kryetarit-te-klines-sokol-bashota-dhe-tre-zyrtareve-te-tjere/>)

<sup>143</sup> “Apeli e kthen në rivendosje rastin ndaj ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota”. Betimi për Drejtësi. 10 mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-ndaj-ish-kryetarit-te-klines-sokol-bashota/>)

<sup>144</sup> “Apeli konfirmon aktakuzën ndaj ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota dhe të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 30 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-ish-kryetarit-te-klinessokol-bashota-dhe-te-tjereve/>)

nuk kishte arritur të mbahej as seanca e caktuar për 11 korrik 2018. Në seancën e 3 dhjetorit 2018, gjykata kishte vendosur që të bëhet një ekspertizë financiare për të përcaktuar lartësinë e çmimit të banesave të cilat janë objekt i aktakuzës.<sup>145</sup> Në seancën e 4 marsit 2019, kishte shfrytëzuar të drejtën për tu mbrojtur në heshtje.<sup>146</sup> Ndërsa në seancën e mbajtur me 27 maj 2019, prokurorja Sadihe Gashi kishte hequr dorë nga ndjekja penale për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtarë ndaj katër të akuzuarve, pasi sipas saj nuk ishte vërtetuar se të akuzuarit kishin kryer veprat penale me të cilat ngarkoheshin. Ndërsa për mos deklaram të pasurisë, për të cilën vepër penale ngarkoheshin të akuzuarit Bashota dhe Berisha, prokurorja Gashi kishte kërkuar që Bashota të shpallet fajtor dhe t'i ndalohet funksioni i ushtrimit të detyrës zyrtare.<sup>147</sup>

Me 29 maj 2019, GjTh në Pejë ka shpallur aktgjykimin në këtë rast, ku dy të akuzuarit Bashota dhe Berisha për mos deklaram apo deklaram të rremë të pasurisë i kishte dënuar me nga gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1,000 euro gjobë, mirëpo dënimi me kusht ndaj tyre nuk do të ekzekutohet nëse ata brenda një viti nuk kryejnë ndonjë vepër penale.<sup>148</sup>

Nga shqyrtimi kryesor e deri në shpalljen e aktgjykimit në këtë rast ishin caktuar 10 seanca, prej të cilave 7 janë mbajtur ndërsa tri seanca janë shtyrë.

Në tetor 2019, Gjykata e Apelit e kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim, për shkak se sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.<sup>149</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Nuk përcaktohet me aktakuzë

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>145</sup> “Caktohet ekspertizë financiare në gjykimin ndaj Sokol Bashotës dhe të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 3 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/caktohet-ekspertize-financiare-ne-gjykimin-ndaj-sokolbashotes-dhe-te-tjereve/>)

<sup>146</sup> Gjykimi ndaj Sokol Bashotës dhe të tjerëve, ish-kryetari i Klinës mbrohet në heshtje, prokurorja kundërshton ekspertin financiar”. Betimi për Drejtësi. 4 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-sokol-bashotes-dhe-te-tjereve-ish-kryetari-i-klines-mbrohet-ne-heshtje-prokurorja-kundershton-ekspertin-financiar/>)

<sup>147</sup> “Prokuroria heq dorë nga akuza për keqpërdorim detyrë ndaj Sokol Bashotës, kërkon të shpallet fajtor për mos deklaram të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 27 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-heq-dore-nga-akuza-per-keqperdorim-detyre-ndaj-sokol-bashotes-kerkon-te-shpallet-fajtor-per-mos-deklaram-te-pasurise/>)


<sup>148</sup> “Sokol Bashota dënohet me burgim me kusht për mos deklaram të pasurisë, aktgjykim refuzues për keqpërdorim detyrë (Video)”. Betimi për Drejtësi. 29 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/sokol-bashota-denohet-me-burgim-me-kusht-per-mos-deklaram-te-pasurise-aktgjykim-refuzues-per-keqperdorim-detyre/>)

<sup>149</sup> “Ish-kryetari i Klinës, Sokol Bashota do të gjykohej sërish për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 31 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klines-sokol-bashota-do-te-gjykohej-serish-per-korrupsion/>)

- **Rasti lidhur me tenderin milionësh të cigareve të “KFOR-it”**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.445/08
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Shadije Gërguri
<b>Prokuror:</b>	Fillimisht Habibe Salili, pastaj Afrim Shefkiu
<b>Të pandehur:</b>	Shaip Ferizi, Shqipe Avdiu, Arben Jashari, Mustafë Vitia, Mexhid Mustafa, Besnik Ferizi, Faton Topanica, Arsim Topanica, Ajdar Jashari dh Lulzim Gashi
<b>Veprat penale:</b>	“Krim i organizuar lidhur me veprën penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare”, “Shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve”
<b>Faza e procedurës:</b>	Rigjykim

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 4,019 ditë**



Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 11 tetor 2007, ndërsa aktakuza nga ana e Prokurorisë Publike të Qarkut ishte ngritur më 30 dhjetor 2008, e më pas ishte precizuar nga ana e PSRK-së më 20 korrik 2017.

Sipas aktakuzës, nëntë të akuzuarit që nga 8 shtatori 2006 e deri më 9 tetor 2007, si pjesë e një grupi të organizuar kriminal, duke e pasur secili rolin e tyre të ndarë në veprimtari kriminale, me qëllim të përfitimit të një dobie pasurore apo financiare të kundërligjshme, gjatë importimit të cigareve si kontraktues të KFOR-it dhe në emër të KFOR-it kishin keqpërdorur detyrat zyrtare.

Cigaret në vlerë prej 2.931.929.08 euro nuk i kishin dorëzuar në KFOR, por u kanë shitur kompanive të tjera pa banderolë, duke shkaktuar evazion fiskal ndaj buxhetit të konsoliduar të Kosovës në shumë prej 2,441,927,71 euro.

Prokuroria të akuzuarit Shaip Ferizi, Shqipe Avdiu dhe Arben Jashari, i ngarkonte me veprat penale “krim i organizuar”, lidhur me veprën penale “shpërdorim i detyrës zyrtare” si dhe me veprën penale “shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve”.

Ndërsa, të pandehurit Mustafë Vitia, Mexhid Mustafa, Lulzim Gashi, Besnik Ferizi, Faton Topanica, Arsim Topanica dhe Ajdar Jashari, i ngarkonte me veprën penale “krim i organizuar” lidhur me veprën penale “shmangie nga pagesat e detyrimeve”.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Ky proces maratonik gjyqësor, në të cilën pretendohet se i janë shkaktuar dëm buxhetit të shtetit rreth 2,441,927,71 euro, akoma është duke u trajtuar nga ana e gjyqësorit kosovar.

Në këtë rast janë caktuar shumë seanca e janë dëgjuar shumë dëshmitarë. Në seancën e mbajtur me 18 shtator 2017 ishte dëgjuar dëshmitarja Shemsije Shala, e cila kur ishte ballafaquar nga prokurorja Habibe Salihu me deklaratën e dhënë në polici, ajo kishte deklaruar se kishte pasur presion gjatë dhënies së kësaj deklarate.<sup>150</sup> Për shkak se i akuzuari Mustafë Vitia kishte munguar në seancën e paraparë të mbahet me 15 nëntor 2017, gjykata kishte lëshuar urdhër arrest ndaj tij, ndërsa mbrojtësi i tij, avokati Florin Vërtopi kishte deklaruar se Vitia gjendet në Gjermani për arsye shëndetësore.<sup>151</sup> Me 6 shkurt 2018 ishte paraparë të mbahet seanca e radhës mirëpo e njëjta kishte dështuar për shkak të mungesës së të akuzuarit Lulzim Gashi<sup>152</sup> i cili pasi kishte munguar edhe në seancën e 28 majti 2018 ishte veçuar procedura ndaj tij dhe ishte lëshuar urdhër për letër rreshtim ndërkombëtar, po ashtu ndaj tij ishte caktuar edhe paraburgimi.<sup>153</sup> Në këtë seancë kishte dhënë mbrojtjen i akuzuari Shaip Ferizi i cili kishte mohuar në tërësi akuzën e prokurorisë. Në seancën e mbajtur me 29 maj 2018, të akuzuarit Shqipe Avdiu, Arben Jashari, Mustafë Vitia, Besnik Ferizi, Faton Topanica dhe Arsim Topanica kishin shfrytëzuar të drejtën e tyre për tu mbrojtur në heshtje,

<sup>150</sup> “Dëshmitarja në rastin për krim të organizuar: Kam pasur presion gjatë dhënies së deklaratës në polici”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitarja-ne-rastin-per-krim-te-organizuar-kam-pasur-presion-gjate-dhenies-se-deklarates-ne-polici/>)

<sup>151</sup> “Lëshohet urdhërarrest për njërin nga dhjetë të akuzuarit për krim të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 15 nëntor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/leshohet-urdherarrest-per-njerin-nga-dhjete-te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar/>)

<sup>152</sup> “Njëri nga të akuzuarit jashtë shtetit, dështon gjykimi për krim të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 6 shkurt 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/njeri-nga-te-akuzuarit-jashte-shtetit-deshton-gjykimi-per-krim-te-organizuar/>)

<sup>153</sup> “Njëri nga nëntë të akuzuarit për krim të organizuar mohon se e dëmtoi buxhetin e Kosovës mbi dy milionë euro”. Betimi për Drejtësi. 28 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/njeri-nga-nente-te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar-mohon-se-e-demtoi-buxhetin-e-kosoves-mbi-dy-milione-euro/>)

ndërsa të akuzuarit Shaip Ferizi, Mexhid Mustafa dhe Ajdar Jashari, kishin dhënë mbrojtjen e tyre.<sup>154</sup>

Me 16 tetor 2018 ishte mbajtur seanca e radhës në të cilën kishte dhënë dëshminë e saj dëshmitarja Violeta Pillana, e cila kishte deklaruar se vlera e cigareve të destinuar për KFOR-in, por që u janë shitur kompanive private, kishte arritur shumën 1.8 milionë euro.<sup>155</sup> Me 4 dhjetor 2018 ishte dhënë fjala përfundimtare, në të cilën prokurori special Afrim Shefkriu kishte kërkuar dënimin e nëntë të akuzuarve, ndërsa mbrojtja kishte kërkuar aktgjykim refuzuar për shkak të parashkrimit ose lirimin e të akuzuarve.<sup>156</sup>

Përfundimisht, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vendosur që më 12 dhjetor 2018 të shpallte aktgjykimin, mirëpo më pas e njëjta kishte vendosur që të rihap shqyrtimin, për shkak se sipas kryetares së trupit gjykues, gjykatëses Shadije Gërguri, prokuroria në aktakuzën e saj kishte propozuar që të shqiptohet edhe dënimi plotësues bashkë me atë kryesor – marrja e sendeve të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale.<sup>157</sup> Kurse, sipas saj duke marr parasysh në precizimin e aktakuzës më 20 korrik 2017, si dhe në fjalën përfundimtare të dhënë nga prokurori Afrim Shefkriu, nuk është precizuar kërkesa pasurore-juridike. Gjykatësja Gërguri kishte thënë se në mungesë të këtij propozimi, gjykata nuk është në gjendje të vendos lidhur me këtë pikë. Ajo ka thënë se në pamundësi të vendosjes edhe për këtë çështje, trupi gjykues ka vlerësuar se duhet të rihapet seanca e shqyrtimit gjyqësor vetëm për këtë pikë të aktakuzës. Tutje, ka thënë se në seancën e radhës detyrohet prokurori i Prokurorisë Speciale që ta precizojë kërkesën pasurore-juridike, përkatësisht kërkesën se cilat sende duhet të konfiskohen apo t'u kthehen palëve.

Në seancën e radhës e cila ishte mbajtur më 26 shkurt 2019, pasi mbrojtja e të akuzuarve kishte kundërshtuar kërkesën e PSRK-së për konfiskim të sendeve e të hollave, prokurori special Afrim Shefkriu kishte vendosur që të heqë dorë nga konfiskimi i automjeteve, motoçikletave e sendeve të amortizuara, ndërsa kishte mbetur pranë kërkesës për konfiskimin e aseteve të tjera, në mesin e të cilave sete, para, automjete, leje të qarkullimit, vulë të falsifikuar<sup>158</sup>

Me 11 mars 2019, gjykata kishte shpallur aktgjykimin në këtë rast ku nëntë të akuzuarit i

---

<sup>154</sup> “Tre të akuzuarit për krim të organizuar japin mbrojtjen e tyre, ndërsa gjashtë prej tyre mbrohen në heshtje”. Betimi për Drejtësi. 29 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/tre-te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar-japin-mbrojtjen-e-tyre-ndersa-gjashte-prej-tyre-mbrohen-ne-heshtje/>)

<sup>155</sup> “Dëshmitarja thotë se vlera e cigareve të destinuar për KFOR-in, por që u janë shitur kompanive private, arrin shumën 1.8 milionë euro”. Betimi për Drejtësi. 16 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitarja-thote-se-vlera-e-cigareve-te-destinuara-per-kfor-in-por-qe-u-jane-shitur-kompanive-private-arrin-shumen-1-8-milione-euro/>)

<sup>156</sup> “Prokuroria kërkon dënimin e nëntë të akuzuarve për krim të organizuar, mbrojtja thotë se lënda është parashkruar”. Betimi për Drejtësi. 4 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-denimin-e-nente-te-akuzuarve-per-krim-te-organizuar-mbrojtja-thote-se-lenda-eshte-parashkruar/>)

<sup>157</sup> “Rihapet shqyrtimi në rastin e nëntë të akuzuarve për krim të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 12 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rihapet-shqyrtimi-ne-rastin-e-nente-te-akuzuarve-per-krim-te-organizuar/>)

<sup>158</sup> “Prokuroria heq dorë nga konfiskimi i të hollave dhe disa sendeve në gjykimin ndaj nëntë të akuzuarve për krim të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2019 (<https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-heq-dore-nga-konfiskimi-i-te-hollave-dhe-disa-sendeve-ne-gjykimin-ndaj-nente-te-akuzuarve-per-krim-te-organizuar/>)

kishte shpallur fajtor dhe i kishte dënuar me burgim me kusht. Shaip Ferizi është dënuar me dy vite burgim me kusht, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen vepër penale brenda pesë viteve. Të njëjtit i është konfiskuar një set me ngjyrë të zezë me çelës, me shumën e të hollave prej 4.179 euro një “Audi A4” si dhe lejen e qarkullimit të këtij automjeti, dy vula të falsifikuara, automjeti “BMË”, automjeti “Renault Tëingo”, si dhe shumën e të hollave prej 20.055,58 euro.

E akuzuara Shqipe Avdiu është dënuar me dy vite burgim me kusht, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse ajo brenda katër viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe i është konfiskuar shumën prej 5.086,75 euro.

I akuzuari Arben Jashari është dënuar me dy vite burgim me kusht, ku edhe dënimi ndaj tij nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen ndonjë vepër penale brenda pesë viteve. Po ashtu, të njëjtit i janë konfiskuar dy vetura, njëra “BMË”, dhe tjetra “Daimler Chrysler”.

Me dy vite burgim me kusht është dënuar edhe i akuzuari Mustafë Vitia, ku edhe ndaj tij nuk do të ekzekutohet ky dënim, nëse nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, ku pos dënimit me kusht atij i është konfiskuar edhe shumën prej 231,00 euro, dhe një automjet “Volksëagen 1 J Bora”.

Njëjtë si i akuzuari Vitia, janë dënuar edhe të akuzuarit Mexhid Mustafa dhe Ajdar Jashari. Pas dënimit me kusht, Mustafës i janë konfiskuar edhe shumën prej 1.409,00 euro, ndërsa të akuzuarit Jashari shumën prej 50.000 euro, 60.400 euro, 586,50 euro si dhe një automjet “Renault Clio”. Besnik Ferizi dhe Arsim Topanica janë dënuar me dy vite burgim me kusht, dënimi ndaj të cilëve nuk do të ekzekutohet nëse nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale brenda katër viteve. Të akuzuarit Ferizi i është konfiskuar një veturë “Audi”, ndërsa të akuzuarit Arsim Topanica një kombi furgon “Volksëagen”, dhe librezat e qarkullimit të këtij furgoni, një automjet kombi “Mercedes Daimler Chrysler”, dhe librezat e qarkullimit, si dhe dy automjete “Volksëagen”, njëri prej të cilëve “picup”. Ndërkaq, i akuzuari Faton Topanica është dënuar me një vit burgim me kusht, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen ndonjë vepër penale brenda dy viteve.<sup>159</sup>

Ndërsa, për shkak të pamundësisë së sigurimit të prezencës së të akuzuarit Lulzim Gashi, gjykata ka vendosur që ndaj tij të veçohet procedura.

Me 18 dhjetor 2019, ishte mbajtur seanca e kolegjit të Apelit, në të cilën Prokuroria Themelore në Prishtinë dënimet ndaj tyre i kishte konsideruar tepër të buta dhe në disproporcion me shkallën e rrezikshmërisë së veprave penale për të cilat akuzohen, duke

---

<sup>159</sup> “Dënohen me kusht nëntë të akuzuarit për krim të organizuar, u konfiskohen vetura dhe mijëra euro”. Betimi për Drejtësi. 11 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-kusht-nente-te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar-u-konfiskohen-vetura-dhe-mijera-euro/>)

kërkuar që dënimet me kusht të ashpërsohen. Ndërsa të akuzuarit kishin kërkuar që të lirohen nga akuza.<sup>160</sup>

Ky rast është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit, më 18 dhjetor 2019.

**Dëmi i pretenduar:** 2,441,927,71 euro

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Para: 141,946.00 euro, Automjete: Audi A4, “Renault Tëingo”, “BMË”, “Daimler Chrysler”, “Volksëagen 1 J Bora”, “Renault Clio”, “Audi”, kombi furgon “Volksëagen”, “Picap -Volksëagen. Tri (3) libreza qarkullimi, dy (2) vula të falsifikuara.

---


<sup>160</sup> “Të dënuarit për krim të organizuar dhe keqpërdorim kërkojnë pafajësinë në Apel, prokuroria propozon dënime më të ashpra”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-denuarit-per-krim-te-organizuar-dhe-keqperdorim-kerkojne-pafajesine-ne-apel-prokuroria-proponon-denime-me-te-ashpra/>)



- **Rasti “Grantet”**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PS.nr.74/19
<b>Kryetar i Trupit Gjykes:</b>	Arben Hoti
<b>Prokuror:</b>	Habibe Salih
<b>Të pandehur:</b>	Nenad Rikalo, Kapllan Halimi, Shefki Zeqiri, Ekrem Gjoka, Shkelzen Morina Leon Thaçi, Lindar Krasniqi, Albana Zeqiri
<b>Veprat penale:</b>	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.
<b>Faza e procedurës:</b>	Ende nuk ka filluar procesi gjyqësor

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, ka kaluar 1 ditë**



Aktakuza në këtë rast ende nuk është bërë publike. Mirëpo, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), më 30 dhjetor 2019, me anë të një komunikate për media ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë në kundër ish-ministrit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Nenad Rikalo, sekretarit të përgjithshëm të kësaj ministrie, Kapllan Halimi dhe gjashtë zyrtarëve tjerë, Shefki Zeqiri, Ekrem Gjoka, Shkelzen Morina, Leon Thaçi, Lindar Krasniqi, Albana Zeqiri për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>161</sup>

Sipas aktakuzës së përpiluar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), me 26 dhjetor 2019, të pandehurit Nenad Rikalo, Kapllan Halimi, Shefki Zeqiri dhe Ekrem Gjoka, në bashkëveprim, gjatë vitit 2018, me qëllim që tu mundësojnë përfitim në mënyrë të kundërligjshëm kompanive si: konzorciumit “Novus” SH.P.K, për fitimin e grandit “Ndërtimi i tregut modern për prodhime bujqësore” në Prishtinë, konzorciumit “Dhemetra” SH.P.K për fitimin e grandit “Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e plehut organit” (duke mos

<sup>161</sup> “PSRK ngritë aktakuzë për keqpërdorim detyre ndaj ish-ministrit të MBPZHR-së, Nenad Rikalo”, Betimi për Drejtësi. 30 dhjetor 2019. ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-keqpërdorim-detyre-ndaj-ish-ministrit-te-mbpzhr-se-nenad-rikalo/>)

qenë fare në listën e projekteve të cilat mbulohen me financim përmes grandeve), koncorziumit “ DOO Zubin Potok” për fitimin e grandit “ Projekti për ndërtimin e investimeve në objektin për magazinimin dhe ruajtjen e frutave”, si dhe konzorciumit NTP “Arena Engineering” në Pejë, për fitimin e grandit “Prodhimi dhe përpunimi i mishit” në Pejë, kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural neni 5.1, neni 8, neni 13 paragrafi 1.2, neni 4, neni 14.2 Ligji 03/L098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, neni 8 dhe 9, rregullores ( QRK) nr. 37/2013, neni 7.1, paragrafi 1.1, Udhëzuesi dhe Doracaku për hartimin e konceptit të dokumenteve nga Zyra e Kryeministrit.

Këtë thuhet se e kanë bërë ashtu që i pandehuri Nenad Rikalo, në cilësinë e Ministrit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka tejkaluar kompetencat e tij, ka hartuar një “Program të veçantë”, pa buxhet të veçantë të ndarë për këtë projekt, ka vendosur mbi kriteret, ka përcaktuar regjionet për financim, shumën e grandit, duke i anashkaluar edhe procedurat e rregullta të hartimit të programit të veçantë, që ishte kompetencë e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural në MBPZHR duke mbivendosur në mes të masave me programin e rregullt, me datë 26 mars 2018, në mënyrë të kundërligjshme ka lëshuar vendimin me nr. ref. KM 91/18 për hartimin e politikave të reja për zhvillim të mëtutjeshme të infrastrukturës rurale dhe ngritjes së konkurrencës në zonat rurale më pak të zhvilluara, me ç’rast edhe programin ua dorëzon vet të përfunduar, ndërsa komisionin e kishin formuar vetëm formalisht.

Tutje, thuhet se i pandehuri Kapllan Halimi, në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm në këtë ministri, ka tejkaluar kompetencat e tij ashtu që në mënyrë të kundërligjshme ka nxjerr vendimin me ref.nr. ZSP 266/18 për t’ua mundësuar përfitim në mënyrë të kundërligjshme kompanive të sipërcituara, emëron grupin punues në përbërje prej 11 anëtarëve për përgatitjen e investimeve në infrastrukturë rurale , duke qenë në dijeni se ky grup nuk është kompetent dhe nuk ka njohuri për përpilimin e këtij programi, derisa ishte në dijeni se ky grup ishte vetëm formal, duke ditur se drafti është dorëzuar nga vet ministri Rikalo.

Sipas akuzës, i pandehuri Shefki Zeqiri, në cilësinë e personit zyrtar në këtë ministri, gjatë vitit 2018, duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme, e ka hartuar dhe aprovuar Udhëzimin Administrativ 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë “Zonat Rurale më pak të zhvilluara”, edhe pse e kishte ditur që ky program ishte hartuar në kundërshtim me Ligjin 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Rregulloren (QKR) nr. 37/2013, duke i anashkaluar procedurat e rregullta të hartimit të programit të veçantë që është kompetencë e Departamentit të Politikave për zhvillim Rural në MBPZHR.

Ndërsa, sipas akuzës, i pandehuri Ekrem Gjoka, në cilësinë e personit zyrtar, ushtrues detyre i Kryeshefit të AZHB-së, në mënyrë të kundërligjshme ka marrë vendimin ref.nr. ZHB-07/4/54/2018 për formimin e grupit punues, i cili grup do të bëjë kontroll administrative, vlerësim, miratim dhe kontraktimin e projekteve të masës të infrastrukturës rurale, në

përbërje prej: Lindar Krasniqi, Shkelzen Morina, Albana Zeqiri dhe Leon Thaçi, duke anashkaluar faktin se ky ekip duhet të formohet prej drejtorit, të monitorohet prej drejtorit dhe ky grup të raportonte te Drejtori i Drejtorisë për Miratimin e Projekteve dhe Zhvillim Rural, kështu i pandehuri Gjoka me qëllim ka vepruar në atë mënyrë që t'u mundësonte përfitim kompanive të lartpërmendura në mënyrë të kundërligjshme ngase vet ishte pjesë e grupit kur ministri ua kishte dorëzuar draftin e gatshëm, duke vepruar në këtë mënyrë buxhetit të Republikës së Kosovës në bashkëveprim i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 4.000.000 euro.

Sipas akuzës, të akuzuarit Shkëlzen Morina, Leon Thaçi, Lindar Krasniqi e Albana Zeqiri, më 14 gusht 2018, duke bashkëvepruar në cilësinë e personave zyrtarë pranë MBPZHR-së, duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim që t'u mundësoj përfitim në mënyrë të kundërligjshme kanë shpallur fitues konzorciumin “Novus” sh.p.k për fitimin e grandit “Ndërtimi i tregut modern për prodhime bujqësore”, në Prishtinë, kanë shpallur fitues konzorciumin “Dhemetra” sh.p.k për fitimin e grandit “Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e plehut organik” në Gjilan, kanë shpallur fitues konzorciumin “DOO Zubin Potok”, për fitimin e grandit “Projekti për ndërtimin e investimeve në objektin për magazinimin dhe ruajtjen e frutave”, kanë shpallur fitues konzorciumin NTP “Arena Engineering”, për fitimin e grandit “Prodhimi dhe përpunimi i mishit”, në Pejë, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë “Zonat rurale më pak të zhvilluara”.

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Shqyrtimi fillestar për këtë rast është caktuar 74 ditë pas ngritjes së aktakuzës, për 12 mars 2020, apo mbi 40 ditë pas afatit të përcaktuar ligjor.

- **Rasti i kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Pejë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.25/18
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Sylë Lokaj
<b>Prokuror:</b>	Fillimisht Agron Matjani, më pas Ramiz Buzhala
<b>I pandehur:</b>	Haki Rugova
<b>Vepra penale:</b>	“Konflikt i interesit”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 646 ditë**



Më 7 dhjetor 2017, AKK kishte parashtruar një kallëzim penal ndaj kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, nën dyshimin se ka kryer veprën penale “konflikt interesi”, me rastin e nënshkrimit të një tenderi në këtë komunë, përfitues i së cilit ka qenë vëllai i tij, Gani Rugova. Ky kallëzim penal, kishte ndikuar që PTh në Gjakovë, më 26 mars 2018, të ngritë aktakuzë ndaj Rugovës, me pretendimin se ai i ka dhënë tender vëllait të tij Gani Rugovës, në vlerë rreth 300 mijë euro.

Rugova thuhet se deri sa ka qenë kryetar i Komunës së Istogut, më 1 gusht 2014, ka nënshkruar kontratë me kompaninë “Ma-Con” SH.P.K. drejtor i të cilës ka qenë Gani Rugova, për ndërtimin e kanalizimit për fshatrat Cërcë dhe Lubozhdë, me një çmim të kontratës prej 289.119.85 euro.

Organi i akuzës pretendon se me anë të këtyre veprimeve, i akuzuari Rugova, i ka mundësuar vëllait të tij, Gani Rugova, interes financiar, andaj e akuzon se ka kryer veprën penale të konfliktit të interesit.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Fillimisht kallëzimi penal i AKK-së ishte dërguar në Prokurorinë Themelore në Pejë, përkatësisht ajo i ishte deleguar prokurorit Haxhi Sinanaj, por i njëjti më 17 janar 2018, me shkresë i ishte drejtuar kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Ali Selimaj dhe pas konsultimit me kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit, Haxhi Dërguti, si dhe Agim Kurmehaj, lënda është deleguar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për shkak se Sinanaj kishte thënë se me Rugovën ka raporte shoqërore dhe këtë e bën me qëllim që hetimi të jetë i drejtë dhe i pavarur.<sup>162</sup>

Pasi lënda kishte kaluar në Prokurorinë e Gjakovës, pas kallëzimit penal ishte ngritur aktakuzë më 26 mars 2018. GjTh në Pejë kishte caktuar seancën e parë fillestare, më 7 maj 2018, por ajo kishte dështuar të mbahet për arsye se nuk ishte paraqitur i akuzuari Rugova. Ai më herët e kishte njoftuar gjykatën se akoma nuk kishte caktuar avokat mbrojtës dhe për këtë arsye nuk kishte shkuar në gjykatë.<sup>163</sup> Seanca tjetër ishte caktuar për 21 maj 2018, por edhe ajo kishte dështuar për të njëjtën arsye, mungesën e Rugovës. Megjithatë, për dallim nga seanca e 7 majit, kur Rugova e kishte njoftuar gjykatën për arsyen e mungesës, më 21 maj mungesën nuk e kishte arsyetuar fare. Kryetari i trupit gjykues, Sylë Lokaj, kishte thënë se për seancën tjetër e cila ishte shtyrë në afat të pacaktuar, gjykata do të lëshojë urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj Rugovës.<sup>164</sup> Haki Rugova, më 10 shtator 2018 ishte ulur në bankën e të akuzuarit në tentimin e tretë të caktuar nga gjykata, por sikurse dy herët e mëparshme, edhe kjo seancë nuk arriti të mbahet, këtë here me kërkesë të mbrojtësit të tij, avokatit Besnik Berisha, me arsyetimin se mbrojtja nuk është pajisur me shkresat e lëndës nga prokuroria, me të cilën kërkesë për shtyrje ishte pajtuar edhe prokurori Agron Matjani.<sup>165</sup>

---

<sup>162</sup> “Ngritet aktakuzë për konflikt interesi ndaj kryetarit të Istogut, Haki Rugova”. Betimi për Drejtësi. 16 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ngritet-aktakuze-per-konflikt-interesi-ndaj-kryetarit-te-istoguthaki-rugova/>)

<sup>163</sup> “Mungon kryetari i Istogut, dështon seanca fillestare në rastin ku ai akuzohet për konflikt interesi”. Betimi për Drejtësi. 7 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-kryetari-i-istogut-deshton-seancafillestare-ne-rastin-ku-ai-akuzohet-per-konflikt-interesi/>)

<sup>164</sup> “Sërish mungon Haki Rugova, paralajmërohet se ai mund të sillet me forcë në gjykatë”. Betimi për Drejtësi. 21 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-mungon-haki-rugova-paralajmërohet-se-aimund-te-sillet-me-force-ne-gjykatë/>)

<sup>165</sup> “Kryetari i Istogut, Haki Rugova paraqitet në gjykatë, por seanca shtyhet në mungesë të shkresave të lëndës”. Betimi për Drejtësi. 10 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-istogut-haki-rugovaparaqitet-ne-gjykatë-por-seanca-shtyhet-ne-mungesë-te-shkresave-te-lëndës/>)

Kur kishin dështuar tri seanca gjyqësore dhe pritej që e njëjta të mbahej më 5 nëntor 2018, kjo gjë nuk ndodhi. Këtë herë ishte mungesa e kryetarit të trupit gjykues Sylë Lokaj, që bëri që ky rast të mos e fillojë seancën fillestare. Po ashtu në seancë nuk ishte paraqitur as i akuzuari Rugova, i cili e kishte njoftuar gjykatën se gjendet në udhëtim jashtë vendit.<sup>166</sup>

Pas katër (4) dështimeve rresht, seanca fillestare kishte arritur të mbahej më 17 janar 2019, ku Rugova ishte deklaruar i pafajshëm. Ndërsa më 21 mars 2019, apo më shumë se një muaj pas afatit ligjor, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë, në të cilin Rugova kishte kundërshtuar aktakuzën e prokurorisë.<sup>167</sup>

Shkalla e parë, kishte konfirmuar aktakuzën më 8 prill 2019, ndërsa njëjtë kishte vepruar edhe Gjykata e Apelit, e cila më 7 qershor 2019 kishte hapur rrugën për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë.<sup>168</sup>

Shqyrtimi gjyqësor kishte filluar më 23 tetor 2019, në të cilën seancë mbrojtja dhe menaxherja e zyrës së prokurimit së komunës së Istogut, e kanë konsideruar si aksidentale nënshkrimin e kontratës nga Haki Rugova për dhënien e tenderit vëllait të tij<sup>169</sup>.

Ndërkaq, gjykimi kishte dështuar në seancën e 10 dhjetorit 2019, pasi në atë seancë nuk ishte paraqitur prokurori Ali Uka.<sup>170</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Nuk përcaktohet me aktakuzë

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>166</sup> “Gjykatësi në trajnim, Haki Rugova në udhëtim zyrtar, sërish dështon gjykimi ndaj kryetarit të Istogut”.

Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesi-ne-trajnim-haki-rugovane-udhetim-zyrtar-serish-deshton-gjykimi-ndaj-kryetarit-te-istogut/> )

<sup>167</sup> “Haki Rugova kundërshton akuzën për konflikt interesi, prokuroria thotë se kryetari i Istogut i mundësoi fitim pasuror kompanisë së vëllait të tij” Betimi për Drejtësi. 21 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/haki-rugova-kundershton-akuzen-per-konflikt-interesi-prokuroria-thote-se-kryetari-i-istogut-i-mundesoi-fitim-pasuror-kompanise-se-vellait-te-tij/>)

<sup>168</sup> “Apeli konfirmon aktakuzën për konflikt interesi ndaj kryetarit të Istogut, Haki Rugova” Betimi për Drejtësi. 7 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-aktakuzen-per-konflikt-interesi-ndaj-kryetarit-te-istogut-haki-rugova/>)

<sup>169</sup> “Mbrojtja dhe zyrtarja e prokurimit në Istog e quajnë aksidentale nënshkrimin e kontratës nga Haki Rugova për dhënien e tenderit vëllait të tij” Betimi për Drejtësi. 23 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-dhe-zyrtarja-e-prokurimit-ne-istog-e-quajne-aksidentale-nenshkrimin-e-kontrates-nga-haki-rugova-per-dhenien-e-tenderit-vellait-te-tij/>)

<sup>170</sup> “Mungon prokurori, dështon gjykimi për konflikt interesi ndaj kryetarit të Istogut, Haki Rugova” Betimi për Drejtësi. 10 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurori-deshton-gjykimi-per-konflikt-interesi-ndaj-kryetarit-te-istogut-haki-rugova/>)

- **Rasti “Toka”**

<b>Gjykata Themelore:</b>	Prishtinë
<b>Numri i lëndës:</b>	PKR.nr.610/16
<b>Kryetar i Trupit Gjykses:</b>	Fillimisht Arcadius Sedeck, pastaj Petko Petkov, ndërsa aktualisht Beqir Kalludra
<b>Prokuror:</b>	Fillimisht Danilo Cecarelli, pastaj Naim Abazi
<b>Të pandehur:</b>	Azem Syla, Shaban Syla, Shpresim Uka, Fahredin Gashi, Ramadan Uka, Arton Vila, Avdyrrhaman Brajshori, Lubisha Vujoviq, Gazmend Gashi, Sabedin Haxhiu, Nyrtene Brajshori, Sami Maqedonci, Ndue Palushi, Ramadan Mavraj, Avni Maxhuni, Elhame Uka dhe Lumnije Sopjani
<b>Veprat penale:</b>	“Krim i organizuar”, “Pastrim i parave”, “Marrje të mitos”, “Mashttrim i rëndë”, “Mashttrim në detyrë”, “Nxjerrje të vendimeve gjyqësore të kundërligjshme”, “Keqpërdorim i pozitës zyrtare”, “Legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar” dhe “Evazion fiskal”
<b>Faza e procedurës:</b>	Në proces

➤ **Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 1,164 ditë**



Prokurori i EULEX-it më 30 prill 2014, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër Azem Sylës, Nuhi Ukës dhe të tjerëve. Më 24 tetor 2016, Prokuroria kishte ngritur aktakuzë kundër Azem Sylës, Nuhi Ukës dhe 20 të tjerëve për veprat penale “krim i organizuar”, “marrje e mitos”, “pastrim i parave”, “mashttrim në detyrë”, “mashttrim i rëndë”, “keqpërdorim i detyrës zyrtare”, “nxjerrje të kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, “legalizim i përmbajtjes së falsifikuar” dhe “evazion fiskal”.

Gjithashtu sipas aktakuzës të pandehurit akuzohen se në bashkëpunim, përmes veprimtarive kriminale i kanë privuar Kosovës pronat shoqërore, duke përfshirë falsifikimin e vendimeve dhe dokumenteve zyrtare, mashtrim dhe veprime të tjera korruptive. Hetimet në këtë rast janë bërë edhe në bashkëpunim me Prokurorinë e lartë për Krim të Organizuar në Beograd. Hetimet në këtë rast ishin bërë edhe në bashkëpunim me Prokurorinë e Lartë për Krim të Organizuar në Beograd

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur me 24 tetor 2016, ndërsa seanca e shqyrtimit fillestar ishte caktuar me 12 dhjetor 2016, apo pas 49 ditësh nga data e ngritjes së aktakuzës, edhe pse ishte dashur të caktohej pas 30 ditësh, mirëpo ishte shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit Hajrullah Berisha.<sup>171</sup> Shqyrtimi fillestar i radhës ishte mbajtur më 15 dhjetor 2016, në të cilën seancë mungesa e dy të akuzuarve Hajrullah Berisha dhe Mustafë Halili, shkaktoi diskutim të gjatë në gjykatore. Pavarësisht kërkesës së avokatëve mbrojtës për veçim të procedurës ndaj këtyre dy të akuzuarve, kjo nuk paraqiti problem për gjyqtarin Arcadius Sedek, që të vazhdojë procedurën edhe në mungesë të pandehurve Berisha, i cili gjendet në Republikën e Maqedonisë dhe të pandehurit Halili, i cili gjendet në ShBA.<sup>172</sup> Neni 245 paragrafi 1 i KPPK, përcakton se gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre.

Gjyqtari Sedek, kishte vendosur që të mos mbaj fare shqyrtim të dytë por jashtë seance kishte refuzuar kërkesat e mbrojtjes për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet e provave. Kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Arkadiusz Sedek, pasi kishte pranuar kundërshtimet e mbrojtjes, kishte refuzuar të njëjtat dhe më 4 prill 2017, kishte konfirmuar aktakuzën në shkallën e parë. Mbrojtja kishte vazhduar të kërkoj rrëzimin e aktakuzës së prokurorisë, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit, pas vendimit të gjykatësit Sedek për konfirmimin e aktakuzës, të cilin e ka konsideruar atë si vendim të padrejtë, por Gjykata e Apelit, më 26 tetor 2017, kishte nxjerrë aktvendim me të cilin kishte konfirmuar vendimin e shkallës së parë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi aktakuzën e Prokurorisë Speciale të 24 tetor të vitit 2016.

Shqyrtimi gjyqësor nga gjykatësi Sedek ishte caktuar pas më shumë një viti nga konfirmimi i aktakuzës apo 391 ditë pas seancës fillestare, konkretisht më 9 janar 2018. Të martën e 9 janarit 2018, edhe pse në gjykatë kishin ardhur të gjitha palët, shqyrtimi gjyqësor nuk kishte filluar, pasi kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Arcadius Sedek, kishte deklaruar se trupi gjykues nuk është në përbërje të plotë. Ai kishte thënë se për ta plotësuar trupin gjykues kanë bërë kërkesë në KGJK, që të lejojnë që anëtare e trupit gjykues në këtë rast të jetë gjykatësja

---

<sup>171</sup> “Hapet për media rasti “Toka”, shtyhet seanca në mungesë të njërit nga të akuzuarit”. Betimi për Drejtësi. 13 dhjetor 2016. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/hapet-per-media-rasti-toka-shtyhet-seanca-nemungese-te-njerit-nga-te-akuzuarit/> )

<sup>172</sup> “Rasti “Toka” – Deklarohen të pafajshëm Azem Syla dhe të tjerët”. Betimi për Drejtësi. 15 dhjetor 2016. (Shih linkun: <http://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-deklarohen-te-pafajshem-azem-syla-dhe-te-tjeret/> )



Nora Bllaca, që ishte transferuar në Gjykatën e Apelit.<sup>173</sup>

Sipas gjykatësit Sedeck, arsyeshmëria e kësaj kërkesë ishte për të mos përsëritur dëshmitë e dy dëshmitarëve të mbrojtur, që ishin marrë në procedurën e mundësisë së veçantë hetuese, në vitin 2016, para se të ngrihej aktakuza, në të cilën procedurë në kolegjin gjykues kishte marrë pjesë edhe gjykatësja Bllaca. KPPK parasheh që në rastet kur është zhvilluar procedura e mundësisë hetuese të veçantë, në mënyrë që provat e marra në atë procedurë të vlejné në shqyrtimin gjyqësor, duhet që njëri nga anëtarët e kolegjit të mundësisë hetuese të veçantë, të jetë edhe anëtar i trupit gjykues në shqyrtimin gjyqësor.

EULEX-i, pa e pritur përgjigjen nga KGJK, e ka tërhequr kërkesën për kthimin e Bllacës në trupin gjykues të këtij rasti dhe ka caktuar gjykatësin e EULEX-it, Vladimir Mikula, si anëtar të trupit gjykues, që bashkë me Bllacën ishte pjesë e kolegjit të mundësisë hetuese të veçantë.

Në seancën e 24 janarit 2018, kishte ndryshuar përsëri përbërja e trupit gjykues, ku kryetar i trupit gjykues në vend të Arccadius Sedeck, ishte Petko Petkov, kurse gjykatësja vendore Nora Bllaca është zëvendësuar nga gjykatësi Vesel Ismajli, ndërsa anëtar tjetër ishte Vladimir Mikula. Edhe pse gjyqtarët e EULEX nuk kishin mbajtur asnjë seancë të shqyrtimit gjyqësor në seancën e 20 shkurtit 2018, gjyqtari Petkov, kishte njoftuar palët se ky rast duhet të kalojë tek gjyqtarët vendorë. Mirëpo, me këtë vendim nuk ishte pajtuar prokurori Danilo Ceccarelli, i cili këtë e kishte quajtur turp, duke e konsideruar edhe si një dështim të madh të misionit të EULEX-it, në Kosovë.<sup>174</sup>

Nga 9 janari e deri më 3 shtator 2018, kishin dështuar 7 seanca gjyqësore, ndërsa në seancën e 3 shtatorit, gjyqtari Kalludra, kishte veçuar procedurën ndaj Ilaz Sylës, Hajrullah Berishës dhe Mustafë Halitit, të cilët nuk i përgjigjeshin ftesave të gjykatës dhe ndaj Nuhi Ukës, i cili ishte në gjendje jo të mirë shëndetësore.<sup>175</sup> Nuhi Uka më 28 shtator 2018, kishte ndërruar jetë dhe në këtë mënyrë procedura ndaj tij është pushuar. Edhe seanca e paraparë të mbahej më 16 nëntor 2018, ishte shtyrë me kërkesë të të akuzuarit Shaban Syla, pasi që, mbrojtësja e të njëjtit nuk prezantoi në seancë.<sup>176</sup> Edhe seanca e 16 janarit 2019 kishte dështuar të mbahej në mungesë të avokatëve Arianit Koci, Granit Vokshi dhe Xhevahire Klopër<sup>177</sup>. Me 25 qershor

---

<sup>173</sup> "Trupi gjykues jo i plotë, shtyhen seancat e kësaj jave ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin "Toka". Betimi për Drejtësi. 9 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/trupi-gjykues-jo-i-plote-shtyhenseancat-e-kesaj-jave-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>)

<sup>174</sup> "EULEX-i e transferon te vendorët rastin e Azem Sylës, prokurori e quan të turpshëm vendimin". Betimi për Drejtësi. 29 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/eulex-i-e-transferon-te-vendoret-rastin-eazem-syles-prokurori-e-quan-te-turpshem-vendimin/>)

<sup>175</sup> "Rasti "Toka", arratiset Ilaz Syla, veçohet procedura ndaj tij dhe të tjerëve që munguan në seancë". Betimi për Drejtësi. 3 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-arratiset-ilaz-syla-vecohetprocedura-ndaj-tij-dhe-te-tjereve-qe-munguan-ne-seance/>)

<sup>176</sup> "Me kërkesë të njërit nga të akuzuarit, shtyhet gjykimi ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin "Toka"". Betimi për Drejtësi. 16 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/me-kerkesa-te-njerit-nga-teakuzuarit-shtyhet-gjykimi-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>)

<sup>177</sup> "Avokatët në Hagë, shtyhet gjykimi ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin "Toka"". Betimi për Drejtësi. 16 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avokatet-ne-hage-shtyhet-gjykimi-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>)

2019, pas shumë dështimeve kishte arritur të mbahet seanca e shqyrtimit kryesor në të cilën palët kishin dhënë fjalën hyrëse. Prokurori Naim Abazi ka thënë se gjatë shqyrtimeve gjyqësore do të vërtetohet se të akuzuarit kishin marrë pjesë si grup kriminal dhe se nga provat e shumta do të vërtetohet se të akuzuarin ishin fajtorë. Ndërsa të akuzuarit dhe mbrojtësin e tyre e kishin kundërshtuar aktakuzën.<sup>178</sup>

Seanca e 5 shtatorit 2019, kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së mbrojtësit së të akuzuarit Gazmend Gashit, avokatit Qerim Metaj, ku sipas kryetarit të trupit gjykues, gjykatësit Beqir Kalludra i akuzuari Gashi me anë të një parashtrere e kishte njoftuar gjykatën se avokati Metaj gjendej në QKUK për trajtim mjekësor.<sup>179</sup> Seancat e 11 dhe 18 shtatorit ishin mbajtur në Gjykatën Themelore në Gjilan, për shkak se Gjykata Themelore në Prishtinë nuk kishte mjete teknike për të dëgjuar dëshmitarin bashkëpunuar përmes videolinkut, seanca të cilat ishin mbyllur për publikun.<sup>180</sup>

Më 27 shtator 2019, ishte paraparë që të vazhdohet me shqyrtimin e këtij rasti, por kjo nuk ka ndodhur për shkak të kërkesës për shtyrje të seancës së mbrojtësit të Azem Sylës, avokatit Besnik Berisha, me arsyetimin se kishte rast vdekje.<sup>181</sup>

Edhe pse ishte paraparë që gjykimi ndaj Sylës dhe të tjerëve të vazhdoi më 18 tetor 2019, kjo gjë nuk u arrite të bëhet pasi gjykata kishte ‘harruar’ që t’i dërgoi urdhëresat që të akuzuarit Shaban Sylja, Shpresim Uka, Fahredin Gashi dhe Lubisha Vujoviq, të cilët gjendën në vuajtje të dënimit për një rast tjetër, të sillen në gjykatë nga Burgu i Dubravës.<sup>182</sup>

Ndërkaq ishin mbajtur seancat e 11, 20 dhe 27 nëntorit dhe 17 dhjetorit, në të cilat seanca janë dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga prokuroria.

**Dëmi i pretenduar:** Nuk është përcaktuar me aktakuzë

**Sekuestrimit dhe Konfiskimi:** Prona

---

<sup>178</sup> “Rasti “Toka”, prokurori thotë se grupi i Azem Sylës ka korrumpuar zyrtarë të gjykatave dhe të zyrave kadastrale, mbrojtja e kundërshton aktakuzën”. Betimi për Drejtësi. 25 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-prokurori-thote-se-grupi-i-azem-syles-ka-korrumpuar-zyrtare-te-gjykatave-dhe-te-zyrave-kadastrale-mbrojtja-e-kundershton-aktakuzen/>)

<sup>179</sup> “Dështon gjykimi ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin “Toka””. Betimi për Drejtësi. 5 shtator 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>)

<sup>180</sup> “Mbyllet për publikun gjykimi ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin “Toka””. Betimi për Drejtësi. 11 shtator 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbyllet-per-publikun-gjykimi-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>)

<sup>181</sup> Mungon njëri avokat, dështon gjykimi ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin “Toka” Betimi për Drejtësi. 29 shtator 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka-2/>)

<sup>182</sup> “Gjykata nuk lëshon urdhëresat, dështon gjykimi i Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin “Toka” Betimi për Drejtësi. 28 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-nuk-leshon-urdheresat-deshton-gjykimi-i-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>)

## **XI. Rekomandimet**

1. Sistemi Gjyqësor dhe Prokurorial të zbatojnë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, dhe të japin qasje në kërkesat e bazuara në këtë ligj. Veçanërisht, KGJK, KPK, Gjykatat dhe Prokuroritë, në asnjë rast mos të heshtin përballë këtyre kërkesave, derisa nëse e njëjta kërkesë duhet të refuzohet, të ipet arsyetimi meritor.
2. Agjencia për Informim dhe Privatësi në kuptim të nenit 28 të Ligjit nr.06/-081 për qasje në Dokumente Publike të ndërmarrë veprime përballë mos transparencës së sistemit prokurorial dhe gjyqësor.
3. Në hetimin e rasteve të korrupsionit, Prokurori i Shtetit të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e tjera ligj zbatuese në Republikën e Kosovës. Ky bashkëpunim të jetë shumë dimensional, përkatësisht që të trajtohen me seriozitet rastet e parashtruara nga institucionet e tjera publike, të iniciohen me vetiniciativë rastet e publikuara nga këto institucione (p.sh. raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit), materialet, ekspertizat dëshmitë etj. të këtyre institucioneve publike të përfshihen si prova në aktakuza si dhe me këto dimensione të bashkëpunimit, të mbrohen aktakuzat në Gjykata. Kjo qasje e Prokurorit të Shtetit do të mundësonte aktivizimit e të gjitha institucioneve publike në luftë kundër korrupsionit.
4. PSRK të marrë primatin dhe të ketë qasje pro aktive në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë.
5. Krijimi i një departamenti të veçantë në PSRK për luftimin e korrupsionit të reflektojë në rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit, dhe jo në një riorganizim të radhës pa asnjë efekt praktik.
6. Prokurorët në Departamentin për Korrupsion dhe Krim Financiar në PSRK të caktohen mbi bazën e kritereve meritorë, derisa Prokurori i Shtetit dhe PSRK të investojnë vazhdimisht në ngritjen profesionale të prokurorëve në këtë departament.
7. Pas kësaj ngritje, PSRK dhe KPK të kenë kujdes që të krijohet stabilitet në këtë departament, në mënyrë që prokurorët pas kësaj ngritje profesionale mos të lëvizin në departamente të tjera, si dhe të ketë një adresë si për sukseset ashtu edhe për dështimet në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë.
8. Përballë numrit të madh të aktakuza të profilit të lartë të cilat kanë dështuar në Gjykata, Prokurori i Shtetit të bëjë një analizë të këtyre rasteve dhe të identifikojë se cilat kanë qenë shkaqet e dështimit të këtyre rasteve, dhe në raport me këtë analizë, të reflektojë në veprimet hetimore të radhës.
9. Gjykatat e Republikës së Kosovës të zbatojnë në përpikmëri Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore. Pas vlerësimit të drejtë të parimeve të dënimit, rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe qëllimeve të dënimit, dënimet të shqiptohen në përputhje me limitet e paraqitura në shtojcën e këtij udhëzuesi.
10. Gjykatat e Republikës së Kosovës krahas dënimeve kryesore, të aplikojnë edhe dënimet plotësuese.
11. Prokurorët e Shtetit ti referohen Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore me rastin e paraqitjes së mjeteve juridike.

12. Në trajtimin e rasteve të korrupsionit, si Prokurori i Shtetit ashtu edhe Gjykatat të kujdesen që krahas qëllimit që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe të dënohet, të ruhet edhe buxheti i Republikës së Kosovës.
13. Gjykatat e Republikës së Kosovës të publikojnë në faqet e tyre zyrtare të gjitha seancat gjyqësore të caktuara. Në këtë drejtim, KGJK të përcaktojë obligimin për publikimin e këtyre seancave në Rregulloren për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave, dhe në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore, të mbajë përgjegjës të gjithë akterët të cilët dështojnë në përmbushjen e këtij obligimi.
14. Gjyqtarët të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore, në mënyrë që ti shmangen shtyrjes së paarsyeshme të seancave gjyqësore.
15. Prokurorët me rastin e ngritjes së aktakuzave, të identifikojnë saktë pasurinë e përfituar në mënyrë të kundërligjshme, dhe të kërkojnë nga Gjykatat konfiskimin e pasurisë së përfituar nga vepra penale. Të njëjtat propozime të mbrohen edhe në Gjykatë, dhe në rastet kur këto propozime janë të bazuara, Gjykatat të konfiskojnë pasurinë e përfituar me anë të kryerjes së veprës penale.
16. Ndaj personave të cilët shpallen fajtorë me vendim të formës së prerë, Prokurori i Shtetit të iniciojë procedurat e konfiskimit të pasurisë sipas Ligjit nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.
17. Nisur nga fakti se lëndët e korrupsionit hyjnë në grupin e lëndëve me prioritet të trajtimit nga sistemi i drejtësisë, prokurorët dhe gjyqtarët në këto raste të respektojnë të paktën afatet ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale.
18. Në rastet kur kthimi i lëndës në rigjykim nuk është i domosdoshëm, Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të marrin përsipër vendosjen meritorë të rastit në kuptim të ndryshimit të aktgjykimit, dhe jo ti kthejnë lëndët në rigjykim.
19. KGJK të trajtojë çështjen e rasteve të korrupsionit për të cilat Gjykata Supreme ka konstatuar se është shkelur ligji në dobi të të akuzuarve dhe të kërkojë përgjegjësi nga gjyqtarët përmes mekanizmave të brendshëm të kontrollit.